

1 E mërkurë, 15 shkurt 2023

2 [Konferencë përgatitore e Prokurorit të  
3 Specializuar]

4 [Seancë e hapur]

5 [Të akuzuari hyjnë në sallën e gjyqit]

6 --- Seanca fillon në orën 09.31

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,  
8 të gjithëve.

9 Znj. Sekretare, ju lutem paraqisni çështjen.

10 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
11 çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim  
12 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
14 sekretare.

15 U rikujtoj palëve dhe pjesëmarrësve se prezantimi i  
16 palëve nuk do të bëhet rregullisht, sikurse u tha herën e  
17 kaluar. Thjesht ngrihuni në këmbë për të prezantuar një anëtar  
18 të ri të ekipit. Dhe këtu kam ndërmend bashkëmbrojtësin. Dhe,  
19 në qoftë se keni staf mbështetës, atëherë këtë e administroni  
20 edhe vetë.

21 Gjithashtu vërej se të akuzuarit janë të pranishëm në  
22 sallë.

23 Sa për seancën e sotme do të bëjmë pushim në orën 11.00.  
24 Pastaj do të vazhdojmë mbas 11.30 deri në ora 13.00. Pastaj  
25 pushimit të drekës prej 14.30 deri në 16.00. Besoj që nuk do

1 të jetë e nevojshme të vazhdojmë mbas orës 16.00, prandaj ju  
2 kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve që të bëjnë parashtrime të  
3 shkurtra dhe të përqendruara.

4 Siç e dini, më 19 janar 2023, ky Trup Gjykues caktoi  
5 mbajtjen e kësaj konferencë për sot, 15 shkurt. Kalendari në  
6 formë të shkruar qarkullon më 26 janar. Sikurse thuhet në  
7 rendin e ditës, Paneli do t'i kërkojë përgjigje ZPS-së për  
8 çështjet e shtjelluara në paragrafët 1 deri 5 të rregullit 118  
9 dhe tani do të fillojmë me shqyrtimin e këtyre çështjeve.

10 Përpara se të fillojmë me këtë, dua që të bëj disa  
11 komente në lidhje me përmasat dhe strukturën e çështjes së  
12 ZPS-së.

13 Rikujtoj se që nga konferenca në dhjetor, i kemi kërkuar  
14 ZPS-së që të shqyrtojë me kujdes mundësinë e pakësimit apo  
15 zvogëlimit të çështjes së vet. Kemi shprehur mendimin tonë se  
16 700 orë për pyetjet e dëshmitarëve të ZPS-së është pak e  
17 shumtë si kohë.

18 Paneli nënvijëzon rëndësinë e kufizimit të dëshmitarëve  
19 dhe provave të panevojshme dhe përsëritëse. Dëshmitarët  
20 konfirmues duhet të thërriten vetëm kur konfirmimi është i  
21 rëndësishëm për argumentet e ZPS-së. Dhe provat shkresore  
22 duhet të lidhen drejtpërdrejtë me akuzat dhe jo të paraqiten  
23 për të zgjeruar kontekstin apo për të shpjeguar rrethanat e  
24 përgjithshme. Prova të tilla duhet të anashkalohen.

25 Me sa duket ZPS-ja ka ndërmend të paraqesë prova

1 pothuajse për çdo veprim kundër cilësdo viktime të pretenduar  
2 dhe për çdo vend krimi. Pa minimizuar natyrën e rëndë të  
3 këtyre pretendimeve, Dhoma vëren se strategjia e paraqitjes së  
4 provave për çdo vend krimi mund të marrë shumë kohë dhe jo  
5 domosdoshmërisht ka peshë për suksesin apo dështimin e  
6 çështjes.

7 Një grup reprezentativë, që në mënyrë adekuate ilustron  
8 një kategori veprimesh, natyrën e krimeve, klasifikimin e  
9 tyre, përmasat, natyrën, vendet ku kanë ndodhur viktimat e  
10 krimeve, kryesit dhe lidhja e pretenduar e këtyre me të  
11 akuzuarit mund të jetë më efektive në qoftë se paraqitet në  
12 mënyrë më të shkurtër. Çdo përpjekje e ZPS-së për të qenë  
13 shteruese do të kalojë kufirin kohor që kemi caktuar për  
14 paraqitjen e provave.

15 Ne lusim Prokurorinë që të vazhdojë me rishikimin e  
16 këtyre vendeve të krimeve në mënyrë që të bëhet zvogëlimi i  
17 numrit të tyre.

18 Dhe sa i përket strukturës së çështjes së ZPS-së, nuk  
19 është e domosdoshme që, për shembull, provat në lidhje me  
20 zinxhirin komandues të UÇK-së duhet të paraqiten në mënyrë të  
21 strukturuar, koherente dhe logjike. E kemi kërkuar këtë nga  
22 ZPS-ja por nuk kemi pasur shumë sukses. Edhe më tej kërkojmë  
23 një qasje të tillë prej Prokurorisë.

24 Edhe pse nënvijëzojmë se mënyra e prezantimit të provave  
25 është kryesisht përgjegjësi e palës thirrëse, Paneli vazhdon

1 të jetë i shqetësuar dhe do të mbetet i shqetësuar gjatë  
2 gjithë këtij gjykimi. Prandaj kërkojmë që ZPS-ja të marrë  
3 parasysh dhe ndoshta dhe vetë Trupi Gjykues do të nxjerrë një  
4 urdhër në lidhje me këtë. Do të fillojmë me një kërkesë.

5 Kur një dëshmitar thërritet nga ZPS-ja për të dhënë  
6 dëshmi plotësisht apo pjesërisht për funksionimin e zinxhirit  
7 komandues të UÇK-së, ZPS-së do t'i kërkohej që të përgatisë  
8 materiale pamore ose vizuale ose tabela, ku në mënyrë të qartë  
9 dhe të detajuar të paraqesë lidhjen e dëshmisë së dëshmitarit  
10 me atë që do të thotë dëshmitari.

11 Këto tabela dhe materiale vizuale do ta ndihmojnë Trupin  
12 Gjykues dhe Mbrojtjen dhe pjesëmarrësit që ta kuptojnë  
13 dëshminë e atij dëshmitari dhe që ta vendosin atë në një  
14 kontekst të duhur. Informacioni i tillë në tabela duhet të  
15 përfshijë informacion në lidhje me njësitë, strukturat dhe  
16 grupet ushtarake si zonat operative, njësitë speciale,  
17 policinë ushtarake dhe kështu me rashë.

18 ZPS-ja gjithashtu duhet të mbajë parasysh përdorimin e  
19 hartave dhe materialeve të tjera vizuale për t'i ndihmuar në  
20 identifikimin e vendeve fizike ku pretendohet se kanë ndodhur  
21 krimet.

22 ZPS-ja duhet t'ju japë kopje të këtyre tabelave dhe  
23 materialeve vizuale Trupit Gjykues, Mbrojtjes dhe  
24 Përfaqësuesit të Viktimave më së voni 24 orë para fillimit të  
25 dëshmisë së atij dëshmitari.

1 Prokurori mund të marrë vendim vetë se për cilin  
2 dëshmitar duhet të përgatisë materiale të tilla.

3 Tani do të kërkojmë parashtrimet e palëve dhe të  
4 Përfaqësuesit të Viktimave në lidhje me këtë.

5 A mund të na ndihmoni Prokuror, në lidhje me këtë  
6 kërkesë? Pra, a jeni në gjendje të përgatisni materiale të  
7 tilla?

8 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Mund ta bëjmë këtë. Në qoftë  
9 se deklarata hapëse përputhet me atë që keni thënë ju, atëherë  
10 ju mund të na jepni udhëzime të tjera për ndryshimin e  
11 paraqitjes së saj.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni z.  
13 Kehoe?

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, nuk kam.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts?

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] A është e mundur që te këto  
17 materiale të na jepen pak më herët se 24 orë para fillimit të  
18 dëshmisë, në mënyrë që Mbrojtja të ketë mundësinë të merret me  
19 pyetjet për atë dëshmitar në mënyrë më efektive?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë do t'ua  
21 lë ta diskutoni me Prokurorin. Dhe, në qoftë se nxjerr një  
22 përfundim të arsyeshëm, atëherë më informoni.

23 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ju faleminderit, i nderuar  
24 Gjykatës.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Falënderoj palët dhe pjesëmarrësit për parashtrimet e  
2 tyre.

3 Oh, z. Laws, ju harrova.

4 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kam parashtrime.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani për sa i  
6 përket opsioneve që i ka Paneli në dispozicion sipas  
7 paragrafit 1 të rregullit 118.

8 Është e qartë se Paneli ka kompetencën që të kufizojë  
9 numrin e dëshmitarëve, të kufizojë kohën që ka në dispozicion  
10 Prokuroria për paraqitjen e provave, të shkurtojë gjatësinë e  
11 pyetjeve dhe të ftojë Prokurorinë që të kufizojë numrin e  
12 vendeve të krimit apo të krimeve të pretenduara.

13 Megjithatë, Paneli ka ndërmend që ta besojë Prokurorinë  
14 dhe t'i lejojë asaj që të paraqesë çështjen ashtu siç e sheh  
15 vet të arsyeshme. Paneli e rezervon të drejtën e vet për të  
16 ndërhyrë, në qoftë se është e domosdoshme për të garantuar  
17 drejtësinë, shpejtësinë dhe rregullin e këtij procesi. Dhe  
18 kërkojmë prej jush që të vazhdoni të thjeshtëzoni çështjen.

19 Paneli rregullisht do të monitorojë progresin e çështjes  
20 së ZPS-së dhe atë të Mbrojtjes, duke mbajtur parasysh kohën e  
21 përlllogaritur për paraqitjen e provave dhe Trupi Gjykses do të  
22 ndërmarrë hapa në qoftë se e sheh të nevojshme.

23 Paneli gjithashtu pret që pasi të ketë krijuar një mendim  
24 se nuk do të thërrasë një dëshmitar apo nuk do të përdorë një  
25 provë të caktuar, ZPS-ja duhet ta informojë Trupin Gjykses,

1 palët dhe pjesëmarrësit.

2 A e keni këtë të qartë, z. Prokuror?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Po, e kuptoj.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

5 Tani për sa i përket kohës gjithsej që i është dhënë ZPS-  
6 së për paraqitjen e provave, theksoj se kalendarin që ua kemi  
7 dhënë palëve, përfshin rreth 600 orë në vitin e parë të  
8 gjykimit. Do të kalojmë tek shqyrtimi i këtij kalendari me më  
9 shumë hollësi më pas, mirëpo për momentin dua që ta pyes ZPS-  
10 në në lidhje me madhësinë e çështjes, argumenteve të saj.

11 Do të filloj me disa pyetje për dëshmitarët.

12 Momentalisht, në bazë të parashtrimit të djeshëm, ju keni  
13 numrin 312 dëshmitarë. Dhe ky numër ndryshon, pra, ka 11  
14 dëshmitarë më pak se nga parashtrimi i mëparshëm. A është kjo  
15 e saktë?

16 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni  
18 ndërmend që të hiqni ndonjë dëshmitar nga lista?

19 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Siç kemi thënë, është ky një  
20 proces që bëhet në vazhdimësi. Dhe do të vazhdojmë me  
21 rishikimin e listës së dëshmitarëve dhe me paraqitjen e  
22 provave dhe me ecurinë e vetë procesit do të shohim nëse është  
23 e nevojshme të hiqen dhe dëshmitarë të tjerë dhe do ta bëjmë  
24 këtë, po qe e nevojshme.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dua

1 gjithashtu t'ju pyes në lidhje me parashtrimin e datës 7  
2 shkurt 2023, që mban numrin F01261, që ka të bëjë me një  
3 kërkesë për ndryshimin e masave mbrojtëse në lidhje me dy  
4 dëshmitarë.

5 Duhet ta kemi të qartë një gjë: A jeni duke thënë se në  
6 qoftë se nuk miratohet kjo kërkesë për ndryshim të masave  
7 mbrojtëse, dy dëshmitarët nuk janë të gatshëm të dëshmojnë?

8 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Për këtë do të përgjigjet kolegu  
9 im.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Ne themi që, në qoftë se  
11 ndryshojnë masat mbrojtëse, dëshmitë e këtyre dëshmitarëve do  
12 të kërkojmë t'i paraqesim në formë të shkruar.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se  
14 Trupi Gjykses urdhëron që ata të dëshmojnë drejtpërdrejtë,  
15 atëherë ju a do të propozonit që këta dy dëshmitarë të  
16 tërhiqen?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Do ta bëjmë rivlerësimin e kësaj  
18 në atë moment kohor sepse për momentin nuk është marrë një  
19 vendim.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

21 Atëherë dhe sa dëshmitarë në lidhje me krimet do të  
22 thërrasë Prokuroria?

23 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Siç e di edhe Gjykata,  
24 informacioni që japin dëshmitarët shpesh herë është përsëritës  
25 dhe përputhet. Kështu që nuk mund të japim një numër të saktë



1 për dëshmitarët në lidhje me krimet -- vetëm një minutë sa t'i  
2 gjej shënimet. Për dëshmitarët në lidhje me krimet kemi 188  
3 dëshmitarë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po për  
5 strukturën e UÇK-së?

6 ZNJ. MAYER: [Përkthim] 110. Dhe mund të vazhdojë sipas  
7 kategorive që janë në rendin e ditës.

8 Për veprimet dhe sjelljen e të akuzuarve 63 dhe për  
9 elementet kontekstual vepra penale 37. Dhe në qoftë se i  
10 mbledhim këto shifra, atëherë dalin më shumë se 312. Siç e  
11 dini, disa dëshmi mund të jenë përputhëse, përsëritëse. Dhe  
12 këto janë kategoritë si do t'i paraqesim dëshmitarët.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi  
14 paraqitur shqetësimet tona në lidhje me numrin e orëve që do  
15 t'i jepen dëshmitarëve pas paraqitjes së dëshmive tyre në bazë  
16 të rregullit 153, 154. A e keni bërë ndonjë gjë për të  
17 zvogëluar numrin e këtyre orëve?

18 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po. Në përgjigje të urdhrit të  
19 tretë gojor të Trupit Gjykses të 16 dhjetorit, ne bëmë një  
20 parashtrim. Dhe aty paraqitet plani për zvogëlimin e orëve në  
21 lidhje me 154 dëshmitarë - më falni- për dëshmitarët sipas  
22 rregullit 154.

23 Dhe kjo paraqet një përpjekje të konsiderueshme që të  
24 përqendrohemi në dëshmitarët e rregullit 154 ku dëshmitë e  
25 mëparshme, në qoftë se pranohen nga Gjykata, do të paraqiten

1 dhe do të paraqesin bazë për dëshminë e tyre që do të japin.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për sa i  
3 përket listës së 12 dëshmitarëve të parë e kemi të qartë se  
4 radhitja e tyre në parashtrimin që keni bërë është faktikisht  
5 radhitja si do të japin dëshmi këtu. A është kjo e saktë?

6 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do t'i  
8 kthehem numrit të kërkesave që kanë bërë Mbrojtja në lidhje me  
9 paraqitjen e provave në këtë proces.

10 Ju lutem, që në qoftë se do të ketë ndryshime të  
11 radhitjes së dëshmitarëve, ZPS-ja duhet ta njoftojë Mbrojtjen  
12 dhe Përfaqësuesin e Viktimave kur të dalë një nevojë e tillë.

13 Po, urdhëroni.

14 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Po, do të bëj vetëm një  
15 koment të shkurtër. Sikurse e kemi thënë në parashtrimin tonë  
16 me shkrim, ne jemi të vetëdijshëm se Trupi Gjykes do që koha  
17 të përdoret në mënyrë efikase. Pasi t'i kemi rishikuar orët  
18 për pyetjet e palës tjetër, ne duhet të shikojmë edhe njëherë  
19 radhitjen e paraqitjes së dëshmitarëve, por për këtë gjithsesi  
20 do t'ju informojmë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 Do të vazhdojmë me numrin e krimeve dhe vendeve të  
23 krimeve dhe disa prova.

24 A ka ndërmend që ZPS-ja të zvogëlojë akuzat ose kuadrin e  
25 akuzave në këtë moment kohor?

1 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A e keni të  
3 qartë se ne ju ftojmë që ta bëni këtë?

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po. E çmojmë këtë dhe kontekstin  
5 që na e dhatë në fillim të kësaj seance. Ne vazhdojmë që të  
6 shikojmë provat që kemi, mirëpo në të njëjtën kohë kemi dhe  
7 parasysh kohën e Gjykatës.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A e keni  
9 ndërmend të paraqitni prova në lidhje me çdo vend krimi të  
10 përmendur në aktakuzë?

11 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe sa vende  
13 krimi do të përmenden në paraqitjen e provave të Prokurorisë?

14 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Sikurse e dini nga listat që i  
15 janë bashkangjitur Aktakuzës, Lista A, që ka të bëjë me  
16 ndalimet dhe Pika 2 deri në 7 të Aktakuzës, gjithsej 42, duke  
17 përfshirë edhe parashtrimin e djeshëm me një vend krimi.  
18 Domethënë, ka gjithsej 42 vendndodhje në 17 komuna të  
19 ndryshme.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në lidhje me  
21 ndalimin?

22 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po. Vetëm në lidhje me ndalimin.  
23 Për sa i përket Pikave 8 dhe 9 të Aktakuzës, Lista B përmend  
24 vende në 15 komuna të ndryshme dhe në atë paragraf, vrasja dhe  
25 tërheqja nga vendi i krimit në pritje të ofensivës së forcave

1 serbe. Domethënë, gjithsej kemi këtë numër të vendeve në  
2 lidhje me Pikat 8 dhe 9.

3 Ne e kemi të qartë që një numër i përgjithshëm i këtyre  
4 vendeve të krimit mund të japë një pasqyrë sesa komplekse  
5 është paraqitja e provave në lidhje me ato vende krimesh, nuk  
6 është çdo vendndodhje e njëjtë. Edhe pse përmenden më shumë  
7 vende por një vend, për shembull, mund të mbulohet me një javë  
8 apo më pak se një javë dëshmi.

9 Ka vende të tilla të përmendura në Aktakuzë që nuk duhet  
10 të marrin aq shumë kohë.

11 Mund të vazhdoj me dy pikat e tjera apo ju mjafton kjo  
12 përgjigje?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetja ime e  
14 fundit ka të bëjë me përqindjen e provave që kërkoni t'i  
15 paraqisni si prova jo gojore. A mund të na thoni përafërsisht  
16 sa për qind të provave janë këto?

17 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Rreth 50 deri në 60 për qind  
18 sikurse kemi thënë në parashtrimin e djeshëm.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do t'ia  
20 jap fjalën z. Gaynor, që ka disa pyetje.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kam tre pyetje. Do t'i lexoj  
22 të gjitha përnjëherë dhe pastaj do t'ua jap palëve mundësinë  
23 që të përgjigjen.

24 Pyetja e parë, çfarë faktorësh duhet të marrë parasysh  
25 Trupi Gjykses në qoftë se do të vendosë të përdorë të drejtën

1 diskrecionale sipas rregullit 118(1)(d) për të përcaktuar  
2 kohën në dispozicion të ZPS-së për paraqitjen e provave?

3 E dyta, Prokuroria ka parashtruar se 545.5 orë duhen për  
4 paraqitjen e provave të saj. Ky është një numër mjaft i lartë  
5 në krahasim me numrin e orëve në tribunale tjerë. Për  
6 shembull, në gjykimin Karaxhixh në TPNJ, Prokurorisë ju dhanë  
7 300 orë për pyetjet dhe pyetjet plotësuese të dëshmitarëve të  
8 vet. Në çështjen Mlladiç, Dhoma i dha Prokurorisë pak më shumë  
9 se 200 orë për pyetjet kryesore të të gjithë dëshmitarëve të  
10 Prokurorisë. Në të dyja këto çështje, Prokuroria përdori në  
11 mënyrë të gjerësishtme rregullin 92 të Rregullores së  
12 Procedurës dhe të Provave të TPNJ-së. Dhe në të dy këto  
13 çështje kishte aktakuza që përmbanin akuza në masë të  
14 konsiderueshme më të gjera për nga aspekti kohor, territorial  
15 dhe material.

16 Pyetja është kjo: Se çfarë e bën këtë çështje, domethënë,  
17 që të duhen 700 apo 545 orë për pyetjet kryesore të  
18 dëshmitarëve të ZPS-së?

19 Pyetja e dytë ka të bëjë me detyrimin e Trupit Gjykses  
20 sipas rregullit 118(5) që të caktojë një datë të synuar për  
21 përfundimin e paraqitjes së provave të ZPS-së. ZPS-ja ka thënë  
22 që paraqitja e provave mund të përfundojë diku nga fundi i  
23 vitit 2024 dhe, ndoshta dhe fillimi i 2025. ZPS-ja a ka marrë  
24 parasysh këtë detyrim të Trupit Gjykses që të sigurojë se  
25 Mbrojtja të ketë kohën dhe mundësinë e drejtë për t'ju bërë

1 pyetje sipas rregullit 143(3) dëshmitarëve të Prokurorisë dhe  
2 të nxjerrë dëshmi prej tyre që lidhen me çështjen e Mbrojtjes?

3 Urdhëroni, Prokuror.

4 Z. TIEGER: [Përkthim] Mirëmëngjes.

5 Para së gjithash, e çmoj mundësinë që mu dha t'ju  
6 përgjigjem dy pyetjeve tuaja, i nderuar Gjykatës, pjesërisht,  
7 sepse kishte një moment kur unë dhe vet ja kam parashtruar  
8 këtë pyetje vetes në mënyrë retorike dhe u detyrova që t'i  
9 referohem jurisprudencës së TPNJ-së dhe institucioneve të  
10 tjera gjyqësore për t'ju përgjigjur këtyre pyetjeve në mënyrë  
11 sa më objektive.

12 Prandaj do të flasë edhe për përdorshmërinë e çështjes  
13 Karaxhixh dhe Mlladiç për arsye krahasuese me këtë çështje  
14 këtu dhe me ushtrimin e diskrecionit për kufizimin e çështjes  
15 që ka Trupi Gjykses.

16 Përgjigja në pyetjen e parë, në thelb, është se çështjet  
17 Karaxhixh dhe Mlladiç, për arsye që dalin nga natyra e atyre  
18 çështjeve dhe natyra e vetë institucionit dhe faza e  
19 zhvillimit të atij institucioni në atë kohë kur u gjykuan ato  
20 çështje nuk janë një masë e besueshme, në të cilën duhet të  
21 mbështet kur të merret vendimi sesa kohë do t'i jepet  
22 Prokurorisë këtu.

23 Pra, para së gjithash, në lidhje me rrethanat konkrete të  
24 çështjes këtu. Ju e dini, i nderuar Gjykatës, se në çështjet e  
25 tribunalit kishte shumë materiale dokumentuese apo shkresore

1 të asaj kohe dhe këtu flas për raportet ditore të luftimit,  
2 për raporte nga seanca të qeverisë, të parlamentit, të  
3 presidencës dhe kështu me radhë dhe kjo e zvogëlojë nevojën  
4 për t'u mbështetur në dëshmi të disa dëshmitarëve.

5 Përveç kësaj, në mënyrë paradoksale, dëshmitarët u  
6 shpërndanë në të gjithë botën si rezultat i krimeve, nga të  
7 cilat edhe dolën këto dy çështje dhe u intervistuan në  
8 rrethana ku nuk ishin të frikësuar dhe dëshmuan për krime të  
9 atyre përmasave. Dhe dëshmitarët në lidhje me krimet, në fakt,  
10 ishin në gjendje të jepnin dëshmi për një spektër të gjerë  
11 krimesh.

12 Përveç kësaj, kishte një numër të madh përgjatë një  
13 periudhe më të gjatë të ndërkombëtarëve, diplomatëve,  
14 përfaqësuesve të mediave të cilët ishin në gjendje të jepnin  
15 dëshmi sipër krimet dhe për komandën dhe kontrollin.

16 Unë nuk po them që asnjë nga këta faktorë nuk ekziston në  
17 rrethanat e kësaj çështjeje, siç do të shihni edhe ju, se  
18 pjesë të qëllimit të përbashkët në këtë çështje u shpërndanë  
19 publikisht nga të akuzuarit në kohë reale për të zmadhuar  
20 efektin e tyre. Dhe ju do të shihni që ka dhe materiale që u  
21 konfiskuan nga vetë vendbanimet e të akuzuarve që kanë vlerë  
22 të konsiderueshme për këtë çështje, mirëpo gjithsesi, kjo  
23 shkallë është konsiderueshmërisht më e ndryshme.

24 Gjithashtu, ju përmendët çështjen Karaxhixh. Ju me siguri  
25 ju kujtohet, i nderuar Gjykatës, në atë çështje e dini që

1 kishte 2400 fakte të gjykuara më parë në çështje të tjera.

2 Tani, në qoftë se mund të nxirret, deduktohet, një fakt i  
3 gjykuar më parë me një shpejtësi prej 12 minuta për dëshmitar,  
4 kjo do të çonte në një shifër prej 600 orësh. Ose të paktën në  
5 një shkallë prej 15 minutash. Këtë e përmenda sa për ta vënë  
6 në dukje dallimin midis këtyre dy çështjeve.

7 Gjithashtu, dua të them dhe ja vlen të ta them, se masat  
8 e marra në ato raste ishin ekstreme dhe në fund të fundit edhe  
9 u kritikuan. Sidomos në rastin e viktimave që dëshmuan për një  
10 kohë shumë të shkurtër, në kuadrin e provave të rregullit 154.  
11 Të cilat mund të përsëriten këtu, por e dimë mirë dhe, ju si  
12 Trup Gjykses mund ta dini, kritikën që u bënë për faktin që  
13 viktimave ju dha shumë pak kohë në atë kontekst. Dhe  
14 përshtypja ime është që institucionet të cilët kanë ndjekur  
15 këtë lloj rregulli, siç është Gjykata Penale Ndërkombëtare dhe  
16 Gjykata jonë, në një farë mase, është një faktor që mund të  
17 ndikojë në numrin e orëve.

18 Nuk po them se çdo faktor individual është vendimtar, por  
19 po t'i mbledhim të gjitha, nuk është vështirë të shihet se  
20 rastet, çështjet e mëparshme nuk janë domosdoshmërisht një masë  
21 e besueshme lidhur me numrin e orëve që duhet caktuar kësaj  
22 çështjeje. Në fakt, pjesa e parashtrime të mia është e saktë,  
23 që rastet, çështje të cilat janë trajtuar nga institucione që  
24 kanë trajtuar po këto çështje, arrijnë një shkallë efikasiteti  
25 i cili përdoret nga institucioni në raste tjera, por që nuk



1 mund të përdorej kur nuk e ke këtë përvojë. Pra, në rastin e  
2 Gjykatës Penale Ndërkombëtare, për shembull, shikoni numra  
3 lidhur me numrat e orëve që kemi paraqitur dhe ne.

4 Pra, po t'i shikoni këto lëndë, këto çështje, do të  
5 kuptoni që kjo që po them unë tregon se në raste si, për  
6 shembull, Ntaganda, janë dhënë 281 orë për 87 dëshmitarë; në  
7 Ongwen, 400 orë për 120 dëshmitarë; në çështjen Ngaissona i  
8 janë dhënë 420 [sipas përkthimit] orë, e kështu me radhë. Nuk  
9 dua të shpreh ekuivalencën e saktë midis nesh dhe atyre. Por  
10 ideja është që në këto raste, në kontekste të ndryshme,  
11 kërkohen një numër i ndryshëm orësh.

12 Sa për të nënvijëzuar rrezikun e bërjes së ekstrapolimeve  
13 lidhur me orët nga çështje të tjera, pa bërë një analizë të  
14 thellë, dy çështje, për shembull, përbëjnë vetëm një fraksion  
15 të bazës së krimit të cilët janë trajtuar në TPNJ, Limaj dhe  
16 Haradinaj, në këtë rast u deshën 200 ditë të punës së  
17 gjykatës, që përkthehet afërsisht me 800-900 orë. Nuk po them  
18 që t'i përdorim si shembull për të krahasuar orët, por sa për  
19 pasur kujdes të mos bëjmë ekstrapolime lidhur me orët, por të  
20 futemi thellë në faktorët që bëhen shkas për nxjerrjen e  
21 këtyre përfundimeve.

22 Në lidhje me faktorët që duhen përdorur në këtë rast nga  
23 Gjykata, po citoj nja dy që mendoj që kanë rëndësi, që na  
24 sjellin tek pika e ngritur nga Gjykatësi Kryesues sot në  
25 mëngjes; që këto faktorë ushtrohen më mirë në kontekstin e

1 kohës konkrete reale, rishikimit të kohës reale për trajtimin  
2 e kësaj çështjeje.

3 Këto faktorë janë kryesisht fushëveprim i çështjes që  
4 përcaktohet nga krime dhe nga të akuzuarit jo nga Prokuroria.  
5 Dhe kjo është pikënisja. Pastaj, gjykatat kanë parë nëse  
6 aktakuzat i kanë pasqyruar një përfaqësim të arsyeshëm të  
7 këtyre krimeve dhe jo një renditje shteruese të të gjithë  
8 krimeve. Kjo vlen në rastin e çështjeve të mëdha, siç është  
9 çështja Karaxhixh e cila u reduktua në një farë mase për këtë  
10 arsye.

11 Por, këtu Prokuroria nuk po përpiqet të numërojë vendet e  
12 ndodhjes së krimeve për të trajtuar gjithçka që ka ndodhur  
13 gjatë periudhës së aktakuzës, por për të vënë në dukje  
14 karakterin e kësaj çështjeje. Çështje të tilla si, për  
15 shembull, përhapja sistematike e gjëra, madhësia e grupit,  
16 konflikt i armatosur, politikat që janë përdorur në vende që  
17 kanë qenë nën kontrollin e të akuzuarve. Këto janë faktorë të  
18 cilët bëhen shkak për lindjen e akuzave që përmban aktakuza  
19 dhe ne duam të përpiqemi pikërisht në këto vende krimi dhe jo  
20 të përpiqemi të shterojmë të gjithë rrëfimin historik të asaj  
21 që ka ndodhur gjatë periudhës së aktakuzës.

22 Dhe pasi e kalojmë këtë pikë, mendoj që standardi që  
23 duhet përdorur janë ato që janë artikuluar këtu, pra, detyrimi  
24 për të siguruar një gjykim të shpejtë dhe të drejtë. Një  
25 gjykim i drejtë do të thotë që të dy palët duhet të kenë

1 rastin të paraqesin provat në çështjen e tyre. Prokuroria të  
2 paraqesë çështjen e vet dhe shpejt. Me shpejtësi do të thotë  
3 që procesi të zhvillohet, të ecë në një mënyrë të tillë që të  
4 fokusohet tek provat që nevojiten për të provuar akuzat dhe  
5 asgjë më shumë. Kjo i referohet përzgjedhjes, përzgjedhjes së  
6 një numri jo të jashtëzakonshëm dëshmitarësh dhe përzgjedhjes  
7 së dëshmitarëve që flasin pikërisht për krimet e mbuluara nga  
8 aktakuza. Dhe, siç e ka trajtuar dhe më parë Gjykata, kjo  
9 është një çështje është trajtuar në mënyrë efektive dhe  
10 konstruktive dhe trajtohet në këtë mënyrë me ecurinë e  
11 mëtejshme të çështjes.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Për sa i takon pyetjes së  
13 tretë. Pyetja ime ishte, a merrni parasysh detyrimin e Trupit  
14 Gjykues për të pasur një rast për të bërë pyetje palëve,  
15 gjithashtu dhe palëve për pyetje lidhur me çështje që ata  
16 paraqesin?

17 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ne besojmë që po. Sigurisht, nuk  
18 kemi vlerësime të sakta. Kemi 12 dëshmitarët e parë. Disa nga  
19 vlerësimet e Mbrojtjes, janë më tepër se 200 për qind të kohës  
20 në rastin e dëshmitarëve të drejtpërdrejtë. Ne jua lëmë juve  
21 në dorë si Trup Gjykues të vendosni nëse kjo provon të drejtën  
22 e Mbrojtjes sipas rregullit 143(3). Ne besojmë nëse Trupi  
23 Gjykues dhe Mbrojtja ka pyetje për të bërë duhet t'i marrë në  
24 bazë të të drejtave sipas rregullit 143.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua t'i jap tani Mbrojtjes

1 të drejtën për t'u përgjigjur.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] A mund të komentoj së pari për pikën  
3 e fundit?

4 Kolegu ngriti një çështje interesante lidhur me pyetjet  
5 shtesë lidhur me dëshmitarët e rregullit 154. Nga përvoja kemi  
6 parë se kemi pasur deklarata të dëshmitarëve prej 20 faqesh,  
7 me 30-40 paragrafë dhe ne i shikojmë me kujdes të gjitha nëse  
8 ky rresht apo ky paragraf është në përputhje me filan rregull  
9 e kështu me radhë. Dhe Gjykata, gjithashtu, e shikon dhe  
10 pastaj, në bazë të vlerësimit që i bën, jep vendimin në bazë  
11 të rregullave të ndryshme.

12 Ne kemi mijëra faqe dëshmi këtu edhe në rastin e  
13 dëshmitarit të parë, një Zot e di sesa shumë ka, për një mori  
14 çështjesh. Dhe ata duan që të gjithë këtë informacion ta  
15 përfshijnë aty, informacion, për shembull, që personi mund ta  
16 ketë mësuar nga palë të treta e të katërta. Pa pasur ndonjë  
17 udhëzim nga Prokuroria lidhur me deklarata të cilat ata do të  
18 jenë të interesuar që ta përdorin, na i kanë lënë ne në dorë  
19 që të shikojmë mijëra faqe, aq sa mund të jenë dhe të gjejmë  
20 aty çështjet që kanë lidhje me ne.

21 T'i kthehemi, tani, kohës që përmendi z. Tieger.  
22 Procedurat që përmendi që janë përdorur në çështjen Karaxhixh  
23 dhe Mlladiç. Në qoftë se ka ndonjë shqetësim lidhur me kohën  
24 që duhet për të bërë pyetje shtesë për deklaratat e rregullit  
25 154, kjo është arsyeja, sepse ne nuk e dimë se çfarë mendon

1 Prokuroria që është me rëndësi.

2 Kolegu im, Emmerson, e trajtoi më herët këtë, po del  
3 prapë kjo çështje kur shohim kohën që do na duhet për pyetjet  
4 tona si palë. Nuk na intereson asnjëri. Siç tha dhe Gjykatësi  
5 Smith, dua ta mbarojmë sa të jemi gjallë. Kemi të gjithë të  
6 njëjtin shqetësim, që mos zgjatet pa fund. Besoj, Gjykatës  
7 Gaynor, ju e kuptoni sesa vështirë është për ne që të marrësh  
8 mijëra faqe të na i hedhësh ne që t'i shohim të gjitha me  
9 kujdes dhe të gjejmë se çfarë është ajo që Prokuroria do të  
10 paraqesë si çështje nga ana e saj. Tani puna është kjo, ata  
11 duhet t'i marrin të gjithë dëshmitë e betuara, t'i vendosin në  
12 dokumentacion dhe kur të vijmë te dosja paragjyqësore marrim  
13 një fakt këtu, një fakt aty, një fakt këtu dhe ju nuk keni pse  
14 të ankoheni, do na thonë ne Prokuroria.

15 Si përkthehet kjo në shqetësimet e përditshme dhe në  
16 çështjen e kohës që na duhet për t'i bërë ne pyetjet,  
17 kundërpjetet tona? Ky është problemi. Ne nuk kemi kohën e  
18 duhur për të cilën bëhet fjalë, për shembull, në rastin e  
19 TPNJ-së. Në TPNJ e keni bërë në mënyrë të zakonshme një gjë të  
20 tillë, për dekada të tëra. Edhe këtu u fol për pjekurinë e një  
21 institucioni. Unë e kuptoj që ju, të nderuar, keni shumë  
22 përvojë se keni punuar në institucione të tilla apo ne të  
23 gjithë kemi punuar dhe ne vijmë pak a shumë tek e njëjta bazë  
24 gjeografike apo bazë krimesh.

25 Ti kthehem prapë, është një shqetësim serioz për ne duke

1 pasur parasysh se formulimi i kësaj çështjeje nga ZPS-ja  
2 lidhur me mënyrën sesi i mbrojmë ne të drejtat e klientëve  
3 duke pasur kaq shumë informacion që nuk është theksuar, që nuk  
4 është vënë në dukje se çfarë duhet përqendruar në pyetjet  
5 tona.

6 A mund t'i përgjigjem pyetjes suaj të parë?

7 Ne po flasim për një çështje që është dy herë e gjysëm më  
8 e madhe se ajo Mllaxhixh apo e Ratko Mlladiç, apo e  
9 Karaxhixhit. Ajo që ne kemi këtu është, në fakt, çdo ngjarje  
10 të cilën ZPS-ja e ka përfshirë në këtë aktakuzë dhe po i thotë  
11 Gjykatës se objekti nuk është zgjedhur nga ZPS-ja, po nga të  
12 akuzuarit? Pra, ajo që është në akuzë apo nuk është në akuzë  
13 është vetëm punë e ZPS-së.

14 Sigurisht nuk është trajtuar aq konkretisht sa ç'duhet,  
15 por ju e dini vendimin, e njihni, besoj, vendimin e  
16 Haradinajt. Në çështjen Haradinaj u mor vendi për  
17 përgjegjësinë komanduese, ku autori u gjet fajtor, kurse  
18 komandanti nuk u deklarua fajtor. Tani duhet ta trajtojmë këtë  
19 gjatë pyetjes së 12 dëshmitarëve, duhet ta shqyrtojmë të  
20 njëjtin skenar lidhur me përgjegjësinë komanduese, ndihmën dhe  
21 inkurajimin apo teorinë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët  
22 për t'u përpjekur që fajin t'ua vëmë këtyre katër të  
23 akuzuarve, pasi është marrë vendim nga Gjykata e Shkallës së  
24 Parë dhe Apeli, që komandanti nuk është shpallur fajtor.

25 Prokuroria po e bën përsëri të njëjtën gjë. Pra, është

1 dikush në fund që është gjetur fajtor, kryesi. Pastaj  
2 komandanti i tij nuk është deklaruar fajtor. Dhe nuk bëhet  
3 fjalë për ndërmarrjen e përbashkët kriminale. Tani, mbasi ky  
4 person nuk është gjetur fajtor, ne po dalim mbi të për t'u  
5 përpjekur që t'i fajësojmë katër zotërinjtë. Këtu po ndodhin  
6 shumë gjëra. Dhe kjo do ta zgjasë këtë çështje në mënyrë të  
7 konsiderueshme, për fat të keq ne duhet të jemi ata që duhet  
8 t'ia paraqesim Gjykatës, t'i tërheqim Gjykatës vëmendjen çdo  
9 ditë.

10 A ka hapësirë këtu që ju të ushtroni të drejtën tuaj për  
11 të vendosur për t'i thënë ZPS-së që koha për ta përfunduar  
12 këtë në fund të 2024 apo 2025 është shumë kohë dhe ta  
13 shkurtoni këtë kohë? Unë besoj që ju e keni këtë diskrecion  
14 dhe të drejtën për ta bërë.

15 Unë e ngre këtë pikë lidhur me një nga çështjet më të  
16 fundit të cilën do ta diskutojmë prapë, që është diskutuar  
17 njëherë më përpara, sepse do të dali përsëri gjatë marrjes në  
18 pyetje të 12 dëshmitarëve të parë. Faleminderit.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A deshët të thoshit se ju  
20 besoni që kjo çështje është dy herë e gjysëm më e madhe se ajo  
21 e Mlladiç?

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Po. Ajo ka qenë 200 orë për  
23 Prokurorinë. Po. Kjo është 545. Unë nuk e di matematikën por  
24 shifrat flasin vetë.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kam tre çështje të shkurtra, nëse

1 më lejoni.

2 Së pari, në fund, bëhet fjalë për çështje gjykimi për një  
3 Trup Gjykses mjaft me përvojë, i cili shikon natyrën e  
4 çështjes që Prokuroria përpiqet të paraqesë, gjë për të cilën  
5 dihet për mënyrën sesi çështja është strukturuar dhe  
6 paraqitur.

7 Ju e dini dhe ju duhet ta keni parë në dy parashtrimet e  
8 përbashkëta të Mbrojtjes - e para ishte një kërkesë për  
9 ndihmë; e dyta, kërkesë që trajtonte paraqitjen e provës në  
10 mënyrë jोगojore - vështirësitë që duken se hasen në të gjitha  
11 aspektet e çështjes së Prokurorisë që mund të përfshihen në  
12 tre fjalë: Mungesë fokusi. Ka një mungesë fokusi të qartë në  
13 mënyrën sesi çështja është ndërtuar dhe paraqitur.

14 E pranoj plotësisht vendimin e Trupi Gjykses për t'ia  
15 lënë Prokurorisë të vendosë për çështjen e vet, në bazë të --  
16 sepse juve e quani si mënyrë e drejtë, por juve gjithashtu  
17 ngritët çështjen që paraqitja e provave në mënyrën kështu  
18 rastësore, siç do ta paraqitë Prokuroria, nuk do t'i ndihmojë  
19 atë të përqendrohen tek çështja e tyre.

20 Nuk po futem në hollësi përveçse faktit që ne do të kemi  
21 vështirësi kur të fillojë gjyqi. Dhe keni për ta parë vetë në  
22 parashtrimet tona kur të kalojmë nga Drenoci pjesa e mesme në  
23 mesin verës të 1998, kur ka dhe çështje të tjera të cilat nuk  
24 na janë bërë të njohura sepse materiali vazhdon të jetë i  
25 redaktuar dhe pastaj të kalojmë tek një dëshmitar tjetër që ka



1 të bëjë me një pjesë krejtësisht tjetër të Kosovës në fund të  
2 1999, gjatë dëshmitarëve të parë, ne na vihet një barrë e  
3 madhe për të bërë pyetjet tona. Barrë jo në kuptimi që duhet  
4 të njohim një zonë të madhe për të cilët do të flasim  
5 dëshmitarët, por edhe për ju si Trup Gjykses.

6 Pra, është një sfidë shumë e përbërë sepse do të vijë një  
7 dëshmitar i rëndësishëm, i cili do të dëshmojë për ngjarje  
8 lidhur me Drenocin në verën e 1998 kur ka një grup tjetër  
9 dëshmitarësh që do të vijnë më vonë në gjykim, në këtë listë,  
10 por ajo që ka rëndësi ato që nuk janë në listë, për të cilët  
11 redaktimet nuk janë hequr ende nga dëshmitë e tyre dhe ne nuk  
12 e dimë akoma se çfarë do të thonë dëshmitarët e tjerë për të  
13 njëjtën seri ngjarjesh, prandaj ne jemi të penguar në pyetjet  
14 që do të bëjmë dëshmitarit që ka dhënë dëshminë më përpara.

15 Pikënisja është që premisa bazë është që Prokuroria të  
16 zgjedhë sesi ta -- e ka në dorë vetë si ta zgjedhë, ta  
17 organizojë çështjen, por pasojat që ne do të kemi nga kjo gjë  
18 lidhur me dy dëshmitarët e parë dhe ne mund të kërkojmë dhe  
19 t'i thërresim përsëri pasi të na zbulohet materiali - kjo nuk  
20 do të ndodhë vetëm në një vend krimi të vetëm, por shpesh  
21 sepse nuk ka strukturë dhe fokus, siç thashë, nga ana e  
22 Prokurorisë - ky është një problem i madh dhe i dukshëm.

23 Problemi tjetër dhe kjo lidhet me fushëveprimin, me  
24 shkallën, me ushtrimin e diskrecionit të Trupit për të  
25 vendosur një farë strukture. Jo vetëm për interesin e të

1 ndihmuarit të Prokurorisë ta paraqesë çështjen në mënyrë  
2 koherente. Është detyrë e tyre ta bëjnë. Por ne, qoftë ju dhe  
3 ne si Mbrojtje, kemi një qëllim të përbashkët. Ne kemi për  
4 detyrë të sigurohemi që në qoftë se ata e bëjnë punën në  
5 mënyrë kaotike, nuk do të mbrojë të drejtat e të akuzuarve dhe  
6 do të kërcënojë drejtësinë e gjykimit.

7 Sepse do të jetë një gjykim i gjatë, gjë që në të  
8 vërtetë, në vetvete, është në dëm të të akuzuarve të cilët  
9 kanë dy vjet që rrinë në burg përpara se të fillojë gjykimi i  
10 tyre. Kështu që, një nga gjërat që mund të bëni ju si Trup  
11 Gjykues, mund ta keni parasysh, të përdorni, pra,  
12 diskrecionin tuaj për këtë gjë sepse vetë zgjatja është armike  
13 e drejtësisë, armik i të drejtave të të akuzuarve të mos  
14 mbahen të paraburgosur apo t'i nënshtrohen një përndjekje  
15 penale që është në mënyrë të paarsyeshme e gjatë.

16 Në qoftë se shohim mënyrën sesi Prokuroria propozon t'i  
17 paraqesë dokumentet dhe ka një koment për këtë në parashtrimin  
18 tonë të fundit të përbashkët, aty nuk ka ndonjë tregues në  
19 mënyrën sesi paraqiten dokumentet që të jenë relevante. Apo  
20 ndonjëherë çfarë pjese në një numër ERN është provuese e  
21 çështjes së Prokurorisë.

22 Në rastet 92 ter në TPNJ, për shembull, ishte një dëshmi,  
23 një deklaratë e një dëshmitari që paraqiste dëshminë e këtij  
24 dëshmitari, ata dëshmonin për të thënë që e pranonin atë  
25 deklaratë, mund të jepnin një përmbledhje të shkurtër të asaj

1 deklarate dhe pastaj merreshin në pyetje nga Mbrojtja, kurse  
2 këtu, kemi shtatë, tetë, nëntë, dhjetë orë intervistash, për  
3 shembull, transkriptesh të intervistave, të cilat të gjithë  
4 përmbajnë përsëritje, përcaktime, mungesë qartësie, mundësisht  
5 edhe kundërthënie. Të gjitha këto materiale, me rëndësi apo  
6 jo, të dobishme, të qartë apo jo, të paqartë, në vend që të  
7 filtrohen dhe të na paraqiten ne dhe Trupit Gjykses në mënyrë  
8 koherente, do të hidhen, do të na hidhen përpara sysh me  
9 shpresën që Zyra Administrative dhe, me një fjalë, do të  
10 përmbledhë ato siç duhet, do të bëjë atë që, në fakt, duhet të  
11 ishte detyra e Prokurorisë.

12 Pra, të gjithë vijmë tek pika, në fund, që do të kemi  
13 material shumë të gjerë që askush nuk e di sa i rëndësishëm  
14 është, por avantazhi i Prokurorisë është që në këtë mënyrë e  
15 shtynë çështjen duke futur sa më shumë, hedhur sa më shumë  
16 materiale në proces.

17 Është e vërtetë që një kuptim dhe nuk dua të jem  
18 pexhorativ, po ndonjëherë thuhet që: Është mirë që t'ia japësh  
19 litarin sa më të gjatë Prokurorisë e të shikosh nëse ajo do të  
20 vari veten me të. Nuk është koherente, nuk është. Është edhe  
21 një farë dëmtuese, e cenon drejtësinë.

22 Dy pikat e tjera që dua të ngre shumë shkurt, përsëri,  
23 siç thashë, mund të ndodhë në fund që është një çështje sesi  
24 ndihet ajo. Se është e vërtetë që nuk mund të bazohesh vetëm  
25 në shifra, siç thotë z. Tieger, pa treguar -- pa i futur ato

1 në një kontekst. Nuk bëhet krahasimi në mënyrën matematike.

2 Unë nuk pajtohem me këtë.

3 Por mund të jetë një indikacion, një tregues sesa e  
4 fokusuar është çështja e Prokurorisë, që, është në fund të  
5 fundit, është në themel të diskrecimit tuaj, të diskrecionit  
6 tuaj. Po të bëjmë një krahasim të thjeshtë të fushëveprimit,  
7 objektit dhe orëve të përdorura, në vetvete është një tregues,  
8 jo aq për sa i takon numrit, matematikës, por, në përgjithësi,  
9 në qoftë se një prokuror me përvojë që trajton me çështje me  
10 krime të tilla që mbulojnë një fushë të madhe gjeografike  
11 duhet të këtë për këtë një farë shpjegimi. Ndryshe ndjekja  
12 penale nuk bëhet siç duhet me shkallën e duhur të  
13 profesionalizmit.

14 Kur dikush shikon që prokurorët e ish-presidentit  
15 Slobodan Millosheviç, aktakuza e të cilit filloi në Kosovë dhe  
16 pastaj mbuloi Kroacinë dhe Bosnjën përpara se t'i kthehej  
17 përsëri Kosovës, në 1988-1989, ku filloi fushata në Ballkan.  
18 Pra, unë besoj që në këtë rast periudha e aktakuza duhet të  
19 mbulonte një periudhë dhjetë vite, në gjithë Ballkanin. Në atë  
20 rast, për shembull, nuk shtrohet çështja se çfarë urdhëruan të  
21 bënin por çfarë bënë, përfshi në kuadër të tërësisë së  
22 çështjes. Shumë njerëz e kritikonin faktin që do trajtoheshin  
23 tre konflikte bashkë, por ky ishte qëndrimi që mori  
24 Prokuroria.

25 Pra, Prokuroria i paraqiti faktet e çështjes së saj para

1 se ta mbyllte, sepse presidenti Millosheviç vdiq përpara se të  
2 mbyllej çështja, ajo mori 360 orë. Kurse në rastin tonë, për  
3 të trajtuar këtë çështje duhen dyfishi. Një fraksion i asaj  
4 për të cilën është akuzuar Millosheviçi është këtu.

5 Sigurisht është e drejtë të thuhet që nuk mund të shikosh  
6 vetëm shifrat, vetëm numrat dhe ta përgatisësh një çështje,  
7 por është sofistikim nga ana z. Tieger të sugjerosh që duhen  
8 nxjerrë disa mësimë. Nuk bëhet fjalë për orët, për çdo akuzë  
9 të aktakuzës, në rastin e Millosheviçit duhet të ishte dashur  
10 20 vite, në qoftë se do vazhdonim me këtë logjikë. Por është  
11 një çështje ku krahasimi dhe nuk i justifikohet me shpjegimin  
12 që dha z. Tieger lidhur me përvojën që kishte TPNJ-ja, për  
13 shembull, në atë kohë.

14 Në qoftë se bëjmë një krahasim, del se kjo tregon dhe  
15 njëherë konfuzionin, paqartësinë, mungesën e plotë të  
16 përqendrimit në mënyrën sesi paraqitet çështja Prokurorisë --  
17 më falni, se më ndërprejnë.

18 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk e  
19 kuptoj se çfarë lidhje kanë këto parashtrime të gjata me ato  
20 që u thanë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk janë aq  
22 të gjata sa ç'foli z. Tieger, të mbarojmë.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk mendojmë se Prokuroria ka të  
24 drejtë të kundërshtojë kohëzgjatjen e parashtrimeve.

25 Pra, ne jemi dy javë përpara se të fillojë gjykimi që

1 tregon dhe më shumë diskrecionin, rëndësinë që ka diskrecioni  
2 i Trupit Gjykses. Jo për t'i thënë Prokurorisë sesi duhet ta  
3 procedojë çështjen. Sepse ne të gjithë kemi këshilla për këtë.  
4 Por për të thënë që nuk bëhet kështu. Nuk është mënyra sesi  
5 Trupi Gjykses mund ta pranojë trajtimin e një çështjeje nga  
6 Prokuroria.

7 Dhe kur të gjitha shpjegimet që ju dha z. Tieger nuk  
8 tregojnë asgjë, s'kanë kuptim, nuk provohen nga fakte - siç  
9 thashë, në rastin e Millosheviçit - njeriu pyet: Çfarë do të  
10 thotë? Çfarë ka parasysh? Cili është thelbi? Ai është i  
11 ndryshëm krejtësisht, atëherë bëhej fjalë për ndjekjen e të  
12 pandehurve serbë që ishin ushtri e vërtetë. Kishin dokumente,  
13 kishin strukturë komanduese, raportime të përditshme. Njerëzit  
14 në krye e kontrollonin ata që ishin poshtë.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Emerson, i kemi marrë  
16 kërkesat tuaja për disa çështje. Tani të fokusohemi ke  
17 kohëzgjatja.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po shpjegimi i Tieger se përse  
19 kjo çështje ndryshon nga ajo përpara. Kjo ishte pyetja juaj e  
20 parë. Në qoftë se nuk ka të bëjë me faktin që TPNJ-ja ishte  
21 një gjykatë me përvojë, shpjegimi tjetër që u dha është se  
22 ishte papërvojë: Duhet të provojmë gjëra në atë rastin e TPNJ-  
23 së dua të them bëhet fjalë për të pandehur serbë që ishin  
24 ushtri e vërtetë. Kurse në rastin e UÇK-së, duhet të marrim  
25 copëza aty-këtu, të dhëna nga dëshmitarët. Prandaj, për këtë

1 arsye, domethënë, duhet të jetë -- është e ndryshme. Duhet të  
2 theksoj mënyrën që po përndjek Prokuroria që përpiket të marri  
3 copa aty e këtu dhe t'i bashkojë që në fund mund të paraqitet  
4 prej tyre si ndërmarrje kriminale e përbashkët, kur provat  
5 materiale, siç tha z. Tieger, në rastin e TPNJ-së nuk janë  
6 këtu.

7 Pra, koha që ata propozojnë për të përdorur pasqyron jo  
8 aq dallimin e ligjshëm të kësaj çështjeje dhe çështjeve të  
9 tjera, por pasojat e pashmangshme të mungesës së fokusit që  
10 karakterizon çdo aspekt të mënyrës sesi Prokuroria e ka  
11 hartuar dhe përgatitur çështjen e vetë.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Roberts, ju lutem a mund  
13 të përqendrohemi në çështjen që po diskutojmë tani, domethënë,  
14 kohëzgjatjen e pritshme të çështjes së ZPS-së.

15 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.  
16 Do mundohem të jem sa më konciz të jetë e mundur dhe pa  
17 diskutim mbështes plotësisht atë çfarë u tha nga kolegët.

18 Z. Tieger tha që të drejtat e të akuzuarve duhet të jenë  
19 në qendër të kësaj çështjeje ashtu siç edhe procesi dhe  
20 shpejtësia e procesit.

21 Pra, pa diskutim që kjo është një qasje e drejtë sepse të  
22 akuzuarit kanë të drejtat e tyre të cilat duhet të  
23 respektohen. Dhe këtu, për shembull, i referohem posaçërisht  
24 nenit 21(4)(a) sa i takon të drejtës për t'u informuar në  
25 mënyrë të hollësishme në një gjuhë të cilën ata e kuptojnë dhe

1 sa i takon edhe kohëzgjatjes së çështjes së Prokurorisë. Një  
2 tjetër e drejtë është që të kenë mundësinë që çështja kundër  
3 tyre të gjykohet brenda një kohe të arsyeshme. Si dhe të kenë  
4 mundësi që të marrin në pyetje dëshmitë e dhëna kundër tyre.

5 Mendoj, i nderuar Gjykatës, që kjo është pika kryesore që  
6 do të duhet të merret parasysh prej jush.

7 Sa i takon pikës që u ngrit në fund nga z. Tieger, unë  
8 mendoj, që ZPS-ja nuk ka të drejta të njëjta si të akuzuarit.  
9 Sepse të akuzuarit kanë të drejta që janë të parashikuar në  
10 ligj dhe në rregullore. Ndërkohë që Prokuroria ka mundësinë që  
11 të paraqesë çështjen e saj dhe, ndërkohë, domethënë, mënyra  
12 sesi parashikohen të drejtat ndërmjet palëve, nuk janë të  
13 barabarta. Kështu që për këtë arsye, këtë dua të them për  
14 momentin lidhur me argumentin që juve më kërkuat që të jepja.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Znj. Alagendra, a keni  
16 ndonjë koment lidhur me kohëzgjatjen e çështjes së  
17 Prokurorisë.

18 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Z. Ellis  
19 do t'ju drejtohet, i nderuar Gjykatës.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Ellis.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

22 Jemi plotësisht dakord me çështjet dhe me argumentet e  
23 ngritura kolegët e tjerë. Ne mendojmë që kohëzgjatja e  
24 përgjithshme e çështjes së ZPS-së duhet të lidhet në veçanti  
25 me argumentin që klientët tanë, klienti im posaçërisht, ka



1 qenë në paraburgim për më tepër sesa dy vite tanimë. Dhe në  
2 qoftë se dëgjojmë Prokurorinë që thotë që çështja do të  
3 vazhdojë deri në 2025 dhe pastaj keni parasysh që na duhet  
4 gjithashtu edhe çështja e kohës për pyetjet nga Mbrojtja apo  
5 argumentet e ndryshme që mund të kërkonit ju, të nderuar  
6 Gjykatës. Kështu që mund të mendohet nga të gjithë që do të  
7 duhet një kohë e konsiderueshme që të akuzuarit të qëndrojnë  
8 në paraburgim derisa të përfundojë çështje në fjalë.

9 Sigurisht, që jemi dakord me parashtrimet që u dhanë më  
10 përpara. Përkatësisht, që çështjet e mëparshme nuk mund të  
11 jenë plotësisht përcaktuese, megjithatë, ato mund të jenë një  
12 element i rëndësishëm apo i dobishëm krahasimi, duke marrë  
13 parasysh gjithashtu edhe përvojat tuaja të nderuar Gjykatës në  
14 çështje të ngjashme. Asnjë nga çështjet që përmendi z. Tieger  
15 nuk shkon më shumë sesa 500 orë për Prokurorinë. Ndërkohë që  
16 këtu nuk jemi në TPNJ. Nuk kemi vite në gjykime të mëparshme  
17 në kuptimin gjykimeve që ka pasur TPNJ-ja, megjithatë, të  
18 nderuar Gjykatës ju keni përvojën e akumuluar nga këto çështje  
19 dhe nga tradita e mëparshme.

20 Pra, do të kemi kërkesa ose aplikime për faktet e  
21 gjykuara. Kemi marrë gjithashtu edhe aplikimet e Prokurorisë  
22 për 8.000 dokumente. Sigurisht që do të kemi dhe dëshmitarët  
23 ndërkombëtarë që do të merren nga ZPS-ja. Megjithatë,  
24 parashtrimi ynë është, që asgjë që u tha nga ZPS-ja nuk e  
25 justifikon që orët në dispozicion të ZPS-së të jenë më të

1 gjata sesa në të gjitha çështjet e mëparshme të përmendura.

2 Nuk është vetëm relativisht paradoksale, siç e tha z.

3 Tieger, që një çështje më e madhe kërkon më tepër kohë.

4 Mendojmë që e kundërta është e vërtetë.

5 Do t'ju inkurajojmë, të nderuar Gjykatës, që këtë çështje  
6 ta trajtoni tani ose në një fazë të mëhershme, sepse  
7 vështirësia e trajtimit gradual të kësaj dhe, pastaj,  
8 Prokuroria më pas të vazhdojë që të ofrojë dëshmitarë dhe të  
9 japë të dhëna të tjera për sa i takon vendeve të krimit,  
10 domethënë, këto janë çështje të cilat mund të kenë ndikim mbi  
11 përgatitjen e Mbrojtjes. Kështu që do t'i bënim thirrje Trupit  
12 Gjykues që të marrë parasysh të gjithë këto element.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. Laws.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Nga Mbrojtja më lejoni të jap një  
16 shifër tjetër nëse mundem. Prokurori përmend, tha, që në  
17 rastin e Karaxhixhit çështja u gjykua më shpejt, sepse një  
18 pjesë e mirë e fakteve ishin të gjykuara më tepër, më përpara.

19 Dua të them, domethënë, që Prokuroria kishte vetëm 200  
20 orë në këtë çështje që përmendi Prokurori.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Laws, keni ndonjë  
22 parashtrim?

23 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kemi parashtrim lidhur me  
24 këtë gjë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëhere të

1 vazhdojmë me pyetje të tjera. Dhe dëshiroj të dëgjoj jo vetëm  
2 nga ZPS-ja por edhe nga Mbrojtja për këtë temë, në qoftë se  
3 është e mundur.

4 Më 18 nëntor 2022, ZPS-ja dorëzoi një listë të pikave për  
5 të cilat palët pajtohen. Dhe ky është parashtrimi i  
6 protokolluar F01114, që ka një shtojcë publike dhe një shtojcë  
7 konfidenciale.

8 Ekipet e Mbrojtjeve kanë dorëzuar një njoftim të  
9 përbashkët të Mbrojtjes lidhur me parashtrimin F01114, ky  
10 është parashtrimi i protokolluar F01116.

11 A ka ndonjë zhvillim tjetër në këtë aspekt?

12 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Ne  
13 vazhdojmë që të jemi të përfshirë në diskutime ndërmjet  
14 palëve. Më datën 9 shkurt, javën që shkoi, ne kemi filluar që  
15 të kemi kontakte me Mbrojtjet, me Ekipet e Mbrojtjeve, për të  
16 parë se cilat janë pika juridike me të cilat ata duan që të  
17 diskutojnë me neve, pra, në qoftë se ka pika juridike dhe  
18 faktike me të cilat ata do pajtohen me ne apo jo dhe vazhdojmë  
19 që të kemi diskutime me ta.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kur pritet që  
21 të merret një përgjigje lidhur me këto diskutime?

22 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kemi vendosur për një kohë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do i kërkoj  
24 Mbrojtjes fjalën për t'u shprehur lidhur me këtë pikë.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se ne do biem

1 dakord faktike dhe juridike, të nderuar Gjykatës, në këtë  
2 pikë. Kjo nuk do të thotë që ne nuk do të vazhdojmë me  
3 diskutimet *inter partes*, pra, ndërmjet palëve, megjithatë nuk  
4 di çfarë t'ju them sepse këto diskutime nuk është se kanë qenë  
5 aq shumë produktive deri tani.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe cili  
7 është problemi këtu?

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Thjesht nuk jemi dakord. Nuk jemi  
9 dakord se bëhet fjalë për një mori të gjerë dokumentesh që ka  
10 Prokuroria. Kaq e thjeshtë është.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,  
12 ndonjë gjë për të shtuar?

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk dua që të merrem posaçërisht  
14 për sa i takon pajtimit për çështje faktike. Lidhur me  
15 pajtimin për fakte juridike është shumë e vështirë që të  
16 arrihet kjo gjë, sepse ZPS-ja nuk është se ka bërë ndonjë  
17 parashtrim të ligjit lidhur me argumentet e veta. Nuk ka dhënë  
18 asnjë parashtrim sa i takon korrespondencës apo interpretimeve  
19 ligjore ose cila mund të jetë baza për pajtimet për pikat  
20 juridike.

21 Pra, mendoj që kjo është një prej arsyeve pse i është  
22 bërë kjo pyetje ZPS-së, pra, ZPS-ja duhet që të qartësojë se  
23 çfarë pozicioni ka lidhur me pikat juridike. Së pari duhet të  
24 sqarojnë pozicionin e tyre dhe pastaj në qoftë se ka çështje  
25 me të cilat duhet të pajtohemi duhet të vijohet më tej. Është

1 e rëndësishme që pikat që janë identifikuar për seancën e  
2 pasdites, pra, siç do ta shikojmë, ka shumë pak pajtim  
3 ndërmjet palëve. Pra, disa prej pikave janë diskutuar; disa  
4 prej tyre nuk janë diskutuar deri tani. Megjithatë, më duhet  
5 të them se pozicionet janë shumë të ndryshme sa i takon disa  
6 prej këtyre pikave. Besoj që kjo do të bëhet e qartë deri në  
7 fund të ditës.

8 Sa i takon fakteve, fakteve duhet të jenë të gjykuara,  
9 faktet janë tjetër gjë dhe dua që të merren parasysh, për  
10 shembull, vendimet për çështje të gjykatave të Kosovës, TPNJ-  
11 së apo të gjykatave të tjera. Sa i takon, pra, vendit të  
12 krimit kjo është një çështje e komplikuar, sepse për ne është  
13 e pamundur që të pranojmë fakte për të cilat nuk kemi fare  
14 dijeni. Kështu që, në qoftë se pretendohet se ka ndodhur një  
15 ngjarje e caktuar, pra, në qoftë se do të marrim parasysh  
16 numrin, afatin që për të cilin bëhet fjalë, pra, këto janë  
17 gjëra që duhet të na i japë ZPS-ja. Sepse ne nuk mund të bëjmë  
18 një parashtrim lidhur me diçka për të cilën nuk kemi dijeni  
19 dhe në të cilën ne nuk jemi të përfshirë, në kuptimin që nuk  
20 kemi qenë aty kur ka ndodhur.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A synoni që  
22 t'i përgjigjeni kërkesës së Prokurorisë?

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Ka pasur një diskutim ndërmjet  
24 palëve, i nderuar Gjykatës, besoj që vazhdojnë akoma  
25 diskutimet. Edhe kolegët e mi kohët e fundit kanë pasur

1 diskutime *inter partes*.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe,  
3 thjesht po pyesja nëse ka ndonjë sugjerim, në qoftë se ju  
4 është bërë ndonjë ofertë nga ZPS-ja?

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk mendoj se kjo ofertë është shumë  
6 ndryshe nga skenarët që janë dhënë më përpara nga ZPS-ja,  
7 sepse, sikurse e tha z. Emmerson, bëhet fjalë për zhvillime  
8 për të cilat ne nuk kemi fare njohuri.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Për të qenë i qartë. Pra, thuhet,  
10 për shembull: Se cilat janë ato aspekte të vendimit të  
11 konfirmimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, domethënë,  
12 thuhet që në fillim fare se cilat aspekte të ligjit ju, si  
13 Mbrojtje, parashtrojnë si pozicione për të cilat pajtohen  
14 palët? Dhe unë thjesht nuk kam synim, domethënë, nuk mendoj që  
15 do t'i përgjigjem kësaj pyetje.

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] Pra, besoj që do të na ndihmonte  
17 në qoftë se ZPS-ja, siç e tha dhe z. Emmerson, do thoshte se  
18 cili është pozicioni i ZPS-së. Pra, pozicioni i ZPS-së është  
19 në qoftë se ligji i parashikuar në aktakuzën e konfirmuar  
20 është baza ligjore në të cilën ata do të mbështeten apo në  
21 qoftë se ka ndonjë gjë tjetër shtesë. Pra, duhet të dimë  
22 ekzaktësisht se cili është pozicioni i ZPS-së sepse në të  
23 kundërtën jemi në të njëjtin pozicion siç ishte edhe z.  
24 Emmerson dhe z. Kehoe.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 Do vazhdojmë me pyetje të tjera dhe mbase mund të marrim  
2 ca sqarime nga pyetjet e tjera dhe pastaj mund t'i kthehemi  
3 përsëri kësaj pyetjeje.

4 Z. Ellis.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Pra, kam të njëjtin qëndrim. Jam  
6 kundër, domethënë duam edhe ne, si ekipet e tjera të  
7 Mbrojtjes, që të na thotë ZPS-ja se cili është qëndrimi i saj  
8 dhe do t'i përgjigjemi më pas, pasi të marrim sqarimet nga  
9 ZPS-ja.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. I  
11 mbajta shënim këto komente.

12 Z. Laws, ndonjë gjë për të shtuar?

13 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, asgjë për të shtuar.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit  
15 për parashtrimet tuaja për këtë çështje, kështu që do të  
16 kalojmë tani në nxjerrjen e dokumenteve.

17 Rregulli 118(4) i Rregullores parashikon detyrimet e  
18 nxjerrjes së materialeve nga palët. Është e qartë, pra, që  
19 "duhet që të përmbushet", pra, detyrimi për nxjerrjen e  
20 materialeve. Pra, siç parashikohet në nenin 103, ZPS-ja sipas  
21 këtij rregulli, pra, duhet që të nxjerrë materialet  
22 shfajësuese në momentin e parë që këto materiale i vihen në  
23 dispozicion asaj ose për të cilat vihet në dijeni ZPS-ja.

24 Ne e kemi shpjeguar në një vendim të mëparshëm se çfarë  
25 pozicioni kemi lidhur me këtë.

1 Ndërkohë, që sot duam që të sqarojmë që, ZPS-ja dhe më  
2 tej Mbrojtja, i kanë përmbushur të gjitha detyrimet që  
3 rrjedhin nga rregulli 104, pra, me fjalë të tjera duam të  
4 verifikojmë që i gjithë materiali që ka qenë në posedimin tuaj  
5 dhe që kërkohet që të nxirret, në fakt, është nxjerrë.

6 Gjithashtu duam që të dëgjojmë nga ZPS-ja, që ZPS-ja e ka  
7 bërë rishikimin dhe rivlerësimin e rëndësisë së dokumenteve të  
8 tyre.

9 Në qoftë se disa dokumente shtesë do të ofrohen më pas,  
10 pra, në këto raste duhet që të ekzistojë një shpjegim shumë  
11 bindës lidhur me nxjerrjen e vonuar.

12 Sa i takon materialit aktualisht në ruajtjen në  
13 kontrollin ose njohurinë faktike të ZPS-së, dua të pyes në  
14 qoftë se detyrimet sipas rregullit 103 janë përmbushur, pra,  
15 në qoftë se janë nxjerrë materiale që bien në rregullin 103.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa i takon  
18 kërkesave të tjera për nxjerrje, a janë përmbushur këto  
19 detyrime?

20 Z. HALLING: [Përkthim] Duhet që të shikojmë rregullin  
21 102(3), sepse kemi dokumente të cilat i kemi në posedim muajt  
22 e fundit kështu që do të duhet që të bëjmë njoftimin e duhur.

23 Ne po përditësojmë një njoftim të ri sipas rregullit  
24 102(3) javën që vjen dhe do të përmbushim detyrimet tona për  
25 nxjerrjen e materialeve përpara fillimit të procesit gjyqësor.



1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja  
2 çfarë ka për të thënë lidhur me këtë temë?

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Cili është volumi i materialit të ri  
4 sipas rregullit 103?

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetje e  
6 drejtë.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Po mendojmë aktualisht për 700  
8 dokumente. Pra, ka disa dokumente që do t'i nxjerrim në mënyrë  
9 të drejtpërdrejtë javën që vjen. Por, ndërkohë materialet e  
10 reja, të cilat do të nxirren në bazë të rregullit 102(3), janë  
11 gati 700 dokumente.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] 700 dokumente nuk na thonë shumë.  
13 Nuk është se marrim mjaftueshëm informacion.

14 Z. Gjykatës, a mund t'ju kërkojmë që t'i kërkon  
15 Prokurorit të thonë që për sa faqe bëhet fjalë?

16 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk e kam numrin e saktë të  
17 faqeve, megjithatë këto dokumente do të jenë gati duke filluar  
18 nga e premtja e kësaj jave.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të themi  
20 të premtën. Se po i afrohem gjykimit. Nuk kemi kohë pafund në  
21 dispozicion.

22 Mund të vazhdoni në qoftë se kemi komente të tjera.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, jemi thujse në  
24 fillim të procesit, ndërkohë që vazhdojmë të flasim për  
25 nxjerrjen e materialeve, pavarësisht, le të themi, afateve që

1 janë përcaktuar nga Trupi Gjykses dhe pavarësisht nga  
2 diskutimeve me ju të nderuar gjykatës në mes të dhjetorit, ja  
3 ku jemi prapë sot. Besoj, të nderuar Gjykatës, e mendoni se  
4 çfarë do të thotë për neve që të kemi 700 dokumente të tjera,  
5 duke marrë parasysh këtu edhe dokumente me faqe të pafundme të  
6 cilat janë nxjerrë gjatë 30 ditëve të fundit.

7 Nuk kam çka të them tjetër, i nderuar Gjykatës, përveçse  
8 ta them në mënyrë të përmbledhur që ky është problem për ne.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e vërtetë,  
10 problem është. Edhe e kemi thënë këtë gjë, e kemi pranuar këtë  
11 gjë.

12 Z. HALLING: [Përkthim] A mund të ta shtjellojmë pak më  
13 tepër këtë pikë?

14 Kjo është një çështje e cila parashikohet në rregullin  
15 102(3). Pra, do ketë një procedurë të vazhdueshme. Ne do të  
16 vazhdojmë që të japim dokumente të reja gjatë gjithë gjykimit  
17 dhe do të vazhdojmë t'i njoftojmë ato. Ky nuk është problem.  
18 Kjo është mënyra sesi funksionon parashikimi i rregullit  
19 102(3).

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju po thoni  
21 që këto 700 dokumente janë materiale që sapo janë vënë në  
22 dijeni?

23 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk janë të gjitha materiale  
24 që sapo na janë vënë në dijeni. Disa prej tyre janë dokumente  
25 të 107, pra, të rregullit 107. Por janë dokumente gjithsesi të

1 cilat nuk mund të ishin njoftuar një periudhë të mëparshme.

2 Pra, duhet ta bëjmë këtë si proces ndërkohë që zhvillohet  
3 procesi gjyqësor siç parashikohet në rregullin përkatëse.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emerson,  
5 doni të flisni?

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo në këtë pikë. Mund të kem  
7 parashtrime pak më vonë, por për momentin nuk kam gjë për të  
8 thënë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Kam dy pika. Së pari, sa i takon  
11 njoftimit për alibi sipas rregullit 104. Duam t'ju vëmë në  
12 dijeni që do të dorëzojmë një parashtrim sot. Ndërkohë që kemi  
13 dorëzuar më përpara një raport lidhur me këtë, me parashtrime  
14 të tjera, që është parashtrimi përkatës. Dhe dëshiroj që të  
15 them që po presim më shumë sqarime që kanë të bëjnë me  
16 elementët konkretë të pretendimeve që rrjedhin nga dosja  
17 paraprake që juve kërkua që të dorëzoheshin sot në një  
18 version më pak të redaktuar ose të paredaktuar. Pra, kjo është  
19 çështja që kisha për të thënë për sa i takon njoftimit për  
20 alibi.

21 Pika e dytë ka të bëjë me kërkesën e përbashkët të  
22 Mbrojtjes për sa i takon provave jo gojore. Ka pasur  
23 parashtrime të ndryshme sa i takon materialeve që do të  
24 dorëzohen nga Prokuroria si prova jo gojore, kështu që do të  
25 ketë disa probleme të tjera për nxjerrjen e materialeve që

1 kanë të bëjnë me këtë element.

2 Duke pasur parasysh, gjithashtu edhe volumin e provave jo  
3 gojore që parashikojnë, siç është thënë prej tyre që janë 50  
4 deri në 60 të dokumenteve. Dua të them që kjo mbase do të jetë  
5 një çështje që do të vazhdojë për shumë kohë dhe mund të jetë  
6 një problem për neve dhe thjesht doja t'jua sillja në vëmendje  
7 tani.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ky vazhdon që  
10 të jetë një problem që na shqetëson. Besoj që e keni parë që  
11 nga parashtrimi i përbashkët se përveç 56.000 dokumenteve të  
12 cilat na janë nxjerrë nga janari, ne vazhdojmë që të marrim  
13 materiale të tjera të cilat janë nxjerrë nga ZPS-ja dhe  
14 vazhdojnë të nxirren teksa flasim.

15 Sa i takon materialeve konkrete, nxjerrja sipas rregullit  
16 102(3) është një problem për ne, pra, kur dëgjojmë që mbase  
17 mund të ketë 700 dokumente të tjera që do të nxirren këto mund  
18 të jenë materiale që mund të jenë të rëndësishme, thelbësore,  
19 për ne, për Mbrojtjen. Kështu që, nuk është e qartë sesi  
20 Prokuroria i ka hapur parashtrimet e saj, domethënë, nga ajo  
21 çfarë tha Prokuroria nuk është e qartë se për çfarë  
22 dokumentesh bëhet fjalë. Dhe kam përshtypjen që bëhet fjalë  
23 për materiale që do të duhet të na ishin nxjerrë më përpara.

24 Lidhur me nxjerrjen sipas rregullit 103, ne nuk besojmë  
25 që na është dhënë i gjithë materiali që duhet të na ishte

1 dhënë mbështetur në këtë rregull. Ju kemi dhënë kërkesa të  
2 ndryshme Prokurorisë. Dhe as nuk kemi marrë përgjigje prej  
3 tyre. Do të vazhdojmë që t'i ngremë këto çështje. Dhe thjesht  
4 doja t'ju sillja në vëmendje që nuk kemi marrë gjë akoma.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendoj që  
6 është e vërtetë që nuk i keni marrë të gjitha gjërat.

7 Elementi i nxjerrjes së materialeve është një element  
8 thelbësor për procesin e rregullt gjyqësor dhe nuk është  
9 detyrë dytësore e Prokurorisë. Është çdo gjë që keni në  
10 zotërimin tuaj duhet që të ishte nxjerrë. Nuk ka asnjë arsye  
11 për këtë gjë, për mosbërjen e kësaj gjëje. Pra, e kuptoj për  
12 gjëra të cilat ndoshta i keni marrë dje ose pardje dhe duhet  
13 të jepni njoftim.

14 Por nga ana tjetër duhet të keni parasysh që ne do ta  
15 fillojmë procesin gjyqësor së shpejti.

16 Ju falënderoj për parashtrimet tuaja. Do t'i trajtojmë  
17 ato sa më mirë të jetë e mundur dhe sa më shpjet të jetë e  
18 mundur.

19 Do të kalojmë në çështje thelbësore tani.

20 Në paragrafin 9 dhe 10 të rendit të ditës, ne kemi  
21 identifikuar disa çështje thelbësore që do të donim që t'ju  
22 pyesnim dhe të kërkonim pikëpamjet tuaja. Është e qartë që  
23 Trupi Gjykses është në dijeni të konstatimeve të mëparshme për  
24 çështje që kanë të bëjnë me Gjykatësin e Procedurës Paraprake,  
25 me Gjykatën e Apelit dhe me Gjykatën Kushtetuese. Duam që të

1 jepni pikëpamjet tuaja që kanë të bëjnë me këto pika.

2 Duam që ju të jeni të shkurtër në atë çfarë do  
3 parashtrojnë. Nuk na duhet shumë kohë. Pra, le të mundohemi që  
4 të marrim dy deri në pesë minuta për t'ju përgjigjur pyetjeve.  
5 Nuk na duhet një gjysëm ore për secilin prej grupeve. Dhe  
6 pastaj, në qoftë se do të kemi pyetje plotësuese do t'i bëjmë  
7 ato.

8 Do të fillojë Gjykatësi Barthe. Atëherë pas dhjetë  
9 minutash do të bëjmë pushim, kështu që rekomandoj që Gjykatësi  
10 Barthe të bëjë pyetjen e parë dhe pastaj të bëjmë pushimin dhe  
11 të vijojmë me pyetjet e tjera.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Shumë faleminderit,  
13 Gjykatësi Smith.

14 Grupi i parë i pyetjeve është për ZPS-në dhe ka të bëjë  
15 me format e përgjegjësisë penale. Vërej që në paragrafin 176  
16 të aktakuzës, për procesverbal, është parashtrimi 00999/A03,  
17 që është versioni i redaktuar publik, ZPS-ja pretendon si më  
18 poshtë:

19 "përmes veprimeve dhe mosveprimeve të përshkruara më  
20 sipër, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup  
21 Krasniqi kryen përmes pjesëmarrjes së tyre në ndërmarrjen  
22 kriminale të përbashkët dhe/ose ndihmuan ose inkurajuan krimet  
23 e akuzuara në këtë aktakuzë. Përveç kësaj ose në alternativë  
24 Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi  
25 janë përgjegjës si eprorë për krimet e kryera nga vartësit e

1 tyre”.

2 Dëshiroj t’i pyes ZPS-së si më poshtë: Sipas teorisë së  
3 çështjes suaj, të akuzuarit janë kryes kryesor, bashkëkryes të  
4 NKP-së apo janë thjeshtë ndihmës dhe inkurajues të NKP-së?

5 Z. Prokuror, fjala për ju.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.  
7 Parashtrimi ynë është që ata janë kryes kryesorë të NKP-së.  
8 NKP-ja është një mënyrë e formave të përgjegjësisë penale.  
9 Pra, secila prej formave të përgjegjësisë penale, praktikisht,  
10 do të thotë që do të duhet që të trajtohet për të njëjtat  
11 fakte.

12 Në parashtrimin tonë nuk është e mundur, domethënë, është  
13 mundësisht faktike e mundur, megjithatë nuk është e mundur në  
14 aspektin ligjor në të drejtën ndërkombëtare penale për  
15 ndihmimin dhe inkurajimin e NKP-së. Dhe format e përgjegjësisë  
16 penale nuk mund të vendosen njëra mbi tjetrën dhe këtu, për  
17 shembull, mund t’ju jap si referencë, të nderuar Gjykatës,  
18 çështjen Kvočka, pra, vendimi i apelit në paragrafin 91.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

20 Kaloj tek pyetja tjetër. Është sërish pyetje për ZPS-në  
21 dhe ka të bëjë me të njëjtin paragraf të aktakuzës që sapo  
22 lexova.

23 Në pikëpamjen e ZPS-së, cila është marrëdhënia ndërmjet  
24 pjesëmarrjes në një NKP, ndihmës dhe inkurajimit dhe  
25 përgjegjësisë eprorë? Më konkretisht, a është e saktë që të

1    presumohet që në këtë çështje dy format e fundit, domethënë,  
2    - ndihma dhe inkurajimi dhe përgjegjësia eprore - thjesht  
3    pretendohen në alternativë, domethënë, në qoftë se Trupi  
4    Gjykues nuk i gjen të akuzuarit fajtorë për pjesëmarrjen në  
5    NKP? Dhe në qoftë se ky është parashtrimi juaj, na e thoni  
6    sepse mendoni kështu?

7           Z. HALLING: [Përkthim] Mund t'i përgjigjem kësaj pyetje,  
8    po në qoftë se, domethënë, do më duhet të shkoj pak më gjatë  
9    sesa ora 11.00.

10           Atëherë, siç thashë, mënyrat ose format e përgjegjësisë  
11    penale, pra, ngarkohen në alternativë. Pra, kjo do të thotë se  
12    kur elementët e më tepër sesa një forme përgjegjësie penale  
13    përbushen për të njëjtat fakte, atëherë dënimi mund të  
14    vendoset vetëm për njërin prej tyre.

15           Por, megjithatë konstatimi faktik për format e tjera të  
16    përgjegjësisë penale mund të merret parasysh në dënim. Për  
17    shembull: Kur elementët e të gjitha formave të përgjegjësisë  
18    penale përbushen për të njëjtat fakte.

19           Në parashtrimin tonë, dënimi duhet që të vendoset për  
20    formën e përgjegjësisë penale kryesore që reflekton më mirë  
21    fajësinë e të akuzuarve. Dhe këtë, në fakt, e kemi përmendur  
22    në paragrafin e aktakuzës që përmendët. Dhe është gjithashtu  
23    edhe pjesë e NKP I, NKP III, ndihmës dhe inkurajimi.

24           Siç kemi kërkuar në çështjen Gucati dhe Haradinaj, ne  
25    sërish i kërkojmë Trupit Gjykues që konstatimet të bëhen për



1 të gjitha format alternative të përgjegjësisë penale për të  
2 cilat akuzohen të akuzuarit.

3 Flasim për të njëjtat fakte. Në qoftë se ka një situatë  
4 ku ju të nderuar Gjykatës mendoni që dënime duhet të shprehet,  
5 të shqiptohet për një prej formave të përgjegjësisë penale për  
6 fakte të caktuara dhe një tjetër formë e përgjegjësisë penale  
7 për të tjerët, atëherë situata është që dënimi duhet që të  
8 vendoset për të dyja format e përgjegjësisë penale për faktet  
9 përkatëse. Aspekti kryesor këtu është që përgjegjësia penale  
10 individuale e të akuzuarit duhet të respektohet plotësisht.

11 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
13 vazhdojmë me pushimin.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Më lejoni që të them diçka ju lutem,  
15 sa i takon, pra, planit për seancat ne diskutuam me ZPS-në për  
16 planin. Jo se është vendosur ndonjë gjë përfundimtare nga  
17 Gjykata, por ne jemi konsultuar. Nuk e di, domethënë, në qoftë  
18 se do ta trajtoj tani apo jo.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kam një  
20 seancë të caktuar të parashikuar për këtë pyetje.

21 Në rregull. Do bëjmë pushimin tani dhe do mblidhemi  
22 përsëri në orën 11.30.

23 --- Pauza fillon në orën 11.01

24 --- Seanca rifillon në orën 11.29

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të

1 vazhdoni Gjykatës Barthe.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

3 Pyetja ime e dytë është gjithashtu për Prokurorin dhe ka  
4 të bëjë me format e përgjegjësisë penale sikurse thuhet në  
5 aktakuzë.

6 Z. Prokuror, a keni marrë parasysh përgjegjësi të tjera,  
7 forma të tjera të përgjegjësisë penale në këtë çështje, si për  
8 shembull, bashkëkryerjen ose kryerjen jo të drejtpërdrejtë apo  
9 të tërthortë.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Ju faleminderit. Përgjigjja jonë  
11 ndryshon varësisht nga forma e përgjegjësisë në diskutim. Për  
12 NPK II, kjo mund të ishte akuzuar. Për mendimin tonë është  
13 argumentuar në NPK I, NPK III si forma të përgjegjësisë. Për  
14 sa i përket bashkëkryerjes dhe kryerjes jo të drejtpërdrejtë  
15 për mendimin tonë këto nuk janë forma të përgjegjësisë sipas  
16 të drejtës ndërkombëtare zakonore. Për mendimin tonë këto janë  
17 forma të përgjegjësisë që zbatohen në Gjykatën Penale  
18 Ndërkombëtare, e cila nuk zbaton të drejtën ndërkombëtare  
19 zakonore. Në çështjen Stakic përkatësisht në vendimin e apelit  
20 në atë çështje, konkretisht në paragrafin 62, Trupi Gjykyes u  
21 përpoq të nxirrte vendim fajësie në bazë të bashkëkryerjes.  
22 Mirëpo ky vendim nuk u konfirmua në apel.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Kehoe, a keni koment  
24 lidhur me këtë?

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, disa pika të shkurtra. Mendoj që

1 pika e fundit ka të bëjë me përgjegjësinë komanduese. Mendoj  
2 që ka një farë ndryshimi midis pozicionit të Prokurorisë dhe  
3 atij të Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Mesa e kuptuam nga  
4 ZPS-ja, ata po argumentojnë një çështje në bazë të ndërmarrjes  
5 së përbashkët kriminale dhe ndihmës dhe inkurajimit dhe  
6 përgjegjësisë komanduese. Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe  
7 kjo ka të bëjë me përgjegjësinë komanduese si një krim *sui*  
8 *generis* dhe sipas tij kjo nënkupton NPK-në dhe përgjegjësinë  
9 komanduese dhe ndihmën dhe inkurajimin.

10 Në këtë fazë, të nderuar Gjykatës, do ta ndihmonte  
11 Mbrojtjen sikur ta dinim se çfarë po trajton Prokuroria në  
12 këtë aspekt.

13 Pika e dytë në lidhje me përgjegjësinë komanduese që nuk  
14 është e qartë dhe që është diskutuar dhe që mendoj se dhe  
15 Trupi Gjykues do sqarim - është se përgjegjësia komanduese  
16 ndahet në dy elementë, në atë civile dhe ushtarake. Një  
17 komandant ka domethënë arsyen, nevojën, detyrën që ta dijë.  
18 Duhet të siguroj se komandantët në terren e përçojnë,  
19 përcjellin mesazhin.

20 Përgjegjësia e eprorit në nivel civil është një barazim,  
21 ekuacion tjetër, sidomos kur është fjala për përgjegjësinë  
22 komanduese dhe këtu e kemi ndryshimin e mendimin midis  
23 qëndrimit të ZPS-së dhe mendimit të Gjykatësit të Procedurës  
24 Paraprake.

25 Sa i përket pyetjes në lidhje me NKP II, bashkëkryerjen

1 dhe kryerjen e tërthortë, këto nuk janë pretenduar në atë  
2 mënyrë. Në të kundërtën duhet të riformuloheshin në aktakuzë  
3 për shembull në qoftë se akuzohet në bazë të NKP II-shit, kjo  
4 duhet të ishte shtjelluar në atë mënyrë.

5 Pra përgjigjja jonë e thjeshtë në këtë është se nuk është  
6 pjesë e aktakuzës dhe në qoftë se jemi njoftuar për një gjë të  
7 tillë ne do të ngrinim kundërshtime në këtë drejtim.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Emmerson.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Falënderojmë Prokurorinë për  
10 sqarimin në lidhje me qëndrimin e tyre dhe nuk kemi asgjë për  
11 të shtuar në këtë moment.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Roberts.

13 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit Prokurorisë për  
14 sqarimin. Ne mund të pajtohemi në disa çështje ligjore se NKP  
15 III është pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare dhe se ato  
16 dy forma të tjera nuk janë.

17 Problemi që kam unë është autoriteti apo mungesa e  
18 autoritetit e Trupit Gjykses për të ricilësuar format e  
19 përgjegjësive në aktakuzë apo këto akuza. Sipas Gjykatës  
20 Penale Ndërkombëtare, Trupi Gjykses nuk ka një autoritetet të  
21 tillë. Prokuroria në qoftë se dëshiron që të ndryshojë ose të  
22 zgjerojë format përgjegjësive atëherë kjo varet nga procedura  
23 e përcaktuar në nenin 39(8) të Ligjit dhe rregullin 19 [sipas  
24 përkthimit].

25 Në qoftë se Trupi Gjykses ka një autoritetet të tillë

1 atëherë me siguri që një njoftim paraprak i palëve do të ishte  
2 i mirëseardhur.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Ellis apo  
4 znj. Alagendra.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Mendoj që jam unë ai që do të  
6 përgjigjet.

7 Thjesht të them se po përgatitemi në bazë të aktakuzës  
8 ashtu sikur e kemi kuptuar, pra tre forma të përgjegjësisë,  
9 NKP, ndihmë dhe inkurajim dhe përgjegjësi komanduese.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Ellis.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Do t'i përgjigjem shkurtimisht  
12 asaj që tha Mbrojtja e Thaçit.

13 Pyetja që parashtruat ju i nderuar Gjykatës ndryshon nga  
14 ajo që ka konstatuar Gjykatësi i Procedurës Penale. Gjykatësi  
15 i Procedurës Paraprake po konfirmonte kuadrin e aktakuzës se  
16 për ta bërë këtë duhet të nxirrte përfundime në lidhje me  
17 format alternative të përgjegjësisë penale.

18 Ajo që diskutuat tani janë format e përgjegjësisë penale  
19 që janë të ndërlidhura për qëllime të nxjerrjes së vendimit të  
20 fajësisë në fund të kësaj çështje.

21 Në lidhje me pyetjen e komandantëve civilë dhe ushtarakë,  
22 një dallim i tillë është bërë edhe në Gjykatën Penale  
23 Ndërkombëtare, mirëpo një dallim i tillë nuk bëhet në të  
24 drejtën penale zakonore për sa i përket ndryshimit të  
25 elementëve të veprës penale. Elementi kryesor në këtë është

1 kontrolli efektiv dhe këtë ne e kemi argumentuar në mënyrë të  
2 mjaftueshme në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Sa i përket pikës, më falni, në  
4 lidhje me pikën e parë për dallimin e mendimeve midis ZPS-së  
5 dhe Gjykatës të Procedurës Paraprake, i referohem i nderuar  
6 Gjykatës vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake, F000026  
7 dhe në atë dispozitë del qartë se ka një dallim midis  
8 qëndrimit të ZPS-së dhe përfundimeve të Gjykatësit të  
9 Procedurës Paraprake.

10 Për sa i përket mosekzistencës një dallimi midis së  
11 drejtës ndërkombëtare sa i përket përgjegjësisë komanduese në  
12 nivel ushtarak dhe civil, kjo nuk është e saktë sepse edhe  
13 Statuti i Romës ka pranuar disa dispozita që dalin nga e  
14 drejta ndërkombëtare zakonore, për sa i përket këtyre  
15 elementeve të ndryshme në lidhje me këto forma të  
16 përgjegjësisë penale.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani do t'i kthehem përsëri  
18 NKP-së. Në vendimin e konfirmimit të aktakuzës, parashtrimi  
19 F000026, versioni i redaktuar, dhe unë do t'i referohem këtij  
20 si 'Vendimi i Konfirmimit' në paragrafin 110, Gjykatësi i  
21 Procedurës Paraprake thotë dhe citoj:

22 "Kontributi i kryesit në këtij NKP-të nuk duhet të jetë i  
23 domosdoshëm ose i konsiderueshëm, por duhet të jetë më së paku  
24 një kontribut i qenësishëm ose thelbësor në krimet për të  
25 cilat ai ose ajo konstatohet se është përgjegjës."

1 Pyetja ime është kjo z. Prokuror: Së pari, a pajtoheni me  
2 këtë konstatim dhe në qoftë se po, atëherë cili është dallimi  
3 midis kontributit qenësor apo thelbësor dhe atij të  
4 konsiderueshëm? Ndoshta është një përgjigje e thjeshtë, po do  
5 të kisha kërkuar nga ju që të na jepni nga një shembull për të  
6 dy këto kontribute.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Sa i përket pyetjes nëse pajtohem  
8 me përfundimin e Gjykatës të Procedurës Paraprake. Po,  
9 përgjigjja jonë është po.

10 Për sa i përket pyetjes së dytë është mjaft abstrakte,  
11 por çfarë mund të themi nga mënyra sesi janë përkufizuar këto  
12 standarde në lidhje me kontributin në Tribunalin e Hagës duket  
13 që ky standard për sa i përket NKP-së i kontributit të  
14 qenësishëm, në dukje është më i ulët se i njëjti kontribut në  
15 ndihmë dhe inkurajim.

16 Dhe kjo lidhet me bazën teorike sesi është konstruktuar  
17 koncepti i ndërmarrjes të përbashkët kriminale. Varet pra  
18 tipizimi i kryesve kryesorë dhe ndihmësve apo i instrumenteve  
19 dhe për shkak të këtij dallimi midis kryesve kryesorë dhe  
20 ndihmësve në të drejtën zakonore ndërkombëtare, ne mendojmë që  
21 ky standard duhet të jetë relativisht më i ulët në krahasim me  
22 standardet e tjera.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Për sa i përket kontributit të  
24 dallimit midis atij të qenësishëm dhe të konsiderueshëm kjo  
25 është mjaft e qartë. E di që z. Smith i kujtohen debatet në

1 Gjykatat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në këtë aspekt  
2 dhe mendoj që Gjykatësi Smith nuk ka nxjerrë një përfundim të  
3 kënaqshëm në lidhje me këtë aspekt. Unë mendoj që ju si Trup  
4 Gjykses duhet të bëni një gjë mjaft të rëndësishme. Kontributi  
5 nuk mund të jetë i një farë interesi kalimtar por kontributi  
6 duhet të jetë diçka më shumë.

7 Kërkoj ndjesë për një farë shpjegimi kaq të shkurtër.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk jam i sigurt se ju  
9 kuptova si duhet z. Kehoe. A jeni duke thënë me komentet tuaja  
10 që pyetja ime ishte e mirë apo nuk ishte e mirë?

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Pyetja është që nuk ka ngatërresë  
12 midis kontributit qoftë të qenësishëm apo të konsiderueshëm.  
13 Në qoftë se merrni parasysh çështjen Brdjanin, aty zhvillohen  
14 diskutime në lidhje me këto dallime në kontributin.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, e kam të  
16 qartë.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në varësi të zhvillimeve apo  
18 kërkimeve të ardhshme, burimet ligjore mbështesin standardin e  
19 kontributit të qenësishëm.

20 Për sa i përket pyetjes që lidhet me paragrafin 3, ju siç  
21 e dini, ne si Mbrojtja mendojmë se NKP-III nuk zbatohet në  
22 lidhje me krimet e synimit e konkretë.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Asaj do t'i  
24 kthehem pak më pas i nderuar z. Emmerson.

25 Z. Roberts apo z. Tully.



1 Z. TULLY: [Përkthim] Kam një koment për të bërë përpara  
2 se t'i përgjigjem pyetjes. Nuk dua të nxjerr një farë kuptimi  
3 në qoftë se nuk ka, por z. Halling tha që në pyetjen e parë,  
4 përgjigjja jonë është:

5 "Po, pajtohem me Vendimin e Konfirmimit në lidhje me  
6 këtë pikë."

7 Kjo ndërlidhet me marrëveshjen midis palëve në lidhje me  
8 faktet e pajtuara. Ndoshta këtë duhet ta kemi parasysh kur të  
9 dëgjojmë z. Roberts, parashtrimet e tij.

10 Nuk kam diçka për të shtuar në ato që thanë kolegët e  
11 mirë. Kuptohem. Burimet ligjore flasin për dallime të  
12 konsiderueshme midis kontributit të qenësishëm atij të  
13 konsiderueshëm. Dhe për mendimin tonë duhet të vërtetohet  
14 kontributi i konsiderueshëm në nxjerrjen një vendimi të  
15 fajësisë në lidhje me këtë formë të përgjegjësisë. Do të shtoj  
16 edhe një gjë, të nderuar Gjykatës. Ekziston një farë kuptimi  
17 që ai thelbësor është më pak kontribut në krahasim me  
18 kontributin tjetër. Këtë e kemi cekur edhe në paragrafin 103  
19 të dosjes tonë paraprake.

20 Në qoftë se e leni këtë anash dhe në qoftë se merrni  
21 parasysh mendimin e Trupit Gjykes në Blagojeviç dhe Jokiç, në  
22 paragrafin 103 të atij aktgjykimi thuhet se, "të akuzuarit të  
23 përfshirë në një veprë penale duhet të formojnë një lidhje në  
24 një hallkë veprimesh". Sepse përkufizimi një veprim që nuk  
25 ndikon në një veprim penal, atëherë logjikisht nuk mund të

1 konsiderohet si i konsiderueshëm. Dhe me definicion është i  
2 parëndësishëm si kontribut. Kaq ishin parashtrimet e mia.  
3 Faleminderit.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Ellis.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Pajtohem me parashtrimin e fundit.  
6 Burimet ligjore e përcaktojnë kontributin e qenësishëm - më  
7 falni - të konsiderueshëm në krahasim me atë të  
8 konsiderueshëm. Pra duhet të ketë dhënë një i akuzuar  
9 kontribut të konsiderueshëm në kryerjen e një krimi. Dhe  
10 qëllimi i përbashkët që pretendohet është një koncept i  
11 paqartë dhe politik.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Ellis. Kjo  
13 ishte pikërisht pyetja ime në vijim, përkatësisht në qoftë se  
14 një anëtar i NKP-së besoj se do të përgjigjet, Prokuror -  
15 duhet të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme apo tjetër në  
16 NKP për kryerjen e një krimi, për të cilin pretendohet se  
17 është përgjegjës.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Kjo pyetje është e  
19 ngjashme me atë të mëparshme edhe pse tingëllon ndryshe.

20 Në jurisprudencën e TPNJ-së do të gjeni përfundime ku  
21 ndërmarrja e përbashkët kriminale ka të bëjë me planin e  
22 përbashkët, kurse kontributi me veprën penale. Në një fjali të  
23 vendimit të konfirmimit që me të cilin mendoj se të gjithë  
24 palët pajtohen, kjo formon dy pjesët e fjalisë varësisht nga  
25 mënyra si e lexoni fjalinë.

1 Ne parashtrojmë se këtu kur kontributi në realizimin e  
2 një plani kriminal - kjo është domosdoshmërisht edhe kontribut  
3 në kryerjen e krimit. Dhe për mendimin tim është ky kuadri i  
4 duhur analitik për vlerësimin e kontributit të akuzuarve në  
5 krimet që ju ngarkohen në bazë të formës së NKP-së.

6 Siç e shihni unë i kam kombinuar në përgjigjen time sepse  
7 nga aspekti analitik nuk mund t'i dalloni. Kontributi në një  
8 plan duhet të ketë ndikim në kryerjen e krimeve. Dhe vlerësimi  
9 në qoftë se kontributi në atë plan është i nivelit që përbën  
10 kontribut të konsiderueshëm kjo është çështje e një vlerësimi  
11 rast pas rasti.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Prokuror, mund të jetë  
13 edhe ndryshe, domethënë e kundërta në qoftë se kontributi në  
14 një krim mund të kontribuohet edhe në ndërmarrjen e përbashkët  
15 kriminale?

16 Z. HALLING: [Përkthim] Për shembull, një person mund të  
17 kontribuojë në një plan pa qenë pjesë e atij plani. Dhe mënyra  
18 si e dallon e drejta zakonore ndërkombëtare kryesin nga  
19 instrumenti është përmes ndihmës dhe inkurajimit.

20 Pra në fakt është e mundur që dikush të kontribuojë në  
21 realizimin e një plani të përbashkët në mendjen e tyre për të  
22 mbajtur përgjegjës në bazë të NKP-së.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Kehoe.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Për shembull, në qoftë se një i  
25 akuzuar bëhet pjesë e një marrëveshjeje që e dinë se është

1 marrëveshje kriminale duhet të ketë një farë lidhje në kuptim  
2 të NKP III-shit dhe Prokuroria duhet ta vërtetojë atë lidhje.  
3 Se patjetër duhet të ketë një farë lidhje. Nuk mund të ketë  
4 vetëm një gjë që e pa përshkruar apo e paditur që i lidh këto  
5 të dyja. Nuk mund të thuhet se çfarëdo që ndodhi në Kosovë  
6 ndodhi ashtu në vitin 1998-1999.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

8 Z. Emmerson.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ka mënyra të ndryshme të  
10 parashtrimit të dilemës në lidhje me atë se çfarë duhet të  
11 provojë Prokuroria për kontributin e konsiderueshëm. Dhe kjo  
12 varet nga faktet.

13 Mirëpo këtu parashtrohet pyetja jo thjesht në qoftë se ke  
14 kontribuar në kryerjen e një krimi konkret. Dhe mendoj që ky  
15 diskutim nxjerr në pah se kur dy apo në shumë njerëz bien  
16 dakord që të kryejnë një krim në juridiksionin e një  
17 Tribunali, atëherë është NKP. Mund të jenë dy njerëz që rrahin  
18 një njeri në një incident të vetëm apo mund të jetë një grup  
19 anëtarësh të UÇK-së në një objekt të caktuar. Mund të jetë  
20 politika e një komandanti vendor apo një komandanti zone.

21 Por, këtu parashtrohet pyetja se pse të gjithë këto krime  
22 të ndryshme janë pjesë e një NKP tjetër. Nuk kemi të bëjmë me  
23 një mëri të NKP-ve më të vogla, por është një NKP ombrellë që  
24 përfshin synimin për kryerjen e atyre krimeve. Për të kryer  
25 krimet që në atë kohë janë kryer në këtë terren në kuadër të

1 asaj politike.

2 Nuk mjafton të thuhet thjesht se ka pasur NKP. Pa dyshim  
3 që ka pasur një NKP kur dy apo më shumë kryes kryejnë një krim  
4 si pjesë e atij plani të përbashkët të NKP-së. Por pyetja që  
5 parashtrohet është, në qoftë se ka një NKP të përgjithshme  
6 ombrellë që përfshin të gjithë Shtabin e Përgjithshëm apo këtë  
7 të akuzuar apo të akuzuar tjetër. Dhe duhet të vërtetohet në  
8 qoftë se një NKP e tillë ka ekzistuar në atë kohë. Organizimi  
9 ishte i strukturuar vertikalisht dhe anëtarët e NKP-së në një  
10 mënyrë apo tjetër, përmes fjalëve, veprimeve apo politikave  
11 promovonin kryerjen e atyre krimeve dhe krimet në fakt u kryen  
12 në terren. Pra këto janë çështje që duhet të shqyrtohen në  
13 kuadër të këtij gjykimi.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

15 A keni ju diçka për të shtuar?

16 Z. Tully: [Përkthim] Jo.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po ju z. Ellis?

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dallimin që e  
19 mjegullon Prokuroria është dallimi midis një plani të  
20 përbashkët dhe që në vetvete është kriminal dhe një plani të  
21 përbashkët që nuk është kriminal. Sepse varësisht nga kjo, një  
22 kontribut i qenësishëm do të ishte dhe kontribut në kryerjen e  
23 veprës penale.

24 Mirëpo kur një plan i pretenduar në aktakuzë nuk është  
25 vetvete kriminal, atëherë ky dallim është mjaft i rëndësishëm.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
3 z. Barthe.

4 Mendoj që z. Mettraux ka disa pyetje ndërlydhëse.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Ellis kam një pyetje  
6 për ju, por vlen edhe për parashtrimet e disa kolegëve tuaj.  
7 Ju po sugjeroni që duhet të vërtetohet ekzistence e një  
8 lidhjeje të konsiderueshme midis sjelljes që i atribuohet një  
9 të akuzuari dhe vetë krimeve. A keni ndonjë jurisprudencë prej  
10 ku mund të citoni ndonjë përfundim faktik të një dhome  
11 gjyqësore apo trupit gjykues që vërteton se një person ish  
12 shpallur fajtor në bazë të NKP I apo NKP III për një krim, në  
13 të vërtetë ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në kryerjen e  
14 atij krimi. Pra, a keni ndonjë shembull që verifikon apo  
15 konfirmon ekzistencën e një lidhje të tillë. Këtë mund ta na e  
16 thoni tani ose të na jepni si referencë ndonjë moment të  
17 mëtejshëm.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk jam në gjendje t'ju jap një  
19 referencë të tillë tani. Mirëpo do t'ju them kështu, se  
20 kontributi i konsiderueshëm në kryerjen e një krimi është  
21 njëri nga hapat në përmbushjen e elementëve të krimit.

22 Por sigurisht që do të kërkoj ato referenca dhe do t'ju  
23 jap.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E di që jeni i aftë të  
25 jepni këto përgjigje, z. Ellis.

1 Kam edhe disa pyetje për Mbrojtjen. Do të filloj me z.  
2 Kehoe. Këtë e kemi diskutuar edhe në të kaluarën. Juve, z.  
3 Kehoe, edhe kolegët tuaj keni përmendur të ashtuquajturat  
4 krime të Serbëve.

5 Dhe do ta përmbledh qëndrimin tuaj se ZPS-ja nuk  
6 kundërshtonte pikën që forcat serbe kishin kryer krime kundër  
7 popullatës civile në Kosovë.

8 Gjithashtu ju dëshironi që prova që do të paraqisni në  
9 lidhje me këto krime mund të jenë të rëndësishme në lidhje me  
10 pika apo aspekte të tjera. Dhe ju dhe disa nga kolegët tuaj  
11 keni bërë të ditur që këto krime mund të kenë ndikim në  
12 efektivitetin dhe funksionimin e zinxhirit komandues të UÇK-  
13 së.

14 Tani ku janë këta tregues në bazë të cilëve ju pretendoni  
15 se këto krime mund të kenë pasur ndikim të arsyeshëm mbi  
16 funksionimin e UÇK-së. Mund të gjejmë një shembull që është  
17 shembulli i sulmit mbi familjen Jashari. Por nuk gjetëm asnjë  
18 shembull tjetër në dosjet e Mbrojtjes. Nuk dua që ta zgjasim  
19 diskutimin në lidhje me këtë, por thjesht dua që t'ju pyes në  
20 qoftë se nuk e kemi kuptuar këtë pikë sikurse e keni  
21 parashtruar në dosjen tuaj. Pra është fjala ku a ka di kund në  
22 dosjet tuaja një pjesë që flet për këtë aspekt dhe që neve nuk  
23 e kemi vërejtur?

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Unë do të flas për një pjesë të  
25 kësaj pike, kolegu im për një pjesë tjetër. Por të flasim se

1 çfarë ndodhi në pranverë të '99-s.

2 Gjatë sulmeve ajrore të NATO-s, ishte një orvatje e  
3 orkestruar e forcave serbe që të spastrojnë Kosovën nga  
4 popullata shqiptare. 800 mijë njerëz u dëbuan në vende të  
5 tjera, kurse 200 mijë e më shumë u zhvendosën brenda vendit.

6 Pra, brenda kësaj periudhe, zinxhiri komandues nuk i  
7 funksiononte UÇK-së. Shumë prej komandave u zhvendosën nga  
8 zonat ku ndodhnin krimet. Dhe është e rëndësishme që t'i  
9 kalojmë këto krime sepse e fusin në kontekst sjelljen për të  
10 cilën diskutojmë në pranverë të 1999-s.

11 Mirëpo e njëjta gjë vlen edhe për 1998-n, për verën e  
12 1998-s, kur u bë një ofensivë e madhe e forcave serbe, e cila  
13 në fakt e shkatërroi UÇK-në.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t'ju ndaloj aty.  
15 Arsyeja e pyetjes që po bëja është - për mua të paktën - ka  
16 një dallim të madh do të thoja midis atyre që quhen krime t;  
17 serbëve për një mungesë të një fjale tjetër dhe ofensivës  
18 serbe. Unë e kuptoj atë që thoni se veprimtaria ushtarake ka  
19 një efekt në forcat kundërshtarë.

20 Por, unë po pyes që nëse krimet që ua keni atribuar  
21 bashkë me disa kolegët tuaj forcave serbe, kanë pasur një  
22 efekt të tillë?

23 Nuk po ju kërkoj që të zhvilloni një diskutim të gjatë,  
24 por nëse diku në dosjen tuaj ka ndonjë shembull të vendit se  
25 ku këto krime - nuk flas për operacionet ushtarake - këto



1 krime kanë pasur efekt të dëmshëm në funksionimin e UÇK-së.  
2 Nëse nuk ka një shembull të tillë në dosjen tuaj, nëse në  
3 ndonjë fazë të procesit mund të na jepni ndonjë indikacion të  
4 këtyre incidenteve, sepse në këtë fazë është shumë vështirë të  
5 paktën për mua - t'i identifikoj ato.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Me kënaqësi do t'jua jepnim një  
7 listë të tillë duke u kthyer pastaj te 1988 [sipas përkthimit]  
8 lidhur me ndikimin që pati në popullsinë civile, në UÇK.  
9 Ndikimi në popullsinë civile dhe UÇK është shpesh i përzier.  
10 Do të kemi këtu dëshmi të ekspertëve lidhur me reagimin e UÇK-  
11 së, kampet e refugjatëve, apo ndryshe persona të zhvendosur në  
12 Maqedoni, në Shqipëri dhe në një farë mase në Mal të Zi. Dhe  
13 për se ata u kthyen, cili ishte motivi, veprimtaria që u  
14 zhvillua. Do të përcaktohet, do të provohet nëpërmjet  
15 dëshmitarëve, sepse njerëzit u kthyen me hakmarrjen në mendje.

16 Janë veprimtari të cilat Prokuroria po u paraqet sipas  
17 kategorive të ndryshme në përgjithësi dhe në veçori.

18 Dhe pastaj është një element tjetër në një pjesë të madhe  
19 të kësaj që është ai i vetëmbrojtjes. Këtë do t'i lutesha dhe  
20 kolegut tim ta trajtonte shkurt. Në qoftë se z. Milosheviç  
21 [sipas përkthimit] mund të flasë shkurt dy minuta.

22 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Z. Mettraux, afati i Mbrojtjes për  
23 paraqitjen e mbrojtjeve të tjera, parashtrimeve të tjera është  
24 e hënë dhe do t'i merrni po ashtu në përputhje me urdhrat  
25 tuaja.

1 Ne do ta ngremë çështjen e vetë Mbrojtjes që është  
2 paraqitur edhe në Statutin e Romës dhe që është vërtetuar ne  
3 aktgjykimin e Gjykatës.

4 Një tjetër është që duhet të provoni, duhet të provohet  
5 se ka pasur një kërcënim për një përdorim të menjëhershëm të  
6 paligjshëm të forcës. Është pra ky aspekti i paligjshmërisë,  
7 komponenti i paligjshmërisë që do të lidhej me vlerësimin tuaj  
8 që e ka ngritur dhe Mbrojtja në përgjigje të shumë çështjeve  
9 të Prokurorisë në dosjen e saj paraprake.

10 Për shembull në paragrafin 12 ka një pretendim se janë  
11 dërguar trupa nga të akuzuarit me trajnim minimal ose pa  
12 përvojë fare apo nuk ka pasur informacion për të drejtën  
13 humanitare. Vetëm për këtë pjesë kemi një pyetje: Popullsia që  
14 sulmohet e ka për detyrë të trajnojë njerëzit përpara se të  
15 mbrohen?

16 Pra, është një gjë që t'u thuash - siç thotë Prokuroria  
17 që janë kryer krime, por është një gjë tjetër për qëllimet e  
18 Mbrojtjes të thuash - Prokuroria e pranon se në të gjithë  
19 kohën që lidhet me këtë akuzë, ekzistonte përdorimi i  
20 menjëhershëm dhe i paligjshëm i anës serbe kundër popullsisë  
21 shqiptare. Kështu duhet formuluar mendojmë ne pyetja. Në qoftë  
22 se Prokuroria nuk e pranon këtë, atëherë neve na kërkohet të  
23 paraqesim prova se ekzistonte kërcënimi i përdorimit të forcës  
24 së paligjshme nga ana kundërshtarë që zbut çdo përgjegjësi për  
25 sa i takon të akuzuarit. Gjithashtu mund të lidhet edhe me

1 ndalimin apo me paraburgimin që është një çështje tjetër. Por  
2 një palë që sulmohet dhe që ushtron të drejtën e  
3 vetëmbrojtjes, çfarë të drejte ka ajo palë si një aktor jo-  
4 shtetëror në një konflikt të armatosur jo-ndërkombëtarë të mos  
5 përdorë për qëllimet e sigurisë, të parandalojë dikë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ka një pyetje tjetër për  
7 sa i takon çështjes së këtyre krimeve. Dhe unë e kuptoj se  
8 çështja po evoluon, çështja juaj si Mbrojtje për këtë çështje  
9 dhe do ta diskutojmë më vonë.

10 Por për sa i takon krimeve serbe, sa për tu sqaruar, nuk  
11 duket se sugjerohet nga ndonjëri prej jush, ekipet e Mbrojtjes  
12 se provat e krimeve serbe po ofrohen për zbutje, po për  
13 zvogëlimin e veprave. Është ky një sugjerim?

14 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Nuk e kuptoj fjalën tuaj "zbutje  
15 apo lehtësim". Është, ofrohet vetëmbrojtja për këtë qëllim.  
16 Mund t'ju siguroj se asnjë nga ne nuk do të ngrejë çështjen se  
17 ti je fajtor gjithashtu, *tu quoque*, pra që një veprim  
18 justifikohet nga një krim i kryer nga ana serbe. Pra nuk do të  
19 ndodhë një gjë e tillë kurrë nga ana jonë si element  
20 mbrojtjeje.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po i drejtohem z. Kehoe  
22 dhe Mbrojtjeve të tjera.

23 Bëhet fjalë për një çështje që shumë shkurt e përmendëm  
24 në dhjetor. Ka një referencë në dosjen tuaj në paragrafin 45  
25 dhe 61 tek Plani apo Operacioni Patkoi. Dëshiroj të di nga ju

1 se çfarë duhet, si duhet ta kuptojmë ne si Trup Gjykses, z.

2 Kehoe. Në veçanti dy gjëra.

3 E para, nëse ju ofroni të provoni ekzistencën konkrete të  
4 operacionit të një kontrolli të tillë. Pra ofroni të provoni  
5 këtë se një gjë e tillë në fakt ka ekzistuar? Dhe mbase nga  
6 pyetja ime do të kuptoni që është pak e ngarkuar si pyetje në  
7 masën që operacioni serb është vënë në diskutim, në  
8 pikëpyetje.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Ne do të provojmë se Operacioni  
10 Patkoi është një term që është përdorur edhe nga komuniteti  
11 ndërkombëtar, nga subjekte të tjera ushtarake që ishin, po  
12 analizonin situatën. E përdorim fjalën "Patkoi" sepse përdoret  
13 në një pjesë të madhe të literaturës.

14 Në vendimin Milutinoviç u gjet një konstatim. Z.  
15 McCloskey është i përgatitur për këtë, do ta trajtonte këtë  
16 çështje për sqarim të mëtejshëm.

17 Po ne do të provojmë se çfarë ka ndodhur, nëse Operacioni  
18 Patkoi ka ndodhur, gjë që është provuar edhe në çështjen  
19 Milutinoviç. Ka ndodhur në 1999 dhe u shpалos në formën e  
20 rrethimit të popullsisë, vënien në zjarr të shtëpive, djegien  
21 e fshatrave dhe të tjera dhe zhvendosjen e popullsisë në Mal  
22 të Zi [sipas përkthimit], Shqipëri dhe Mal të Zi. Dhe si  
23 pasojë e kësaj, jo vetëm lidhur me atë që ndodhi në atë kohë  
24 siç përmendi kolegu, çështjet e *mens rea* po *mens rea* e  
25 njerëzve që ktheheshin, aftësitë e tyre për të marrë hak. Gjë

1 që shpjegon shumë nga dhuna që ndodhi në atë kohë kur këta  
2 njerëz u kthyen, pra refugjatët, njerëzit e zhvendosur u  
3 kthyen në shtëpitë e tyre.

4 Po, do ta provojmë këtë.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju përgjigjët, por sipas  
6 mendimit tuaj. Ky element mendoni se është përgjegjës për  
7 barrën e Prokurorisë të provojë *mens rean* në lidhje me shumë  
8 nga krimet e aktakuzës?

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Po.

10 Në qoftë se më lejoni. Në qoftë se keni ndonjë pyetje  
11 tjetër, z. McCloskey është i përgatitur për këtë çështje dhe  
12 mund tu përgjigjet pyetjeve të tjera që mund të keni.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, po e dëgjova  
14 atë që doja të dëgjoja.

15 Nëse ka ndonjë parashtim tjetër për këtë çështje?

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mënyrën se si e keni sqaruar  
17 çështjen, i nderuar Gjykatës, më çon në një dallim midis  
18 sjelljes që ka ndodhur dhe ka pasur një ndikim në organizimin  
19 e UÇK-së nga njëra anë dhe të klasifikimit të kësaj sjelljeje  
20 si një vepër penale nga ana tjetër, kështu e kuptoj unë.

21 Sepse sipas parashtimeve tona nuk kufizohemi vetëm me  
22 ato çështje, për të cilat janë dhënë dënime apo shpallur  
23 fajtorë, po për çështje që kanë rëndësi për qëllimet e kësaj  
24 çështjeje, pra ndikimi i sjelljes së provuar me një  
25 përjashtim.

1 A mundet ta përmbledh shumë shkurt mënyrën sesi ngrihet  
2 kjo në dosjen tonë, por edhe si trajtohet nga trupe të tjera  
3 gjykuese ne TPNJ.

4 Nuk e di nëse e keni analizuar krimin dhe shpërndarjen e  
5 tyre për sa i takon kohës. Por shumica e krimeve në aktakuzë  
6 ka ndodhur në verën e 1998-s dhe në verën e 1999-s, me fjalë  
7 të tjera, pra grupet në të dyja anët. Në kohë kur duket qartë  
8 se UÇK-ja nuk kishte pothuaj asnjë lloj organizimi apo  
9 kapaciteti. Dhe ka një dallim të madh këtu sepse numri i  
10 krimeve është shumë i vogël midis këtyre dy periudhave që  
11 pretendon aktakuza dhe mendoj që kjo është një pikënisje e  
12 rëndësishme për këtë diskutim.

13 Në 1998-n, kishim operacionin e pranverës apo ofensivën e  
14 Serbëve që filloi me familjen Jashari vazhdoi me Haradinaj në  
15 24 mars dhe që shkatërroi të gjithë fshatrat.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Emmerson, ju po bëni,  
17 nuk po ju kritikoj, pikërisht atë që unë doja të shmangia. Nuk  
18 dua të futem në thelb.

19 Unë kam një pyetje shumë të thjeshtë. Në qoftë se na kanë  
20 shpëtuar indikacione në dosjen tuaj lidhur me krime që juve  
21 mendoni se kanë rëndësi për krimet do të ishim mirënjohës të  
22 na i vinit në dukje këto tregues, këto indikacione. Nuk duam  
23 të na recitoni të gjithë çështjen.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, po ka.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra unë dua të di ato ku

1 janë.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] E para është ofensiva e pranverës  
3 që filloi nga familja Jashari dhe që shkatërroi të gjithë  
4 fshatrat pastaj. Dhe kontrolli i të gjithë rrugëve kryesore që  
5 ishte kritike për mundësinë e organizimit të UÇK-së. Periudha  
6 e dytë e rëndësishme është ofensiva e verës serbe.

7 Siç mund ta shihni shumica e krimeve ka ndodhur midis  
8 këtyre ngjarjeve edhe gjatë ofensivës së verës. Për këtë  
9 periudhë kohe, është shumë e qartë dhe në çështjen e Haradinaj  
10 janë paraqitur prova, për këtë UÇK-ja nuk kishte mundësi as të  
11 kalonte, të ecte nëpër vend. Nuk përdornin dot automjete në  
12 rrugë, nuk kishin mjete komunikimi dhe ishin të detyruar të  
13 udhëtonin në rrugë dytësore, natën, që të mos i shikonin dhe  
14 t'i sulmonin.

15 Pra, kjo lidhet me organizimin e UÇK-së, në atë kohë kur  
16 bëhet fjalë për krimet që pretendohet se kanë ndodhur në  
17 aktakuzë dhe kjo është shumë e rëndësishme.

18 Pastaj kemi periudhën nga nëntori deri në prill kur ka  
19 një numër relativisht veprash penale që pretendohet që janë  
20 kryer në këtë aktakuzë.

21 Pastaj në 24 mars, 1999, një vit i plotë pas sulmit të  
22 Haradinaj, që është dhe fillimi i bombardimeve të NATO-s. Ajo  
23 që ndodhi menjëherë mbas bombardimeve, pastaj është një objekt  
24 i gjykimeve të tjera në TPNJ, pra fushata e krimeve kundër  
25 njerëzimit.

1 Tani për sa i takon Operacionit Patkoi, ne kemi përdorur  
2 një formulim tjetër në dosjen tonë. Unë e di dhe ju me siguri  
3 e dini se mohohet nga ana serbe dhe shumë historianë e  
4 diskutojnë se operacioni ushtarak është quajtur Operacioni  
5 Patkoi, që ishte një operacion formal zyrtar.

6 Ne e përshkruajmë si një plan që ka ekzistuar dhe kjo  
7 është provuar në TPNJ gjatë asaj periudhe për të kaluar nga  
8 pjesë verilindore e Kosovës për tu ulur poshtë në jug-perëndim  
9 dhe perëndim, siç e tha z. Kehoe, për ta zhvendosur popullsinë  
10 dhe duke proceduar duke ecur me shpejtësi të ndryshme me  
11 qëllim që çdo fshat pastaj ishte objekt i krimeve kundër  
12 njerëzimit dhe të gjithë njerëzit u detyruan të shkojnë drejt  
13 kufijve. Dhe në këtë proces, forcat serbe organizuan karvanë,  
14 automjete për t'i detyruar njerëzit të largoheshin nga Kosova.

15 Por erdhi një moment në mes të këtij evakuimi të detyruar  
16 përmes krimeve kundër njerëzimit që ata i mbyllën kufijtë dhe  
17 ata nuk janë akuzuar kurrë për gjenocid. Për ne, qëllimi,  
18 synimi i gjenocidit ishte pranishëm, të paktën për atë çast  
19 dhe për një periudhë të konsiderueshme më pas. Në atë fazë një  
20 pjesë e popullsisë është targetuar për gjenocid, ata që kanë  
21 mbetur në Kosovë.

22 Ua dhashë këtë sepse në përgjigje të kësaj situate dhe  
23 menjëherë pas armëpushimit, të gjithë njerëzit kthehen dhe ka  
24 qindra armë në duar të njerëzve dhe atëherë e shohim dhe  
25 kryerjen e grupit të dytë të krimeve. Njerëzit e kthyer në



1 Kosovë mundësisht ka dhe gjasa që të jenë kryer në hakmarrje,  
2 por jo në një situatë ku UÇK-ja kishte kontrollin e  
3 popullsisë.

4 Të gjitha këto gjëra duhen shqyrtuar, qoftë nëse e merrni  
5 si çështje fakti apo si çështje ligji, që është e qartë se  
6 dënimet ne TPNJ ishin pjesë e dokumentacionit. Ajo që ka  
7 rëndësi nuk është dënimi, por është ajo që ka ndodhur. Dhe  
8 këtu është ndërprerë aftësia e UÇK-së për të kontrolluar  
9 personat që mund t'i kenë kryer këto krime dhe aftësia e saj  
10 për të pasur mjetet dhe strukturat që pretendon.

11 Çështja nuk është që ZPS-ja i pranon që janë kryer krime  
12 por se nuk mund të marrësh vendime si Trup Gjykues për  
13 strukturën komanduese, për autoritetin operacional kur nëse  
14 udhëheqësit kishin dijeni dhe kishin mundësi të parandalonin  
15 ose të ndëshkonin apo për kërkesat që kanë qenë të nevojshme  
16 pa e kuptuar nëse sjellja e forcave apo e ofensivës serbe i  
17 shtynte njerëzit të bënin ato që bënin.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Duam ta bëjmë të qartë dhe  
19 unë mendova se ishte e qartë nga pyetja që bëra. Ka vetëm një  
20 grup krimesh për të cilët ne jemi të interesuar në këtë  
21 gjykim. Dhe nuk pranojmë pastaj ushtrim tjetër në ekuivalencë  
22 morale apo diçka të ngjashme. Nuk po ju ftoj të bëni  
23 parashtrime të tjera. Thjesht po theksoj faktin se ideja që  
24 kemi ne tani është se provat e veprimeve të tilla qofshin  
25 krime apo operacione do të paraqiten, nëse do të paraqiten

1 lidhur me ndikimin që kanë pasur në zinxhirin e komandës që  
2 lidhet me çështjen tonë. Ky është kuptimi që dua të kini.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, mund të nxirren konkluzione  
4 nga këto.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Roberts.

6 Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit. Do të flas shkurt.

7 Për të komentuar komentet e kolegëve unë e kuptoj pyetjen  
8 tuaj si një ushtrim për të na informuar për provat që duhet të  
9 paraqesim të cilat duhet të lidhen me akuzat për krimet e  
10 mbuluara këtu. Dhe në dosjen tonë paraprake kemi trajtuar edhe  
11 çështjen e krimeve serbe. Edhe pse nuk e kemi lidhur  
12 drejtpërdrejt me këto çështje, do ta bëjmë këtë si Mbrojtje e  
13 Thaçit, ta lidhim me çështjet që mund të prekin komandën,  
14 kontrollin e UÇK-së, duke përfshirë atë që tha z. Kehoe,  
15 motivim për hakmarrje për shpagim. Nuk do të citohet si  
16 retorikë, thjesht do t'i përmendim, nuk do të paraqesim prova.  
17 E kuptojmë dhe qëndrimin tuaj, udhëzimin që na jepni duke  
18 thënë se ju jeni këtu për të përcaktuar përgjegjësinë penale  
19 në këtë çështje.

20 Por ne besojmë dhe themi se ka vende ku krimet serbe do  
21 të ishin me rëndësi për përcaktimin e kësaj fajësie. Dhe në  
22 kohën e duhur do të bëjmë parashtrimet e duhura dhe besojmë që  
23 ju do të kënaqeni me parashtrimet tona. Faleminderit. Do të  
24 bindeni nga ato.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] Sa për të thënë dhe unë diçka. Një

1 çështje që desha ta ngrija është fakti që pranimi i këtyre  
2 krimeve nga Prokuroria është kaq i përgjithshëm, kaq i vakët  
3 sa nuk na lejon që të paraqesim prova më konkrete dhe ju e  
4 kërkoni këtë konkretësi për të provuar krimet për të cilat  
5 akuzohen. Ne nuk e diskutojmë ekzistencën e krimeve serbe por  
6 Prokuroria nuk na lejon ta bëjmë këtë.

7 Për ta bërë këtë nuk e pranojmë atë që thotë Prokuroria  
8 se na ka dhënë informacion apo prova të mjaftueshme për të na  
9 lejuar ta bëjmë këtë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Ellis.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Ne bashkohemi me të gjitha ato që u  
12 ngritën nga ekipet e Mbrojtjes, por më duket se kjo çështje e  
13 kalon më tej thjesht çështjen e zinxhirit të komandës.

14 Ne bashkohemi me ato që tha z. Kehoe lidhur me  
15 hakmarrjen, shpagimin si motivim për kryesit që është një  
16 çështje e rëndësishme mendojmë në këtë proces. Sigurisht nuk  
17 kemi synim që të paraqesim prova. Ne thjesht duam të përlligjim  
18 rëndësinë e pyetjeve që bëjmë.

19 Gjithashtu pajtohem me parashtrimin e z. Roberts që bëri  
20 tani se cila është vlera provuese për ne kur Prokuroria në  
21 përgjithësi nuk e diskuton faktin që janë kryer krime serbe.  
22 Pra bëhet fjalë për konkretësi që na duhet për t'i dhënë peshë  
23 qëndrimit tonë.

24 Problemi që kemi është se kur i paraqesim Prokurorisë  
25 fakte për këto krime, përgjigjja që marrim është jo. Pra,

1 ndërsa Prokuroria është e gatshme të dalë dhe të thotë në  
2 përgjithësi që kam pasur krime, nuk pajtohen konkretisht për  
3 ato që ne them, paraqesim.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam një pyetje të fundit,  
5 pastaj do t'i drejtohem Prokurorisë. Diçka që z. Kehoe jeni  
6 objekti. Pastaj z. Roberts sepse ai bëri një koment për këtë  
7 gjë.

8 Nga parashtrimet tuaja kuptojmë nga disa nga dosjet  
9 paraprake tuajat, kemi parë që disa apo ndoshta të gjithë ju  
10 diskutoni ose ekzistencën e NKP-së si një teori në të drejtën  
11 zakonore ndërkombëtare apo si një sugjerim nëse është apo jo e  
12 pranueshme në këtë juridiksion.

13 Duke mos kërkuar diskutimin nga ju për sa i takon  
14 themelësisë së saj, po ju pyes nëse ka një vendim nga Paneli i  
15 Gjykatës së Apelit të këtij Tribunali që thotë, po, ekziston  
16 në të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe po, përdoret edhe për  
17 këtë juridiksion, zbatohet.

18 Me sa kuptoj unë parashtrimet tuaja janë kundër kësaj,  
19 kundër thelbit të këtij vendimi. Dhe jam i interesuar t'ju  
20 pyes, Ç'kërkoni nga ne lidhur me këto konstatime të Gjykatës  
21 së Apelit? T'i injorojmë? Të dalim me një mendim më të mirë se  
22 ta sipas jush? A nuk jemi të detyruar ne të respektojmë  
23 mendimet e Gjykatës së Apelit? Cilat do të ishte baza për  
24 parashtrimet tuaja dhe çfarë kërkoni nga ne? T'i rikthehemi  
25 dhe njëherë diskutimit lidhur me ekzistencën e kësaj doktrine?

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Ne mendojmë që është një çështje e  
2 gjallë. Kam përgjigje të dyfishtë dhe z. Ellis do të flasë për  
3 pjesën e parë, unë pjesën e dytë. Mund ta shpejtojmë  
4 diskutimin nëse më lejoni.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Ellis.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mbase është një  
7 çështje që del nga mënyra si e kemi trajtuar ne këtë çështje  
8 në dosjen paraprake. Siç e dini më së miri historia e kësaj  
9 çështjeje është se ne e kemi ngritur këtë në një mocion në  
10 prill përpara Gjykatësit të Procedurës Paraprake se nuk e  
11 pranojmë ekzistencën e NKP-së, sidomos NKP-III sipas të  
12 drejtës zakonore në atë kohë, në 1998-1999. Sigurisht nuk do  
13 të futemi sot në çështjet përkatëse. Kjo u hodh poshtë nga  
14 Gjykatësi i Procedurës Paraprake atëherë, por nuk mbaroi  
15 historia aty për sa i takon historisë procedurale.

16 Sepse ne pastaj e dërguam çështjen në Dhomën e Gjykatës  
17 Kushtetuese. Në bazë të nenit 33(1) të Kushtetutës së Kosovës,  
18 z. Krasniqi ka të drejtë të mos akuzohet për një vepër që s'ka  
19 qenë pjesë e të drejtës ndërkombëtare zakonore në atë kohe. Në  
20 përgjigje të kësaj morëm një numër pyetjesh nga Gjykata  
21 Kushtetuese, nga paneli i kësaj Gjykate dhe është në vendimin  
22 e parashtrimeve të mëtejshme, numër 5. Ne bëjmë pyetjen (C):

23 "Duke qenë se procedura penale kundër kërkuesit vazhdon,  
24 a këtë të drejtë kërkuesi ta ngrejë, të paraqesë ankesë në  
25 bazë të nenit 33(1) të Kushtetutës dhe të nenit 7 lidhur me

1 ndërmarrjen e përbashkët kriminale.”

2           Nga pikëpamja e Dhomës së Gjykatës Kushtetuese, pasi ia  
3 bëmë këtë pyetje, ata nuk menduan se mund të mos e ngrinin  
4 përsëri këtë argument përpara jush. Ata e hodhën poshtë  
5 referimin tonë si të parakohshëm. Prandaj dhe ne themi se  
6 çështja është ende e gjallë, në kuptimin është ende në  
7 diskutim, sepse nuk është momenti i akuzës, por momenti  
8 shpalljes fajtor dhe çdo shpallje fajtor do të vijë nga  
9 vendimet tuaja. Ju jeni ata që do jepni vendimin. Dhe ne  
10 pastaj në bazë të nenit 33(1) ne mund ta kundërshtojmë.  
11 Prandaj themi është një çështje ende e gjallë, ende në  
12 diskutim. Ne do ta ngremë këtë çështje nga çdo këndvështrim që  
13 mundemi dhe për ta bërë këtë duhet sigurisht të ruajmë të  
14 drejtën tonë t’i drejtohem Dhomës së Gjykatës Kushtetuese,  
15 por pasi t’i kemi shteruar të gjitha mjetet ligjore. Prandaj e  
16 bëjmë këtë gjë këtu.

17           GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Ellis, si një çështje  
18 vijuese, e kuptoj atë që thoni lidhur me Gjykatën Kushtetuese.  
19 Por nuk jam i qartë dhe kjo na shqetëson si Trup Gjykues. Cila  
20 është marrëdhënia jonë me vendimin e Gjykatës së Panelit  
21 lidhur me të drejtën e saj për të pasur efekt detyrues. Dhe e  
22 dyta, kjo mbase është për z. Kehoe - çfarë kërkon nga ne? T’i  
23 rikthehem dhe një herë çështjes së Tadiç apo Lynch dhe të  
24 vijmë në mendimin se këtu nuk kemi të bëjmë me NKP apo nuk  
25 zbatohet nuk përdoret në këtë juridiksion. Këtë po ju kërkoj

1 të na thoni.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] A është e mundur që t'i kthehemi  
3 urdhrit të aktakuzës për ta bërë këtë gjë lidhur me çfarë  
4 është vendosur më përpara dhe çfarë ngelet për tu vendosur.  
5 Pra, desha të shtoja atë që tha Mbrojtja e z. Krasniqi, ta  
6 shpjegoj dhe qëndrimin tonë.

7 Është një arkitekturë bizantine që është vendosur këtu.  
8 Apeli është bërë në bazë të nenit 33(1) dhe ne diskutuam  
9 përkthimin shqip dhe anglisht, ku thuhet se askush nuk duhet  
10 të akuzohet apo të dënohet për një vepër, e cila nuk përbën  
11 ndonjë vepër penale në atë kohë.

12 Sepse ka një ndryshim midis versionin shqip dhe serb. Në  
13 versionin serbisht thotë, askush nuk duhet shpallur fajtor dhe  
14 dënuar. Pra për sa i takon ligjshmërisë të nenit 33(1) kjo  
15 duhet përdorur në fazën e shpalljes fajtor se mund të akuzosh  
16 dikë sipas Kushtetutës së Kosovës për diçka që nuk ka qenë  
17 shkelje në atë kohë, por nuk mund ta dënosh për atë gjë.

18 Pra ne jemi këtu ku jemi. Dhe jeni ju që keni të drejtë  
19 të vendosni për këtë çështje kushtetuese: Pra, a mund të  
20 dënoni tani në përputhje me nenin 33(1) të Kushtetutës dhe  
21 pastaj duhet të përdorni argumentet e ngritura ndërkohë nëse  
22 NKP-janë ka qenë pjesë, e parashikuar në drejtën zakonore në  
23 atë kohë.

24 Ajo që vendosni ju mundet apo jo të diskutohet më tej në  
25 Gjykatën e Apelit dhe të përfundojë në Gjykatën Kushtetuese

1 për të parë pastaj nëse është kushtetuese apo jo. Por neve  
2 thamë atë që mendoni lidhur me interpretimin e Gjykatës  
3 Kushtetuese që nuk bëni ashtu siç menduam ne dhe jemi këtu ku  
4 jemi.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Bizantine, por e qartë.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Është absolutisht e qartë. I  
7 nderuar Gjykatës, juve bëtë dy pyetje. Domethënë në qoftë se  
8 koncepti i NKP-III është i zbatueshëm në atë kohë. Dhe së dyti  
9 pyesni në qoftë se kjo transpozohet në mënyrë të duhur dhe të  
10 ligjshme në të drejtën kosovare, ku ligji në vetvete duhet t'i  
11 nënshtrohet parashikimeve kryesore të Kushtetutës dhe  
12 Kushtetuta efektin prapaveprues. Dhe e dini se çfarë ka  
13 vendosur Gjykata përkatëse. Domethënë, ti nuk mund të ngresh  
14 një padi për NKP-në në qoftë se një vepër e tillë nuk është  
15 parashikuar në kohën e kryerjes së krimit sepse një gjë e  
16 tillë nuk parashikohet në Kushtetutën e Kosovës. Domethënë  
17 kemi dy elementë, të cilët duket sikur janë pjesë e të njëjtit  
18 diskutimi. Domethënë nga njëra anë kemi Kushtetutën e Kosovës  
19 ndërkohë që nga ana tjetër kemi këtë Gjykatë që duket sikur  
20 lejon, domethënë që protagonistët e vetëm të mund të akuzohen  
21 dhe të gjykohen për NKP-në. Kështu që do të duhet të shikohet  
22 ndërlidhja ndërmjet të drejtës ndërkombëtare dhe Kushtetutës.

23 Ndërkohë në dy kërkesat përpara, që është kërkesa e z.  
24 Krasniqi e para që i është dërguar Gjykatës përkatëse, pra  
25 Gjykatës së Apelit dhe pastaj kemi dhe kërkesën tonë.



1 Domethënë cila është lidhja ndërmjet Kushtetutës së Kosovës  
2 dhe të drejtës ndërkombëtare? Dhe në të dyja kërkesat tona,  
3 domethënë ne i referohemi dikotomisë ndërmjet asaj që ju  
4 përmendët, domethënë akuzimit dhe gjetjes ose konstatimit  
5 fajtor.

6 Pra kemi diskutimin që ka të bëjë me versionin në  
7 serbisht të Kushtetutës së Kosovës dhe versionit në shqip dhe  
8 në anglisht të Gjykatës, domethënë të Kushtetutës së Kosovës.  
9 Ndërkohë që në qoftë se do t'i referohemi të drejtës  
10 ndërkombëtare ti nuk mund të marrësh një vendim fajësie në  
11 qoftë se nuk ekziston një lidhje, një parashikim ligjor më  
12 përpara për veprën, për të cilën akuzohen personat në fjalë.

13 Kështu që ne parashtrojmë që kjo zgjidhje është e  
14 parakohshme dhe mendojmë që çdo gjë përtej asaj çfarë ka  
15 shprehur Gjykata Kushtetuese, çështja akoma nuk ka marrë  
16 zgjidhje përfundimtare, pra çështja duhet që të vendoset.

17 Ndërkohë që vendimi që ka të bëjë me 13 qershorin e vitit  
18 2022 është një parashtrim që ka shumë zero dhe pastaj ka 10,  
19 përfundon me 10 në fund. Pra është parashtrimi i datës 13  
20 qershor. Në pjesën e dytë është pjesa që ka të bëjë me z.  
21 Veseli shpjegon sepse është arritur në përfundimin që akuza  
22 nuk zbatohet dhe kalojmë tek pjesa e dënimit.

23 "Dhe nga ana tjetër është e rëndësishme" dhe në qoftë se  
24 do të doni mund t'i referoheni paragrafit 61 për më tepër  
25 qartësi. Dhe në këtë paragraf parashikohet që, "në vlerësimin

1 e vet pa paragjykuar përcaktimin e ardhshëm të ankesave dhe të  
2 parashtrimeve, që ka të bëjnë me shkelje të nenit 3 dhe të  
3 nenit 7 të Konventës”.

4 Domethënë me fjalë të tjera nuk është se ka një vendim  
5 kundër nesh. Kjo është një çështje e cila duhet të vendoset  
6 prej jush. Është një çështje e cila nuk është shumë e  
7 drejtpërdrejtë për tu zgjidhur.

8 Është e vërtetë që ka disa komente dhe disa ngjarje, të  
9 cilat duhet që t’i merrni parasysh, por sigurisht që ju nuk  
10 detyroheni dot nga ne. Dhe ndërkohë ka çështje të cilat do të  
11 duhet që të shqyrtohen prej jush. Ajo që duhet të vendosë  
12 pikësëpari Trupi Gjykues është së pari, A duhet që të presim  
13 ne deri në fund të gjykimit? Pra, ju a jeni të detyruar nga  
14 fakti që dhoma e Gjykatës Supreme mendoi që ky kundërshtim  
15 është i parakohshëm për momentin. Domethënë ideja dhe pyetja  
16 për juve është, A do prisni deri në fund fare?

17 Dhe përgjigjja që do të kemi ne për këtë pyetje është,  
18 Jo, nuk duhet të prisni deri në fund të gjykimit, se kjo është  
19 një situatë e tillë që në qoftë se ju mendoni që kundërshtimi  
20 kushtetues për efektin prapaveprues nuk është i bazuar, nuk  
21 duhet të prisni deri në fund të gjykimit për këtë gjë. Pra  
22 sepse mënyra sesi është strukturuar ky gjykim, pyetja që duhet  
23 të bëhet është, Në qoftë se do të jetë e mundur për këtë  
24 proces gjyqësor që në fund ne të arrijmë në përfundimin që në  
25 fakt nuk mund të shpallim dënim mbi NPK-në. Sepse kjo ka

1 lidhje të jashtëzakonshme me akuzat që janë ngritur në  
2 aktakuzë.

3 Kështu që ky është një vendim i rëndësishëm për t'u  
4 marrë. Ju pa diskutim i keni kompetencat për ta marrë këtë  
5 vendim. Sepse sipas testit të viktimave ose Strasburgut, ti  
6 nuk mund të pretendosh që të jesh viktima, një shkelje vetëm  
7 duke qenë përgjegjës ose duke u akuzuar.

8 Këto zotërinj që kemi këtu nuk është se janë akuzuar  
9 vetëm, por janë mbajtur në paraburgim. Kështu që pa diskutim  
10 janë viktima në qoftë se do ta interpretojmë mungesën e  
11 aftësisë prapavepruese. Dhe për këtë arsye domethënë është e  
12 rëndësishme për juve që të vendosni në qoftë se ka ekzistuar  
13 NPK-ja apo jo në atë kohë. Ju keni një vendim detyrues të  
14 Gjykatës së Lartë Serbe që parashikon që ti nuk mund t'i  
15 dërgosh këta burra në gjykim, pra sipas interpretimit të  
16 Gjykatës së Lartë Serbe, sa i takon interpretimit të NPK-së.  
17 Kështu që për këtë arsye është e rëndësishme për juve për të  
18 vendosur se nuk mund të thuash se ky interpretim vlen për  
19 serbët por nuk vlen për kosovarët. Nuk është se dua të ngre  
20 ndonjë argument politik, por neve duam që ju të keni  
21 justifikim të qenësishëm dhe të mos bëni dallim le të themi në  
22 interpretim. Dhe për këtë arsye pozicioni jonë është se ju  
23 duhet ta trajtoni këtë çështje dhe të merrni një vendim lidhur  
24 me të.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Roberts.

1           Z. ROBERTS: [Përkthim] Kam shumë pak për shtuar, të  
2 nderuar Gjykatës. Jemi plotësisht dakord me pozicionet e të dy  
3 kolegëve.

4           I vetmi paralel që mund të nxjerr nga gjykata të tjera,  
5 që mund t'ju ndihmoj është mënyra sesi është trajtuar NPK-III  
6 në Kamboxhia. Gjykatësit ose Trupi Gjykses e kanë vendosur në  
7 këtë rast që në 1975-n deri në 1979-n u vendos që NPK-III nuk  
8 ishte pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare. Pra ndërkohë  
9 në nivele më të larta të gjykimit, vendimi u tjetërsua dhe  
10 bashkë-prokurorët pra kërkuan që mbas këtij niveli më të lartë  
11 të mund të trajtohej ky vendim përsëri. Me aq sa dimë neve u  
12 vlerësua, u rivlerësua prania e NPK-III në bazë të të drejtës  
13 ndërkombëtare zakonore dhe pastaj u mbërrit përsëri në të  
14 njëjtin përfundim që NPK-III nuk është pjesë e të drejtës  
15 ndërkombëtare penale.

16           Kështu që për këtë arsye, Prokuroria pra bëri atë çfarë  
17 ne të gjithë dimë, pra shkuan edhe në Gjykatën Supreme dhe me  
18 sa mbaj mend, shkaqet procedurale u rrëzuan.

19           Por, me fjalë të tjera çfarë po mundohem të them është që  
20 ka deri në një farë mase precedentë nga gjykata të tjera që  
21 mund të merren parasysh nga ky Grup Gjykses dhe këto janë  
22 çështje të cilat janë me rëndësi.

23           GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Ellis.  
24 Ndonjë gjë tjetër për të shtuar.

25           Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kam gjë tjetër për të shtuar.

1 Faleminderit.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] ZPS-ja shkurtimisht ndonjë  
3 gjë për të thënë?

4 Z. QUICK: [Përkthim] Shumë shkurtimisht, të nderuar  
5 Gjykatës.

6 Korniza e kësaj Gjykate është shumë e qartë. Është e  
7 ndryshme nga Kamboxhia. Në këtë fazë Gjykatësit e këtij Trupi  
8 Gjykses nuk kanë kompetencë që të rishikojnë vendimet e  
9 Gjykatës së Apelit. Një gjë e tillë është e parashikuar qartë  
10 në dispozitat ligjore.

11 Pra sa i takon apeleve të ndërmjetme, këto parashikohen  
12 në rregullin 45 të Ligjit dhe në rregullin 77 dhe 97. Këto  
13 dispozita janë hartuar në bazë të dispozitave të ngjashme të  
14 gjykatave të tjera ndërkombëtare dhe synojnë që t'i shërbejnë  
15 të sigurisë juridike dhe të drejtësisë të procesit.

16 Pra Gjykata e Apelit ka zbatuar jurisprudencën e  
17 gjykatave të tjera dhe ka vendosur ashtu siç ne të gjithën e  
18 dimë dhe kjo është e drejtë e vetëm së Gjykatës së Apelit që  
19 ka kompetencën për të rishikuar vendimet e veta. Ndërkohë që  
20 Gjykatat e nivelit të mëposhtëm nuk kanë të drejtë që të bëjnë  
21 rishikimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit.

22 Në përmbyllje më lejoni të theksoj se përveç  
23 juridiksionit dhe vendimit të juridiksionit që konstaton që  
24 NPK-ja është pjesë e juridiksionit të Dhomave të  
25 Specializuara. Gjykata e Apelit ka pasur një tjetër mundësi që

1 të rishikojë këtë konstatim në çështjen Shala dhe ka nxjerrë  
2 një tjetër vendim që konfirmon juridiksionin.

3 Pra, kjo është një çështje e zgjidhur, ndërkohë që sa i  
4 takon jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese që u përmend nga  
5 Mbrojtjet i referohet shterimit të mjeteve juridike që i  
6 drejtohen specifikisht Gjykatës Supreme dhe pistave të  
7 ndryshme të mundshme potenciale për palët në mënyrë që të mund  
8 të kalojnë në një shkallë të tretë gjykimi.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

10 Z. Laws.

11 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të shtuar lidhur me  
12 këtë temë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kam  
14 përshtypjen që Gjykatësi Barthe ka dhe një pyetje tjetër për  
15 të bërë?

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nëse më lejoni, po.

17 Një moment ju lutem.

18 Kam një pyetje të fundit. Dua të filloj me ZPS-në. Ka të  
19 bëjë me NPK-III, në veçanti lidhur me synimin konkret.

20 Në paragrafin 112 të Vendimit të Konfirmimit, përcaktohet  
21 si më poshtë:

22 "Sa i takon NPK-I, kryesi duhet të ketë synim të njëjtë  
23 me pjesëmarrësit e tjerë për të kryer krimet që përbëjnë pjesë  
24 të synimit konkret".

25 Nga ana tjetër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake

1 konstatoi në paragrafin 117 dhe 122 të të njëjtit vendim që  
2 duhet që të identifikohet synimi i veçantë apo synimi konkret  
3 i kryesit kryesor ose i varësve të tij.

4 Kështu që pyetja që kam për juve është kjo: Çfarë mund të  
5 thoni sa i takon NPK-III? A është e rëndësishme që të  
6 konstatohet synimi konkret sa i takon gjenocidit ose krimeve  
7 të ndjekjes penale apo jo?

8 Z. HALLING: [Përkthim] Ne e kemi trajtuar pak a shumë  
9 këtë pyetje, megjithëse kjo është një çështje e cila është  
10 lënë e hapur pas vendimit për të mocionet paraprake. Në  
11 parashtrimin tonë, NPK-III zbatohet për krime që kanë të bëjnë  
12 me synime konkrete. Dhe synimi konkret nuk është i nevojshëm  
13 në mënyrë të tillë që të përcaktohet përgjegjësia penale  
14 lidhur me NPK-III.

15 Ka forma të ndryshme të përgjegjësisë penale. Ju keni  
16 përmendur dy prej tyre, përgjegjësia eprore që lejojnë të  
17 akuzuarin të ketë një *mens rea* të ndryshëm për kryesit jo të  
18 drejtpërdrejtë. Ndërkohë që NPK-III është thjesht një tjetër  
19 formë e këtyre formave të përgjegjësisë penale.

20 Në parashtrimin tonë, ky vendim nuk e bën dallimin  
21 ndërmjet *mens rea* për krijimin dhe *mens rea* për formën e  
22 përgjegjësisë penale.

23 Sikurse e përmenda, megjithëse thelbi i kësaj çështjeje  
24 nuk është zgjidhur në apel, kjo pyetje është trajtuar në  
25 parashtrimin IA009-F00014, në veçanti, në paragrafin 14 deri

1 në 26, ku ne kemi dhënë pozicionin tonë të plotë lidhur me  
2 këtë çështje.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Prokuror.

4 Z. Kehoe.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Sa i takon pyetjes në qoftë se NPK-  
6 ja mund të zbatohet për synimin konkret. Përgjigjja është jo.

7 Pozicioni ose pozita e Prokurorisë sa i takon NPK-III,  
8 është në qoftë se anëtarë të këtij entiteti mund të kryejnë  
9 gjenocid, a nuk është e nevojshme që NPK-ja të ketë si  
10 parakusht *mens rea* për krimin, për synimin specifik.

11 Në fakt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u shpreh siç  
12 duhej. Kam përshtypjen se është parashtrimi 000... më falni  
13 një moment, pra është parashtrimi 00030. Dhe në të thuhet që,

14 "...për qëllimet e kësaj çështjeje, Gjykatësi i  
15 Procedurës Paraprake e konsideron si anomali ligjore dënimin e  
16 të akuzuarve për pjesëmarrjen në NPK që përfshin ndalimin  
17 arbitrar dhe trajtimin mizor".

18 Tani kjo shkoi deri në nivelin e apelit dhe është një  
19 çështje juridiksioni. Gjykata në atë kohë u shpreh se  
20 Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka shkuar shumë më tepër sesa  
21 i lejohej për të bërë këtë lloj konstatimi. Dhe dua të citoj  
22 këtu vendimin e apelit që është vendimi 00030, paragrafi 235.

23 Megjithatë, pesha më e madhe e të drejtës ndërkombëtare  
24 është që pa diskutim që bëhet fjalë për një anomali ligjore,  
25 sepse dikë që është pjesë e NPK-së dhe nuk ka synim konkret



1 për gjenocid, prapëseprapë të jetë përgjegjës për gjenocidin,  
2 sepse parashtrimi ynë ka qenë që në fillim fare që kjo nuk  
3 është ajo që parashikohet në ligj dhe këtë në fakt e ka  
4 konstatuar dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vendimin e  
5 vet.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. Emerson.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kam gjë për të shtuar.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Tully.

10 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të shtuar sepse  
11 parashtrimi u tha në mënyrë të përmbledhur dhe të plotë nga z.  
12 Kehoe.

13 Dua të them dhe një herë tjetër që ne nuk kemi në fakt  
14 versionin më parë të redaktuar të Vendimit të Konfirmimit.  
15 Kështu që do të doja që të drejtohesha lidhur me këtë kërkesë  
16 tonën. Nuk e di në qoftë se duhet t'i drejtohem Gjykatësit të  
17 Procedurës Paraprake apo t'jua themi ju këtë shqetësim.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

19 Z. Ellis.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kam asgjë për të shtuar lidhur  
21 me këtë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit  
23 për sqarimin. Çështja tjetër që duam të diskutojmë është plani  
24 që ju kemi dhënë sa u takon seancave gjyqësore. Përpara sesa  
25 të merrnim pushimin e kafes, z. Kehoe tha një gjë që nuk është

1 thënë asnjëherë deri tani, që është rënë dakord me ZPS-në.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Është gjë e mirë apo jo, i nderuar  
3 Gjykatës?

4 Unë diskutova me z. Roberts po z. Roberts ishte ai që ka  
5 qenë më tepër në marrje-dhënie, në diskutime me ZPS-në.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts.

7 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, e morëm dje përgjigjen e  
8 Prokurorisë sa i takon mocioneve të përgjithshme për  
9 kalendarin. Kemi gjithashtu edhe mocionet e veçanta që kemi  
10 depozituar një ose dy ditë më përpara.

11 Kemi diskutuar ndërmjet ekipeve të Mbrojtjes dhe në një  
12 zë të përbashkët kemi diskutuar edhe më ZPS-në. Sigurisht që e  
13 kuptojmë që është kompetencë e Trupit Gjykes për të vendosur  
14 ditën e nisjes së procesit gjyqësor. Megjithatë ne patëm  
15 mundësi që të arrijmë një marrëveshje, një pajtim ose të  
16 paktën nuk kemi pasur kundërshtim nga Prokuroria me faktin që  
17 të fillojmë më datën 3 prill me deklaratat hapëse dhe pastaj  
18 të vazhdojmë menjëherë me dëshmitarin e parë. Kështu që nuk do  
19 të ketë asnjë pauzë ndërmjet dëshmitarit të parë dhe pastaj  
20 dëshmitarëve të tjerë ose deklaratave hapëse. Po ashtu kemi  
21 marrë dhe njoftimin që ka të bëjë me 12 dëshmitarët e parë.  
22 Atëherë ndërkohë Prokuroria nuk e kundërshton këtë pozicion  
23 tonin.

24 Kjo pjesërisht reflekton kalendarin, e di domethënë që ka  
25 edhe një çështje tjetër që parashikohet. I reflekton

1 gjithashtu edhe datat e përcaktuara për një çështje tjetër,  
2 por gjithashtu, dhe ju kërkoj ndjesë, ju kërkoj ndjesë në fakt  
3 z. Laws që nuk e kemi përfshirë atë në diskutimet e  
4 organizuara mbrëmë. Ishte faji im për këtë. Megjithatë folëm  
5 me të sot paradite dhe duket sikur ai nuk është se ka ndonjë  
6 kundërshtim me propozimin, pra që të fillojmë më datën 3  
7 prill.

8 Pra, propozimi ynë është që të fillojmë më datën 3 dhe me  
9 urdhrin për 12 dëshmitarët. Dhe shpresojmë që ky do të jetë  
10 një pozicion që do të jetë i pranishëm për Trupin Gjykses.  
11 Megjithatë, e kuptojmë që marrësi nuk do të ketë mbase 1 javë  
12 pra, pushim dhe mendoj domethënë që në fillim fare të merremi  
13 me pjesën shkresore sesa të vijojmë më tej me pjesën gojore të  
14 procesit gjyqësor.

15 Atëherë pavarësisht dallimeve në opinion ose  
16 interpretimit të komunikimeve ose të pozicioneve tona me  
17 Prokurorinë, u munduam që të arrijmë në një marrëveshje dhe i  
18 falënderoj për pajtimin e tyre në pozicionin tonë. Ndërkohë që  
19 jua lëmë ju në dorë të nderuar Gjykatës që të vendosni sa i  
20 takon datën së nisjes së procesit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokuroria.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Po, është e saktë. E vetmja gjë që  
23 dua të shtoj është që ne nuk është se kemi qenë 100 për qind  
24 kundër vonesave të kësaj natyre. Ne shpresonim që ky proces  
25 gjyqësor të fillonte në mars. Megjithatë, siç e tha dhe z.

1 Roberts, pra kur shikojmë kalendarin dhe kur shikojmë  
2 gjithashtu që java e fundit e marsit është e zënë për një  
3 tjetër proces gjyqësor, atëherë ishte e natyrshme dhe nuk  
4 është se kishte ndonjë dallim shumë të madh për procesin  
5 gjyqësor në qoftë se do ta fillonim më datën 3 prill procesin  
6 gjyqësor.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, keni  
8 ndonjë pozitë?

9 Z. LAWS: [Përkthim] Dua që të them [REDAKTUAR]  
10 [REDAKTUAR] avokatit të z. Selimi. Kështu që jemi dakord me  
11 shtyrjen e shkurtër që është kërkuar nga palët për fillimin e  
12 procesit gjyqësor.

13 Pra kemi shkëmbyer që kështu që nuk duam që të cenojmë le  
14 të themi marrëveshjen ose dakordësinë që është arritur  
15 ndërmjet Prokurorisë dhe palëve të tjera. Kështu që nuk jemi  
16 kundër fillimit më datën 3.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
18 do ta marrim këtë parasysh dhe do marrim një vendim lidhur me  
19 këtë sot. I vlerësojmë përpjekjet, besimin tek njëri tjetri  
20 për të pasur një diskutim për këtë çështje të rëndësishme.

21 Atëherë do ta kaloj pjesën që kisha planifikuar për të  
22 diskutuar me këtë. Kështu që tani do marrim pushimin e drekës.  
23 Do fillojmë përsëri në orën 2.30.

24 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.53

25 --- Seanca rifillon në orën 14.30

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni ju  
2 lutem.

3 Vetëm që të mos prisni, po ju themi që do të ta miratojmë  
4 kërkesën për shtyrjen e fillimit të gjykimit deri më 3 prill.  
5 Nuk do ta quaj kërkesë e përbashkët, por do ta quaj kërkesë e  
6 pa kundërshtua dhe përshëndes edhe një herë vullnetin e palëve  
7 që ta zgjidhin këtë në mënyrën e duhur .

8 Tani, do t'i kthehem kohës kur Prokuroria do ta  
9 përfundojë paraqitjen e provave. Prokuroria ka bërë të ditur  
10 që këtë mund ta bëjë diku nga fundi i vitit 2024 - fillimi i  
11 vitit 2025. A ka mbrojtja komente në lidhje me këtë?

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, përveç asaj që kemi thënë në  
13 parashtrimet e mëparshme.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] Shumë gjatë për paraqitjen e  
15 provave të Prokurorisë. Ne e kemi sugjeruar që më parë se  
16 Prokuroria duhet të jetë në gjendje të përfundojë paraqitjen e  
17 provave për 12 muaj. Duke qenë se Trupi Gjykses e bërë të  
18 ditur që nuk do ta drejtojë mënyrën se si do ta paraqesë  
19 çështjen e vet Prokuroria dhe se nuk do të zbatojë për  
20 momentin masa disiplinore, për mendimin tonë, është në kohë e  
21 gjatë që kërkon Prokuroria.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts?

23 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, edhe ne mendojmë që është  
24 shumë gjatë për paraqitjen e provave në këtë çështje.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis?

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Edhe ne mendojmë të njëjtën gjë. Dhe  
2 ne i kemi bërë parashtrimet tona, në parashtrimin 810 dhe kemi  
3 cituar burimet ligjore në mbështetje të kërkesës sonë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ta zëmë do të  
5 përfundojë një ditë paraqitja e provave të Prokurorisë. Ta  
6 zëmë se ka përfunduar. Atëherë, kur mendon që ju domethënë të  
7 përfundoni paraqitjen e provave tuaja.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Është e vështirë të thuhet, por  
9 duke marrë parasysh të gjithë dëshmitarët që kemi propozuar,  
10 dhe ata do t'i thërrasim të paktën për të dhënë dëshmi të  
11 drejtpërdrejtë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Afrohuni pak  
13 me datën, se nuk ju kemi zëmë për fyti. Mund të thoni një datë  
14 të përafërt.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Mendoj që do të na duhen 3 muaj.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ne mendojmë që do të na duhen tre  
17 apo katër muaj.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts,  
19 nuk po ju vendos në shënjestër, por thjeshtë duam një  
20 përgjigje të arsyeshme.

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Në qoftë se nuk e shohim të  
22 nevojshme që të thërrasim dëshmitarët, mendojmë që do të na  
23 duhet përafërsisht koha e njëjtë që tha edhe z. Emmerson.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

25 Z. Ellis?

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk jemi në pozitë që të japim një  
2 shifër të saktë. Mendoj që do të mund t'i përgjigjemi kësaj  
3 pasi të dëgjojmë provat dhe argumentet e Prokurorisë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, e keni  
5 ndërmend që të thërrisni dëshmitarë.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Në këtë fazë? Kemi ardhur në atë  
7 fazën e njëjtë si në dosjen paraprake kur theksuam që nuk  
8 ishim në gjendje të japim një listë paraprake të dëshmitarëve.

9 Dhe këtë qëndrim kemi edhe sot. Në qoftë se do të duhet  
10 ta bëjmë në gjë të tillë, do të na duhet dikur tre deri në  
11 katër javë deri në tre muaj.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk po  
13 mundohem t'ju vendos në një situatë të vështirë por thjeshtë  
14 për nevoja planifikimi po ua bëj këto pyetje.

15 Prokuror, ju keni ndonjë përgjigje në lidhje me këto  
16 periudha që dhanë Mbrojtja?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo varet kryesisht nga koha për  
18 kundërpyetjet. Nga koha që na ka dhënë Mbrojtja për pyetjet  
19 që do të kenë për 12 dëshmitarët e parë, e bën të pamundur që  
20 ne të mund të japim një afat të përafërt se kur do të mundemi  
21 të përfundojmë pyetjet tona.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Orari i  
23 seancave, pra fillon çështja në prill, më 3 prill, në orën  
24 9.00. Deklarata hyrëse e ZPS-së do të zgjasë jo më shumë se  
25 pesë orë, e Përfaqësuesit të Viktimave besoj që thatë 45

1 minuta, apo jo z. Laws?

2 Z. LAWS: [Përkthim] Deri në 45 minuta.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e  
4 Thaçit tha që do t'i duhet tre orë, Mbrojtja e Selimit një orë  
5 në maksimum, Mbrojtja e Krasniqit një orë e gjysmë dhe do të  
6 ketë edhe pyetje të Trupit Gjykues.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Vetëm thjeshtë ta themi edhe  
8 kohën që do t'i duhet deklaratës hapëse të z. Veseli.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, me të  
10 drejtë e keni, 45 minuta. E kam të shkruar, por e kalova gjatë  
11 leximit.

12 Ju kërkojmë palëve që në deklaratën e tyre t'u shmangen  
13 deklaratave të natyrës politike. Duhet që në ato deklarata të  
14 përqendrohen në ato çështje thelbësore që janë në lidhje me  
15 provat dhe argumentet e tyre dhe të mos i përsërisin gjërat  
16 që i kanë thënë në dosjet paraprake.

17 Palët nuk duhet të ndërpresin deklarata hyrëse të palëve  
18 të tjera, dhe duhet të japin Zyrës Administrative kopje të  
19 këtyre deklaratave në mënyrë që këto të mund t'u jepen  
20 përkthyesëve dhe të sigurohet përkthim i saktë dhe i plotë i  
21 tyre.

22 Në qoftë se do t'ju referohen burimeve ligjore në  
23 deklarata e tyre hyrëse, ato burime ligjore, listën e tyre  
24 pra, duhet tua japin paraprakisht Trupit Gjykues, palës  
25 kundërshtare dhe Përfaqësuesve të Viktimave.



1 A është gjithë e qartë deri tani?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

3 [Trupi Gjykses këshillohet]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka komente  
5 Mbrojtja e Thaçit?

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson?

8 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar, kemi  
9 vetëm një pyetje: do të fillojmë çdo ditë seance në orën 9.00?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

11 Z. Ellis?

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Desha vetëm t'ju bëj me dije që z.  
13 Krasniqi mund të bëjë deklaratë jo nën betim, që mund të  
14 zgjasë diku rreth një orë e gjysmë.

15 Edhe Mbrojtësit e Selimit thotë që të njëjtën gjë mund ta  
16 bëjë edhe z. Selimi.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,  
18 pyetjet e mbetura në parashtrimin 1278 dhe 1271 tani janë  
19 hequr. Është kjo e saktë, me sa e kuptova, z. Kheoe?

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk jam i mirë në numrat.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Janë dy  
22 parashtrimet për vazhdimësinë.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Po.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju, z.  
25 Emmerson?

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Po.

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] ZPS-ja me 30  
4 janar dorëzoi një kërkesë për ndryshimin e listës së provave  
5 materiale. Është parashtrimi F01238. Nuk duam t'i dëgjojmë  
6 parashtrimet që tashmë i kanë bërë me shkrim palët, por  
7 thjeshtë doja të dëgjojmë komentet e tyre.

8 Sipas nesh është ndryshimi i gjashtë i listës së provave  
9 materiale që praqet shqetësim. Materiali që kërkon të hiqet  
10 ose shtohet ka qenë në dispozicion me muaj në disa raste me  
11 vite, dhe nuk e dimë se pse i është dashur kaq kohë ZPS-së që  
12 të njohë apo të identifikojë rëndësinë e atij materiali.

13 Prandaj kemi disa pyetje, pse nuk e keni bërë këtë më  
14 herët? Pse nuk e keni bërë vlerësimin e rëndësisë më herët,  
15 pse duhet t'i riktheheni asaj dhe a mund ta siguronit Trupin  
16 Gjykes se kjo do të ndodhë vetëm një herë dhe se nuk do të  
17 marrim kërkesa të tjera çdo herë kur të paraqitet një grup i  
18 ri dëshmitarësh.

19 Urdhëroni, z. Prokuror.

20 Z. QUICK: [Përkthim] Vetëm sa të sigurohem që i kam tre  
21 pyetjet që i bëtë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'ju  
23 përkujtoj.

24 Z. QUICK: [Përkthim] Sa i përket pyetjes së parë, kjo nuk  
25 është bërë më herët sikurse shpjegohet në kërkesë. Për disa

1 dokumente, ZPS-ja kishte kryer disa vlerësime në mënyrë që t'i  
2 plotësojë detyrimet e saj të nxjerrjes së materialeve, duke  
3 përfshirë ato që dalin nga Rregulla 102(3), 103 dhe përgatitja  
4 e gjykimit. Përmendet ndryshimi i aktakuzës, ndryshimi i  
5 listës së provave materiale, ndryshimi i listës së  
6 dëshmitarëve. Në atë kontekst, u identifikuan dokumente të  
7 tjera të cilat nuk ishin identifikuar më herët dhe disa  
8 dokumente të cilat ZPS-ja i çmoi si të rëndësishme për  
9 argumentet e saj.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetja ime  
11 është se pse ju desh ZPS-së kaq shumë kohë ta bëjë këtë, pse  
12 nuk e bëri më herët?

13 Z. QUICK: [Përkthim] Sikurse shpjegohet deri në një farë  
14 mase në kërkesën tonë në fazën paraprake, ZPS-ja kishte  
15 paraqitur më shumë kërkesa gjatë një procesi të miratuar nga  
16 Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe u nxorën disa vendime,  
17 dhe kjo kërkesë konkrete u bë brenda afatit të përcaktuar në  
18 rregullën 102(1), 30 ditë pra para fillimit të gjykimit.

19 Lidhur me pyetjen që t'ju garantojmë që nuk do të  
20 përsëritet kjo më, ZPS-ja mund t'ju konfirmojë se në këtë  
21 moment, nuk ka kërkesa të tjera të pritshme për ndryshim të  
22 listave, mirëpo sikurse pranohet në urdhrin për zhvillimin e  
23 procedurave, mund të ndodhin rrethana të tilla ku të jetë e  
24 nevojshme përdorimi i dokumenteve shtesë me ndonjë dëshmitar  
25 dhe në ato rrethana, Prokuroria do të kërkojë që ato dokumente

1 të përfshihen në listën e provave materiale.

2 Jam i gatshëm t'ju jap sqarime të mëtejshme në qoftë se  
3 është e nevojshme.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sigurisht pas  
5 kaq viteve dhe pasi keni deklaruar se jeni të gatshëm për  
6 fillimin e gjykimit, ne tani Prokuroria marrim një listë dhe  
7 nuk duam që nesër të marrim një listë të re, ku të përfshini  
8 ndonjë provë materiale që keni harruar. Thjeshtë duhet të na  
9 garantoni se e keni përfunduar këtë proces, se i keni  
10 identifikuar ato që ju duhen dhe i keni përfshirë në ato  
11 listat përkatëse.

12 Z. QUICK: [Përkthim] Po, e kemi të qartë këtë, se  
13 ekzistojnë procedura në fuqi dhe në rregullore që kanë të  
14 bëjnë me kryerjen e procedurave dhe që kanë të bëjnë me listën  
15 e provave materiale.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
17 z. Quick.

18 A keni diçka për të deklaruar nga Mbrojtja? Ju lutem mos  
19 i përsërisni ato që i keni thënë në parashtrimet me shkrim. Në  
20 qoftë se ka ndonjë aspekt praktik që duhet të ngrihet në  
21 lidhje me ato prova materiale, atëherë për këtë duhet të na  
22 bëni parashtrime.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Është një problem global dhe  
24 parashtrohet pyetja se kur do të vijë fundi këtij problemi.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kam të

1 qartë atë që po thoni, por a keni ndonjë aspekt praktik,  
2 problem praktik, që mund të dalë në përdorimin e këtyre  
3 dokumenteve në gjykim.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emerson,  
6 a keni për të shtuar?

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Robert?

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis?

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Përveç atyre që i kemi thënë me  
12 shkrim, nuk kemi asnjë gjë për të shtuar. Ndoshta do të kemi  
13 diçka për të thënë në lidhje me nxjerrjen e materialeve.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e kaluam  
15 atë pikë sot në mëngjes.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Po tash për kohën e drekës kisha  
17 kohë të mendoj, edhe pse kam reaguuar shumë ngadalë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, tani  
19 do të flasim për dëshmitarë që kanë status të dyfishtë. Pra si  
20 dëshmitarë dhe viktima.

21 Gjykatësi Gaynor do t'i bëjë pyetjet në lidhje me këtë.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

23 Me 30 janar të vitit 2023 Trupi Gjygues nxori vendimin  
24 mbi kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit, për lejen për të apeluar  
25 vendimin për nxjerrjen e informacionit për dëshmitarët me

1 status të dyfishtë. Në vendimin tonë deklaram se palët dhe  
2 pjesëmarrësit do të ftohen që të trajtojnë çështjet e  
3 rrethanave në të cilat informacionet në kërkesat për  
4 pjesëmarrje duhet t'i jepet Mbrojtjes dhe këtu përfshihet se  
5 me çfarë mënyrë komunikimi duhet të bëhet kjo.

6 Jemi të interesuar për një çështje që e përshkruan  
7 Mbrojtja e Thaçit, përkatësisht mundësia që formularët e  
8 kërkesës mund të përmbajnë material që është i rëndësishëm, për  
9 Mbrojtjen dhe për përgatitjen e Mbrojtjes. Palët dhe  
10 pjesëmarrësit i referohen në parashtrimet e tyre të rregullës  
11 113(1) të Rregullores të Procedurave të Provave. Paneli  
12 shpreson që të gjejë një zgjidhje të arsyeshme dhe që mendojmë  
13 që Mbrojtja duhet të jetë në gjendje të dijë në qoftë se  
14 formularët e kërkesës përmbajnë ndonjë farë informacioni që  
15 mund të jetë shfajësues për klientët e tyre. Në qoftë se keni  
16 ndonjë parashtrim në lidhje me këtë, sidomos Përfaqësuesi i  
17 Viktimave dhe Prokuroria, ju ftoj që ta bëni këtë tani.

18 ZNJ. MAYER: [Përkthim] E kemi të qartë shqetësimin e  
19 Trupit Gjykses në lidhje me drejtësinë, të drejtat themelore  
20 të të akuzuarve dhe në Rregullën 113(1) thuhet shprehimisht që  
21 një zgjidhje e tillë nuk lejohet dhe se ato të dhëna jepen  
22 vetëm Përfaqësuesve të Viktimave dhe Trupit Gjykses.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws?

24 Z. LAWS: [Përkthim] Kemi bërë diskutime të shumta me  
25 kolegët tanë nga ZPS-ja dhe mendoj që do të bëhet një propozim

1 se ne do të bëjmë çdo gjë që është e mundur për ta ndihmuar  
2 Mbrojtjen, mirëpo duhet të jemi të qartë në qëndrimin tonë i  
3 cili mbetet i njëjtë, se është e zbatueshme rregulla 113 e  
4 Rregullores. Edhe pse jemi të gatshëm ta ndihmojmë Trupin  
5 Gjykses në çdo aspekt, nuk mund të shtirem se e kam e kam  
6 ndryshuar këtë qëndrim, sepse nuk e kam ndryshuar.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A ka dikush nga Mbrojtja për  
8 të thënë diçka?

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk do t'i kthehem vendimeve tuaja  
10 mirëpo është besueshmëria dhe pesha që do t'u jepet atyre të  
11 dhënave dhe prandaj duhet të rishikohet, të shqyrtohet ai  
12 informacion. Ndoshta është mirë që një gjykatës tjetër ta  
13 shqyrtojë atë informacion.

14 Pra kërkojmë nga Gjykata që të gjejme një mekanizëm për  
15 shikimin e këtij informacioni dhe për nxjerrjen e një vendimi  
16 se çfarë do të duhet t'i tregohet Trupit Gjykses në mënyrën e  
17 duhur.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Emmerson? S'ka asnjë  
19 tjetër përfaqësues të Mbrojtjes?

20 Tani, a kundërshton ndonjë palë apo pjesëmarrës  
21 autoritetin e Trupit Gjykses për të urdhëruar nxjerrjen e  
22 formularëve të kërkesave të viktimave me status të dyfishtë,  
23 duke mbajtur parasysh tekstin për mbulimin e fjalisë së  
24 fundit të Rregullës 113(1)?

25 Pyetja e dytë, a ka Trupi Gjykses autoritetin,

1 kompetencat në lidhje me atë se kur duhet të rishikojë dhe  
2 redaktojë këta formularë.

3 Dhe e treta, ky rishikim, a duhet të përqendrohet në  
4 identifikimin e vetëm atyre pjesëve që janë të rëndësishme  
5 materiale për paraqitjen e argumenteve të Mbrojtjes, apo në  
6 alternativë, vetëm ato të dhëna që identifikohen -- apo të  
7 bëhen redaktimet e të dhënave identifikuese të plotësuesit të  
8 kërkesave.

9 E katërta, a duhet ZPS-ja të ketë mundësinë të bëjë  
10 parashtrime të mëtejshme në lidhje me këto formularë, përpara  
11 se ato t'i nxirren Mbrojtjes.

12 A keni diçka për të thënë z. Laws?

13 Z. LAWS: [Përkthim] Unë nuk e kundërshtoj atë që Gjykata  
14 ka kompetenca të bëjë atë që dëshiron të bëjë sepse kjo  
15 Gjykatë mund të nxjerrë urdhra që do të mundësojnë kryerjen e  
16 shpejtë të procedurave dhe kryerjen e drejtë të tyre.

17 Sikurse e thashë edhe pak më përpara, me sa e kuptoj unë,  
18 ZPS-ja do të nxjerrë një farë propozimi se si mund të zgjidhet  
19 kjo dhe ne do ta përkrahim atë. Unë mund t'ju përgjigjem  
20 pyetjeve tuaja dhe mund të gjejmë një zgjidhje pragmatike, por  
21 thjeshtë duhet ta trajtoj një aspekt.

22 Në qoftë se Mbrojtësi i Viktimave duhet ta shikojë këtë  
23 material, ta bëjë të qartë qëndrimin tonë në lidhje me këtë.

24 Jo vetëm që duhet të përfshihemi në këtë proces, por ne  
25 nuk kemi edhe instrumente për ta bërë këtë. Është një rishikim



1 që bëhet kundër dëshmitarëve që do të dëshmojnë këtu dhe që  
2 kanë bërë shumë deklarata në të kaluarën. Nuk është kjo pjesë  
3 e punës sonë dhe nuk jemi në pozitë që të jemi arbitër midis  
4 Gjykatës dhe palëve. Procesi i rishikimit të këtij materiali  
5 nuk duhet të na vendosë në një pozitë të një arbitri që duhet  
6 të marrë vendim apo të një prokurori që nuk do t'i marrë  
7 vendime të tilla në përputhje me rregullën 103. Çfarë do që të  
8 dalë sot, kërkojmë nga ju që të mos e merrni atë si zgjidhje.

9 Ajo që kërkojmë prej jush është që çfarëdo materiali që  
10 do të nxirret, duhet që ne ta shohim atë material përpara se  
11 ai t'i nxirret palëve sepse mund të shkaktojë ndjeshmëri te  
12 viktimave e tjera ose tek anëtarët e familjeve të tyre.

13 Përpara se t'i dëgjoni palët, konkretisht Prokurorinë,  
14 mendoj që është me rëndësi pjesa dy e formularit që është me  
15 rëndësi. E kam të vështirë ta kuptoj se si mund të dhënat  
16 personale, apo të kontaktit të në personi, të jenë objekt i  
17 një detyrimi për nxjerrje materiali. Pjesa dy është pjesa e  
18 formularit ku parashtuesi i kërkesës shpjegon se si cilësohet  
19 apo mbi çfarë baze konsiderohet si viktimë pjesëmarrjeje në  
20 proces.

21 Dhe në qoftë se këto pjesë janë fokusi i detyrimit të  
22 nxjerrjes së materialeve, atëherë ne sugjerojmë që mos të --  
23 ky informacion nuk mund të nxirret.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, z. Laws.

25 Urdhëroni, znj. Prokurore.

1 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ne kemi shqetësimin sepse të  
2 devijohet nga rregulla dhe formulimi i qartë i asaj rregulle  
3 që është formuluar duke balancuar palët dhe të drejtat e tyre.

4 Sikurse e dini edhe ju, rregulla 113, kapitulli i 8  
5 përqendrohet në çështjen e pjesëmarrjes së viktimave në  
6 proces, janë vetëm dy rregulla në atë kapitull, prandaj e kemi  
7 të qartë që Trupi Gjykses është i interesuar që të gjejë një  
8 zgjidhje dhe siç tha edhe kolegu im, Gjykata e ka kompetencën  
9 që ta tejkalojë përmbulimin e rregullës.

10 Është me rëndësi që Gjykata të përqendrohet në dallimin  
11 midis që paraqet ky lloj materiali, entiteti, apo subjekti i  
12 vetëm që ka këtë material është Mbrojtësi i Viktimave dhe  
13 Trupi Gjykses.

14 Prandaj ne propozojmë që Trupi Gjykses në qoftë se është  
15 i shqetësuar dhe po bazohem në vendimin e 30 janarit të vitit  
16 2023, ku e refuzon lejen për apel, është parashtrimi F01232,  
17 ku përqendrohet në mundësinë -- jo mundësinë reale për  
18 nxjerrjen e informacionit identifikues.

19 Ne mendojmë që Paneli do të mund të përpilojë një  
20 nxjerrje me kujdes vetëm të atij informacioni që është më i  
21 nevojshëm. Ky material nuk mund të diskutohet në të njëjtin  
22 kuadër sikurse diskutohet nxjerrja standarde e materialeve,  
23 sepse ky është një material tjetër, nuk është një material që  
24 posedon ZPS-ja dhe rregullat për nxjerrjen e materialit dhe  
25 gjithë kapitullin në Rregullore nxjerrjen e materialeve, duke

1 filluar nga rregulla 102 në lidhje me materialet që janë në  
2 zotërim të ZPS-së, dhe mendojmë që ky material nuk mund të  
3 futet apo të mbulohet në atë kuadër. Mund Trupi Gjykses të  
4 urdhërojë nxjerrjen e asaj pjese relevante, siç vuri në dukje  
5 kolegu im. Është mendoj pjesa dy, dhe Avokatit të Mbrojtjes së  
6 Viktimave duhet t'i jepet mundësia që të bëjë rekomandimet e  
7 tij në Zyrën Administrative në lidhje me nxjerrjen e atij  
8 informacioni.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

10 Urdhëroni, z. Kehoe.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Vendimi ishte i qartë dhe e vë në  
12 dukje se mund të krijohet një situatë kur Mbrojtjes i mohohet  
13 qasja në informacion, i cili mund të jetë me rëndësi për  
14 çështjen e vet dhe që mund të ndikojë në besueshmërinë,  
15 mbështetshmërinë dhe peshën e dhënë nga ZPS-ja. Pra, është e  
16 qartë -- 103, kjo gjë mund të ketë një efekt negativ në të  
17 drejtat e të akuzuarve.

18 Në këtë moment, e kuptoj se ka probleme lidhur me  
19 viktimat. Z. Laws e pranoi se Trupi Gjykses ka mundësinë që ta  
20 rregullojë këtë çështje, duke ja dhënë këto materiale Gjykatës  
21 për ta parë përpara se -- Trupit Gjykses -- përpara se t'ua  
22 japë palëve, duke caktuar ndoshta edhe një është gjykatës të  
23 katërt, për t'i diskutuar këto çështje në kamera. Ne ju  
24 kërkohet që ju ta bëni këtë me qëllim që të shikohet nëse këto  
25 dokumente janë pjesë e problemit të nxjerrjes apo jo, me

1 qëllim që t'i jepen Mbrojtjes. Pra ne kërkojmë që të bëhet ky  
2 rishikim i dëshmitarëve me status të dyfishtë.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Emmerson.

4 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kam gjë.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] As ne s'kemi gjë.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, palët dhe  
7 pjesëmarrësit për kontributet e tyre. Do të nxjerrim një  
8 vendim për këtë çështje.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kujtoj se në  
10 një vendim të nxjerrë nga ky Trup Gjykues të premtën që shkoi,  
11 në materialin F1277 ne vumë në dukje se do ta lejojmë  
12 Mbrojtësin e Viktimave të bëjë parashtrime gojore gjatë  
13 konferencës së sotme për një çështje të ngritur nga Mbrojtja e  
14 Thaçit në parashtrimin F01267.

15 Sa për t'ju lejuar kohë të mjaftueshme që z. Laws të ketë  
16 mundësinë nëse do t'i përgjigjet.

17 Pra e kemi fjalën nëse dëshironi të përgjigjeni, z. Laws.

18 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit, po.

19 Sa për të dhënë një ide të përgjithshme, ne në përputhje  
20 me udhëzimin, dorëzua një njoftim për dëshmitarin që do të  
21 intervistonim. Përgjigja e Mbrojtjes së Thaçit ishte se duke  
22 pasur parasysh sipas Trupit Gjykues, do të vendosej një  
23 kufizim i mëtejshëm për pjesëmarrjen në këto procedura, lidhur  
24 me mënyrën e procedimit të kësaj çështjeje.

25 Herën e fundit, Mbrojtja bëri një tjetër sugjerim lidhur

1 me kufizimin e pjesëmarrjes sonë. Kësaj here erdhi gjatë një  
2 parashtrimi për të cilin ne nuk kishim të drejtë të  
3 kundërpërgjigjeshim, sipas udhëzimeve të Trupit Gjykues.

4 Ne menduam se nuk kishim çfarë të bënim dhe mbase Trupi  
5 Gjykues ishte i bindur nga ato që u thanë nga Mbrojtja e z.  
6 Thaçi. Ne kërkuam leje bazuar në premisën se po të na jepej  
7 leja, do ta hiqnim këtë parashtrimin e Thaçit.

8 Baza nuk mund të jetë tjetër, më e mirë se sa vetë  
9 konstatimi i Trupit Gjykues.

10 Trupi Gjykues vëren se parashtrimet e z. Thaçi nuk i  
11 përgjigjen kërkesës por ngrenë një çështje të re. Në këtë  
12 bazë, ne sugjeruam se nuk kemi pse t'i përgjigjemi, nuk i  
13 përgjigjet parashtrimin tonë dhe duhet hequr nga  
14 dokumentacioni gjykatës. Në qoftë se do të ketë një diskutim  
15 për fushëveprimin e pyetjeve të Mbrojtjes ne mund ta bëjmë,  
16 por ne sugjeruam që kjo bëhet në mënyrën e duhur, më mirë me  
17 shkrim sepse duhet t'i referohemi jurisprudencave të ndryshme.

18 Pra ka dy aspekte, por së pari, faleminderit për  
19 mundësinë që më dhatë. Ne sugjerojmë që duhet hequr ky  
20 dokument nga dokumentacioni dhe së dyti, ne jemi gati të  
21 futemi në diskutim në qoftë se Gjykata dëshiron ta rihapi këtë  
22 diskutim lidhur me ecurinë e procesit. Kjo do të na japë  
23 mundësi që të shprehemi lidhur me klientët tanë përpara kësaj  
24 Gjykate.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

1 z. Laws.

2 Doni të përgjigjeni, z. Misetiç?

3 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Po.

4 Ne nuk pajtohemi, me gjithë respektin, me Mbrojtësin e  
5 Viktimave, që e klasifikon kërkesën tonë si një kërkesë për  
6 rishqyrtimin e rendit të procedurave. Sikur ne duam që ta  
7 rihapim, ne nuk e trajtojmë çështjes së mënyrës se si do të  
8 lejohet marrja në pyetje.

9 Nuk i jep Mbrojtjes së Viktimave mundësi që të kërkojë  
10 leje, por nuk sugjeron që Trupi Gjykses i ka paragjykuar  
11 pyetjet, duke ditur se rregulla 143(4) i jep Trupit Gjykses  
12 mënyrën e përgjithshme të mënyrës se si bëhen pyetjet dhe ju  
13 nuk e keni bërë një gjë të tillë, për të paragjykuar mënyrën  
14 se si bëhen pyetjet, kur lejohen të paraqesin prova apo jo.

15 Pra, ne mendojmë se çështja nuk është trajtuar nga Trupi  
16 Gjykses dhe me kënaqësi do të vazhdonim diskutimin nëse është  
17 e nevojshme por ne e kemi cituar autoritetin dhe nuk kemi  
18 arsye se pse Mbrojtësi i Viktimave do të ketë të drejtë t'i  
19 bëjë pyetje dëshmitarëve të Prokurorisë përpara se ne të kemi  
20 mundësi të bëjë pyetjet.

21 Z. LAWS: [Përkthim] A mund të kundërpërgjigjem unë?

22 Ne i kemi ndjekur udhëzimet e Trupit Gjykses të mos  
23 përgjigjemi prandaj nuk jemi përgjigjur. Por nëse ne do të  
24 diskutojnë, mund të japim një përgjigje të plotë, sepse  
25 jurisprudenca e GJPN-së nuk është e njëanshme, siç është sapo

1 sugjeruar nga z. Misetiç. Kjo është e para që desha të thosha.

2 Jemi shumë të kënaqur që po e mbajmë këtë diskutim. Në  
3 qoftë se Gjykata e kërkon këtë, por desha të thosha se rendi i  
4 kryerjes së procedurave nuk specifikojnë ndonjë gjë për  
5 mënyrën se si duhet të bëhen pyetjet. Ne duhet ta shohim por  
6 po përdor fjalën "pyetje shtesë" dhe të gjithë e dinë se çfarë  
7 është kjo pyetje shtesë nga pala kundërshtare.

8 Pra, që të kesh mundësi të bësh pyetje sugjeruese ne nuk  
9 pajtohemi me idenë që Trupi Gjykues e ka lënë të hapur sepse  
10 nuk ishin pyetje shtesë dhe këtu mund të diskutohet nëse  
11 ishin pyetje sugjestionuese apo jo. Por, Trupi Gjykues duhet  
12 të na japi të drejtën nëse ata mendojnë se është e drejtë ta  
13 kemi të bëjmë pyetje. Nëse jo, e pranojmë me kënaqësi, por nuk  
14 mund të vazhdojmë me idenë që është lënë e hapur, e pavendosur  
15 në urdhrin e Gjykatës. Këtë desha të thosha.

16 [Trupi Gjykues këshillohet]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për të qenë  
18 të drejtë me të gjithë palët, z. Laws dhe z. Kehoe, do të  
19 pranojmë parashtrime me shkrim për këtë çështje nga z. Laws,  
20 sa kohë do t'ju duhet të përgjigjeni, më thoni.

21 Z. LAWS: [Përkthim] Shtatë ditë ju lutem.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe pesë për  
23 t'ju përgjigjur?

24 Z. LAWS: [Përkthim] Po.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë nuk

1 po e marrim vendimin për këtë çështje në këtë moment dhe do të  
2 marrim vendim sa më shpejtë që të mundemi. Pa dyshim përpara  
3 fillimit të gjykimit.

4 Edhe një çështje tjetër, përpara se të largohemi. Do të  
5 kemi disa urdhra gojorë që do t'i japim pas pak, mbase do të  
6 ishte mirë që ta fillojmë pjesën provuese të gjykimit në 3  
7 prill, në qoftë se në datën 20 mars kemi një konferencë të  
8 shkurtër për statusin e çështjes. Kjo do të jetë një mundësi  
9 për t'i përmbledhur të gjitha çështjet që mund të jenë të  
10 pazgjidhura.

11 Gjithashtu, do të kemi mundësi t'ju përditësojmë për të  
12 gjitha çështjet që mendojmë se duhet t'i dini përpara e të  
13 fillojë gjykimi, dhe të komentoni për këto.

14 E dimë që udhëtimi për disa prej jush mund të jetë  
15 problematik, kështu që s'do të kishim ndonjë problem nëse ju  
16 doni të paraqiteni nëpërmjet Zoom-it. Për të akomoduar  
17 diferencat në kohë, do të fillojmë në orën 13.00 dhe do të  
18 përfundojmë maksimumi në orën 16.00.

19 Dhe për këtë dëshiroj që dëgjoj mendimet tuaja. Në qoftë  
20 se mendoni se ka diçka për të thënë.

21 Z. Prokuror.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Me kënaqësi do ta bëjmë dhe jemi  
23 të disponueshëm atë ditë. Edhe ne mendojmë që jemi të gatshëm  
24 të ndjekim këtë gjë.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Edhe ne jemi dakord.



1 Z. ELLIS: [Përkthim] Është ide e mirë, edhe ne mendojmë  
2 kështu.

3 Mbase faktori i ndryshimit të kohës mund ta bëjë fillimin  
4 me vonesë më shumë problematik se sa një fillim i hershëm, në  
5 qoftë se nuk gabohem.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë cila  
7 do të ishte koha më e mirë për ju?

8 Z. Alagendra?

9 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Në çdo  
10 kohë që t'ju duket ju më e përshtatshme, për mua s'ka problem.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis? Nuk  
12 e dëgjova. Mund ta përsërisni edhe një herë?

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Unë s'kam asnjë problem, në  
14 çdo orë që i përshtatet Gjykatës, të nderuar.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë që  
16 doni të shtoni, z. Ellis?

17 Atëherë po ndjekim planin që sapo e thamë, nga ora 13.00  
18 deri në orën 16.00.

19 Do të bëjmë në pushim të shkurtër. Pas gjysmë ore, dhe  
20 pastaj do të kthehemi. Ju faleminderit.

21 --- Pauza fillon në orën 15.11

22 --- Seanca rifillon në orën 15.42

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem  
24 ulini.

25 Gjykatësi Mettraux ka një çështje është shkurtër që donte

1 ta sillte në vëmendjen tuaj.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

3 Z. Roberts, kjo ka të bëjë me ty. Ka të bëjë me  
4 protokollimin F01281, datë 13 shkurt të vitit 2023, lidhur me  
5 paraqitjen fillestare dhe një parashtrim, një akuzë të re që  
6 thoni ju.

7 Kam një pyetje shumë të shkurtër dhe të thjeshtë për ju.  
8 Pas zhvillimeve të ditës së sotme dua t'ju pyes në qoftë se  
9 keni akoma të njëjtin qëndrim apo në qoftë se e tërhiqni  
10 qëndrimin që e keni thënë në këtë parashtrim.

11 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, i qëndroj të njëjtës kërkesë,  
12 për sa i takon afatit lidhur me të drejtën për mocionet  
13 paraprake sepse ne kemi të drejtë që të bëjmë parashtrime të  
14 tjera lidhur me paragrafët e redaktuar dhe të njëjtën gjë do  
15 ta bëjmë për sa i takon paragrafit 41, 42, 49 dhe paragrafëve  
16 të tjerë.

17 Lidhur me paraqitjen e parë, do ta lemë në duart tuaja,  
18 të nderuar Gjykatës. Pra ne vazhdojmë që t'i qëndrojnë  
19 qëndrimin tonë për akuzat e reja dhe gjithsesi kjo do të varet  
20 nga informacioni që do të marrim në dosjen paraprake.

21 Pra, në përgjigje, për ta shkurtuar atë çfarë dua të them  
22 është që vazhdojmë që të kemi të njëjtin qëndrim lidhur me  
23 akuzën e re.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

25 Lidhur me paragrafin 41, dhe kjo është pyetje për ZPS-në,

1 sigurisht do të keni edhe kohë për t'ju përgjigjur me shkrim  
2 kërkesës së z. Selimi, por ju kërkojmë shpjegime ose sqarime  
3 në qoftë se jeni të përgatitur që të jepni shpjegime të tilla  
4 dot, e kam fjalën për paragrafin 41 që aktualisht është i pa  
5 redaktuar. Pyetja ka të bëjë me faktin që duhet të sigurohemi  
6 që e kuptoj drejtë atë çfarë pretendohet në atë paragraf dhe  
7 në veçanti, nëse pretendoni që sjellja e z. Selimi në këtë  
8 paragraf të caktuar përbën bazë për dënim. Në kuadrin e asaj  
9 çfarë mund të përbëjë një akuzë të re. Pra, sikurse e thashë,  
10 nuk presim nga ju që të na e shtjelloni plotësisht këtë  
11 çështje. Do të keni kohë që ta bëni këtë gjë me shkrim, pra me  
12 parashtrim të shkruar, megjithatë, mund të na jepni një ide të  
13 përgjithshme të paktën lidhur me atë se çfarë pretendohet n  
14 është atë paragraf konkretisht.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, asnjë prej  
16 akuzave tona nuk ndryshohet si rezultat i informacionit që  
17 përmbahet në këtë paragraf. Domethënë, nuk është se ka një  
18 formë të re të përgjegjësisë penale, nuk ka një akuzë të re.  
19 Bëhet fjalë për të njëjtën çështje siç do të ishte përpara se  
20 sa të ishin hequr redaktimet në paragrafin 141.

21 Pra, dispozitat që kanë të bëjnë me një paraqitje të parë  
22 të mëtejshme, nuk qëndrojnë.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Duke prezumuar këtë që  
24 thoni të jetë e sigurt, ju thoni që deri sa të hiqen  
25 redaktimet, nuk -- Mbrojtja thotë që nuk kishin mundësi që të

1 pretendonin një akuzë të re sepse nuk e dinin se çfarë  
2 përmbante pjesa që ishte e redaktuar.

3 Pyetja është kjo, pra duke pasur parasysh që redaktimi në  
4 vetvete, pra ju a mendoni se z. Selimin -- përgjithshëm në  
5 qoftë se pranohet ajo çfarë përshkruhet në këtë paragraf, a  
6 mendoni ju që z. Selimi do të jetë përgjegjës ose mund të  
7 pritët që të dënohet për një krim, në qoftë se do të  
8 mbështetemi në formulimin e këtij paragrafi?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Ne e besojmë që ky është një nga  
10 faktet materiale që është i nevojshëm në mënyrë të tillë që të  
11 provohet që vendi i ndalimit, që ka të bëjë me krimet në  
12 fjalë. Megjithatë, nuk bëhet fjalë me një vendim dënimi me  
13 këtë incident në vetvete, por incidenti në vetvete tregon që  
14 ekziston një akuzë që ne synojmë që të provojmë, në bazë të  
15 provave tona.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

17 Z. Roberts.

18 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk e kuptova shumë mirë se çfarë  
19 tha Prokuroria, nuk e kuptoj shumë qëndrimin e Prokurorisë.

20 Nga perspektiva ime, në mënyrë të tillë që të mund të  
21 hapim një parashtrim të kuptueshëm për Trupin Gjykses dhe  
22 sfidat ose kundërshtimet e juridiksionit në këtë paragraf, unë  
23 do të preferoja që qëndrimi i Prokurorisë të jepet në formë të  
24 qartë, përpara se sa të bëjmë ne parashtrimin tonë.

25 Pra, ne do e japim këtë parashtrim të hënë, domethënë

1 brenda 21 ditëve pas heqjes së redaktimeve të dokumentit, por  
2 sërish do të doja të thosha që duam që të kemi të qartë se  
3 cili është pozicioni i Prokurorisë lidhur me këtë.

4 Në qoftë se nuk kemi parashtrime të tjera, do të  
5 mbështetemi në atë çfarë tha z. Halling. Megjithatë, duke  
6 pasur parasysh kompleksitetin e lidhur me këtë çështje, ne do  
7 të donim që të paktën deri nga e premtja e javës që vjen të  
8 kemi parashtrimet e Prokurorisë, në qoftë se kjo është e  
9 pranueshme për Panelin.

10 [Trupi Gjykses këshillohet]

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Halling, a mund të na  
12 thoni se sa shpejt ose kur mund të bëni parashtrimet me shkrim  
13 lidhur me këtë çështje?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Më jepni një moment sa të  
15 konsultohem me kolegët.

16 [Prokurorët e Specializuar këshillohen]

17 Z. HALLING: [Përkthim] Deri të hënën e javës që vjen.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A funksionon për ju? A  
19 është OK për ju?

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nëse bëhet parashtrimi të hënën,  
21 atëherë ne do të përgjigjemi deri të premtën në javën që vjen.  
22 Është në rregull kjo?

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

24 Në rregull, tani le të kalojmë tek urdhrat gojorë të  
25 Trupit Gjykses.

1 Urdhri i parë, hapja e çështjes dhe kërkesa për shtyrje,  
2 në përputhje me rregullat 9,5(a) dhe 118(3) të Rregullores,  
3 Trupi Gjykses konstaton që duke pasur parasysh parashtimet e  
4 palëve, ekziston një arsye bindëse për ndryshimin e kohës së  
5 hapjes së procesit gjyqsor.

6 Trupi Gjykses vendos që çështja do të hapet me datë 3  
7 prill të vitit 2023, në orën 09.00 dhe deklaratat hapëse do të  
8 mbahen me datë 3, 4 dhe 5 prill të vitit 2023.

9 Koha e nisjes së procesit gjyqsor në këto ditë do të  
10 jetë në orën 09.00 dhe deri në fund të procesit gjyqsor, me  
11 përjashtim të rasteve kur do të bëjmë ndonjë ndryshim konkret.

12 Procesi -- dëgjimi i provave do të fillojë me 11 prill të  
13 vitit 2023. Trupi Gjykses vë re se Mbrojtja ka tërhequr çdo  
14 kërkesë tjetër pezul të përfshirë në parashtimin e  
15 protokolluar F01253 dhe F01271 dhe konstaton se këto kërkesa  
16 janë të tejkaluara.

17 Urdhri i dytë: Pajtimi ndërmjet palëve lidhur me çështje  
18 faktike dhe juridike, në pajtim me rregullin 118(4), si  
19 Kryegjykatës i këtij Trupit Gjykses, mbaj parasysh gjendjen  
20 dhe pajtimin ndërmjet palëve lidhur me çështje faktike dhe  
21 juridike.

22 Urdhri i tretë gojor: ka të bëjë me rregullën 102(3).

23 Në pajtim me rregullin 102(3) të Rregullores, Trupi  
24 Gjykses urdhëron ZPS-në që të dorëzojë njoftimin e ndryshuar  
25 sipas rregullës 102(3) deri të premtën, me datë 17 shkurt të

1 vitit 2023, në orën 16.00.

2 Urdhri i katërt: data e shënuar për mbylljen e çështjes  
3 së ZPS-së. Në pajtim me rregullën 11(5) dhe 129 të  
4 Rregullores, Trupi Gjykues përcakton datën e mbylljes së  
5 çështjes së Prokurorisë me datë 1 prill të vitit 2025.

6 Urdhri i pestë: në pajtim me nenin 40 të Ligjit, ZPS-ja  
7 urdhërohet që përveç përdorimit të tabelave, ose ndihmave  
8 vizuale në deklaratat hapëse, të përdorë mjete të tilla edhe  
9 gjatë thirrjes së dëshmitarëve. Ajo mbështetet në vlerësimin e  
10 ZPS-së se cila janë ato mjete vizuale ose grafikë të tjerë të  
11 cilët do të jenë të nevojshëm për prezantimin e provave të  
12 tyre.

13 Duhet që të përdorin tabela dhe mjete vizuale të cilat  
14 kanë të bëjnë me provat rreth UÇK-së dhe zinxhirin e komandës.

15 Urdhri i gjashtë: Mbrojtja e Viktimave urdhërohet që deri  
16 më datë 22 shkurt të vitit 2023 në orën 16.00 të dorëzojë  
17 parashtrimet e veta të lidhura me llojet e pyetjeve që do të  
18 bëhen për kundërpjetjen në pajtim me paragrafin 47(ii)(a) e  
19 Urdhrit, sipas urdhrit për kryerjen e proceseve gjyqësore.

20 Urdhri i shtatë: ka të bëjë me planifikimin e Konferencës  
21 për Ecurinë e Çështjes.

22 Në pajtim me Rregullën 116(5) të Rregullores, Trupi  
23 Gjykues planifikon Konferencën për Ecurinë e Çështjes me datë  
24 20 mars të vitit 2023 në orën 09.00.

25 Ky është fundi i urdhrave gojorë për sot. A keni ndonjë

1 gjë për të shtuar?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi për të shtuar.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, me datën 20 mars  
4 seanca do të fillojë në orën 09.00 apo në orën 13.00?

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do fillojë në  
6 orën 09.00, e ndryshuar, jo në orën 13.00.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të them dy gjëra për  
8 procesverbalin për Konferencën e ardhshme për Ecurinë e  
9 Çështjes?

10 Çështja e parë ka të bëjë me datën që Prokuroria do të  
11 duhet të njoftojë grupin pasardhës të dëshmitarëve që do të  
12 thërrasë për të dhënë dëshmi, në mënyrë të tillë që ne të  
13 fillojmë me përgatitjet paraprakisht.

14 Së dyti, e kam ngritur edhe herë të tjera përpara  
15 Gjykatësit të Procedurës Paraprake, por kjo çështje nuk është  
16 zgjidhur asnjëherë prej tij. Numri i dëshmitarëve që do të  
17 thërriten nga ZPS-ja, në veçanti lidhur me çështje që kanë të  
18 bëjnë me zinxhirin e komandës së UÇK-së, intervistat që janë  
19 bërë nga ZPS-ja janë bërë në kuadrin e tyre të thirrur si të  
20 dyshuar, kështu që në qoftë se këta persona do të vijnë e të  
21 japin dëshmi me intervistimin e tyre në cilësinë e të  
22 dyshuarve, ata duhet mbeten me këtë status. Kështu që, të  
23 nderuar Gjykatës, duhet që të shqyrtoni se cilat do të jenë  
24 pasojat për dëshmitarët, jo sepse ne jemi këtu për të  
25 përfaqësuar interesat e dëshmitarëve, por sigurisht që



1 dëshmitarët kanë të drejtën që të mos thonë diçka që i  
2 inkriminon veten e tyre, ose fajëson veten e tyre. Dhe nga ana  
3 tjetër ata kanë të drejtën që të përfaqësohen nga pikëpamja  
4 ligjore.

5 Kjo është e rëndësishme për ne, sepse një dëshmitar i  
6 cili mund të fajësojë veten mund të ketë motive të tjera  
7 shtesë të cilat mund të cenojnë sinqeritetin ose vërtetësinë e  
8 dëshmimeve të tyre. Edhe është një gjë që kjo është çështje që e  
9 kanë ngritur edhe më përpara, ndërkohë që nuk është vendosur  
10 asgjë lidhur me ta. Kështu që, në qoftë se do të ketë  
11 dëshmitarë të cilët mbeten në listën e personave të dyshuar të  
12 Prokurorisë, kjo duhet të sqarohet. Pra, këto janë kërkesat të  
13 cilat janë të nevojshme për t'u sqaruar.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptojmë  
15 shqetësimin tuaj dhe do ta marrim parasysh, do ta diskutojmë  
16 në kohën e përshtatshme.

17 Ndokush tjetër?

18 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit  
21 të gjithëve që ishin sot me ne.

22 Më fal, z. Laws.

23 Z. LAWS: [Përkthim] Më lejoni të shtoj diçka që ka të  
24 bëjë me statusin e dyfishtë të dëshmitarëve, çfarë do të bëhet  
25 lidhur me të?

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të  
2 nxjerrim një urdhër me shkrim, do t'ju informojmë më tej për  
3 hollësitë.

4 Ju faleminderit shumë, faleminderit përkthyesve, stafit  
5 të Gjykatës, të gjithë palëve për sinqeritetin gjatë ditës së  
6 sotme, ju faleminderit. Do të shihemi sërish me datë 20 mars  
7 të vitit 2023.

8 --- Seanca e Konferencës Përgatitore e  
9 Prokurorit të Specializuar mbyllet në orën  
10 15.57

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25